gjatë kësaj periudhe. Megjithatë këto rezultate pritet që të publikohen në një punim pasues. Vlerësimet in-situ janë më efektive kur bëhen analiza për burime lokale, si në rastin e djegieve në malin e Taraboshit. Nga ana tjetër, vlerësimet me teknikat remote sensing, janë më të efektshme në analizat në shkallë globale, si p.sh., stuhitë shkretinore apo tymrat e vullkaneve. Meqenëse qyteti i Shkodrës gjatë muajit gusht, 2011, ndikohej si nga djegiet në Tarabosh, ashtu edhe nga ndikimet e djegieve rajonale, analizat komplete do të kërkonin përdorimin e kombinuar të të dyja teknikave.

Përfundime

Në këtë punim janë prezantuar disa nga metodat më bashkëkohore në analizat e ndotjeve atmosferike, si ato të quajtura remote sensing. Për të ilustruar këtë problem, është trajtuar edhe një rast i veçantë i djegieve masive në malin e Taraboshit, në gusht, 2011. Në këto analiza janë shfrytëzuar modelet ekzistuese, si: NAAPS dhe HYSPLIT, si dhe imazhet satelitore të marra nga MODIS/NASA.

Rezultatet e përgjithshme tregojnë një rritje të dukshme të thellësisë optike të aerosoleve gjatë tetë ditëve të fundit të muajit gusht, rritje e cila i atribuohet më tepër ndikimit të tymrave në malin e Taraboshit. Por duhet pasur parasysh se këto rezultate janë të përgjithshme dhe përfshijnë edhe ndikimet e djegieve biomasore të zonave përreth, të cilat sipas përcaktimeve ishin mjaft të dukshme. Ndërsa proceset e djegieve në distanca shumë të largëta nuk ndikojnë dukshëm në ngjarjen në shqyrtim.

Megjithatë për të përforcuar dhe detajuar më tepër përfundimet e këtij studimi, janë të nevojshme edhe rezultatet e matjeve in-situ, të cilat do të publikohen në një tjetër punim.

Referencat

- CHRISTENSEN, J. H., 1997: The Danish Eulerian hemispheric model - A three-dimensional air pollution model used for the Arctic. *Atm. Env.*, 31, 4169-4191.
- DRAXLER R. R. and G. D. ROLPH, 2003, Hysplit model via NOAA ARL READY website, NOAA Air Resources Laboratory, Silver Spring, edited, Md.
- FRANCHIN, A., CHEN, X., MANNINEN, H., PETAJA, T., KULMALA, M., BERNANDONI, V., MANDIJA, F., SIMONETO, F., VALLI, G., VECCHI, R., Il contributo della ionizzazione dell'atmosfera nella formazione di nuove particelle; le misure nella stazione

- remota SMEAR II (Hyytiala, Finland), Sesto Coovegno Nazionale su Particolato Atmosferico, Genoa, Italy.
- HAYS, M. D., FINE, P. M., GERON, C. D., KLEEMAN, M. J., and GULLETT, B. K.: 2005. Open burning of agricultural biomass: Physical and chemical properties of particle-phase emissions, *Atmos. Environ.*, 39, 6747–6764.
- LUDERER, G., TRENTMANN, J., WINTERRATH, T., TEXTOR, C., HERZOG, M., GRAF, H. F., and ANDREAE, M. O.: 2006. Modeling of biomass smoke injection into the lower stratosphere by a large forest fire (Part II): sensitivity studies, *Atmos. Chem. Phys.*, 6, 5261–5277.
- MANDIJA, F., BUSHATI, J. FRASHERI, N. 2010. ICT application for monitoring air pollution in the area of Shkodra Lake, *Proceedings of the Balwois Conference*, pp. 1-7.
- NICKOVIC, S., G.KALLOS, A. PAPAPOPOULOS and O. KAKALIAGOU, 2001, A model for prediction of desert dust cycle in the atmosphere. *J. Geophysical Res.*, Vol. 106, D16, 18113-18129.
- PENNER, J. E., R. E. DICKINSON, and C. A. O'NEILL, 1992: Effects of aerosol from biomass burning on the global radiation budget. *Science*, 256, 1432-1434.
- REID, J. S., ECK, T. F., CHRISTOPHER, S. A., KOPPMANN, R., DUBOVIK, O., ELEUTERIO, D. P., HOLBEN, B. N., REID, E. A., and ZHANG, J.: 2005 A review of biomass burning emissions part III: intensive optical properties of biomass burning particles, *Atmos. Chem. Phys.*, 5, 827–849.
- SCHULTZ, M. G., HEIL, A., HOELZEMANN, J. J., SPESSA, A., THONICKE, K., GOLDAMMER, J. G., HELD, A. C., PEREIRA, J. M. C., and van der BOLSCHEER, M.: 2008. Global wildland fire emissions from 1960 to 2000, *Global Biogeochem. Cycles*, 22, GB2002.
- TOWNSHEND, J.R.G. and JUSTICE, C.O. 1990. The spatial variation of vegetation at very large scales. *International Journal of Remote Sensing*, 11, 149-157.
- YOKELSON, R. J., KARL, T., ARTAXO, P., BLAKE, D. R., CHRISTIAN, T. J., GRIFFITH, D. W. T., GUENTHER, A., and HAO, W. M.: 2007. The Tropical Forest and Fire Emissions Experiment: overview and airborne fire emission factor measurements, *Atmos. Chem. Phys.*, 7, 5175–5196.

Shkëmbimi i fosforit përmes sipërfaqes sediment-ujë në Liqenin e Shkodrës

Diana Kapiti, Adem Bekteshi

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Departamenti i Biologji- Kimisë

PËRMBLEDHJE

Ekosistemet ujore ndikohen nga prania e lëndëve ushqyese dhe veçanërisht fosforit, i cili nga shumë autorë përcaktohet si elementi kufizues në eutrofikimin e ujërave natyralë. Sedimentet luajnë një rol të rëndësishëm në të gjithë procesin e metabolizmit të fosforit në liqen, duke vepruar si depozitues dhe si burim i fosforit. Studime të shumta kanë treguar se fluksi i fosforit nga sedimenti drejt shtresës ujore ndikohet nga karakteristikat e shtresës ujore pranë sedimentit, e cila ka rëndësi në tretjen e fosforit nga sedimentet.

Liqeni i Shkodrës i lokalizuar në kufirin shqiptaro-malazes ka shërbyer si objekt i studimit, që kishte për qëllim të përcaktonte përmbajtjen e fosforit në sediment dhe shtresën ujore sipër sedimentit, si dhe të përcaktonte faktorët që kushtëzojnë kalimin e fosforit nga sedimenti në shtresën ujore pranë tij.

Rezultatet e analizave treguan se fosfori në sedimentet e liqenit të Shkodrës ndodhet kryesisht në formën e HCl-P, ndërsa sasia më e vogël e fosforit ndodhet në formën e NH₄Cl-P. Rezultatet treguan se kalimi i fosforit nga sedimenti në shtresën ujore pranë tij varet nga përzierja e ujit në liqen dhe nga përmbajtja e NH₄Cl-P në sedimente.

FJALË KYÇE: Liqeni i Shkodrës, format e fosforit, fosfori i ekstraktueshëm

Exchange of phosphorus across the sediment- water interface in Shkodra Lake

ABSTRACT

Aquatic ecosystems are affected by the presence of nutrients and especially phosphorus which is determined by many authors as a limiting element in eutrophication of natural waters. Sediments play an important role in the whole process of metabolism of phosphorus in the lake, acting as the

depository and as a source of phosphorus. Numerous studies have shown that the flow of phosphorus from sediment to the water layer is influenced by the characteristics of the water near the sediment layer which is important in the digestion of phosphorus from sediments.

Shkodra lake located on the border of the Albanian- Montenegrin has served as the object of study, which aimed to determine the content of phosphorus in the sediment and the water above the sediment layer and to determine the factors that constrain the passage of phosphorus from the sediment in the water layer near sediment.

Results of the analysis showed that phosphorus in the sediments of Lake Shkoder was mainly in the form of $\text{HCl} - \text{P}$ and the smaller amount of phosphorus was found to be in the form of $\text{NH}_4\text{Cl} - \text{P}$. Results showed that the transfer of phosphorus from the sediment in the water layer near its hinges by mixing water in the lake and the content of $\text{NH}_4\text{Cl} - \text{P}$ in sediments.

KEYWORDS: Shkodra Lake, formas of phosphorus, extractive phosphorus

Hyrje

Një numër variablash të jashtëm si prania e lëndëve ushqyese, stina dhe regjimi i rrjedhjes ndikojnë në strukturën dhe funksionin e ekosistemeve ujore (EDWARDS & WITHERS, 2007). Urbanizimi dhe intensifikimi i bujqësisë kanë shkaktuar, veçanërisht për fosforin, kalimin nga të qenit si lëndë ushqyese kufizuese për rritjen e bimëve në shumë liqene (STUTTER, LUMSDON 2008) praninë e tij në sasi të tepërt, duke shkaktuar “stress” për ekosistemet ujore përmes procesit të eutrofikimit (WITHERS, JARVIE, 2008). Shuma e të gjithë komponentëve të fosforit në ujërat natyrorë, fosfori total (TP), është i përbërë nga fosfori në trajtë të grimcave dhe në forma të tretshme.

Fosfori në trajtë grimcash është një kombinim i fosforit në trajtën e filtrateve organike dhe inorganike (përmasat e grimcave < 45 mikrometër), fosfori i tretshëm përbëhet nga fosfori i tretshëm joreaktiv dhe fosfori i tretshëm reaktiv (SRP). Fosfori që reagon me testin kolorimetrik (fosfomolibdatin e amonit), konsiderohet zakonisht si fosfori i tretshëm (bioavailable) dhe njihet si fosfori i tretshëm reaktiv ose ortofosfat. (REDDY et al. 1999; HOUSEET al. 1995) Sedimentet luajnë një rol të rëndësishëm në të gjithë procesin e metabolizmit të fosforit në liqen, duke vepruar si depozitues dhe si burim i fosforit. Studimet tregojnë se nën shumë liqene depozitimi i fosforit në sediment është proces që zhvillohet pothuajse gjatë gjithë stinëve. Megjithatë në liqenet me nivel të lartë eutrofië, çlirimi i fosforit mund të kalojë sedimentimin e tij për periudha të caktuara kohore pikërisht në kohën e përzierjes së ujërave (turnover), fluks ky që në shumë raste rezulton i mjaftueshëm për të ndikuar në procesin e

eutrofikimit (LENNOX, 1984). Studime të shumta kanë treguar se fluksi i fosforit nga sedimenti drejt shtresës ujore, ndikohet nga karakteristikat e shtresës ujore pranë sedimentit si pH, temperatura, potenciali redoks dhe aktiviteti mikrobiologjik. Ruajtja e fosforit në sedimente ujore është një faktor kryesor që rregullon gjendjen trofike në shtresën sipër sedimenteve në ujëra, në një shumëllojshmëri të gjerë të mjediseve (BOSTRÖM, 1988).

Liçeni i Shkodrës ndodhet në perëndim të gadishullit të Ballkanit, në kufirin Shqipëri – Mali i Zi dhe është lokalizuar në koordinatat gjeografike 40°10' gjerësi gjeografike veriore dhe 19°15' gjatësi gjeografike lindore. Liçeni ka një sipërfaqe të pasqyrës ujore që varion në kohë nga 350 në 500 km². Karakterizohet nga bregu perëndimor dhe jug-perëndimor që është kryesisht shkëmbor dhe bregu verior dhe lindor që është kryesisht fushor. Liçeni i Shkodrës është një liçen tipik fushor me thellësi mesatare që shkon nga 7 në 10 m, thellësia maksimale është 44 m. Janë gjetur një sërë punimesh që japin të dhëna për përqendrimin e fosforit në ujëra (BEKTESHI, 2011) dhe përqendrimin e formave të ndryshme të fosforit në sedimentet e liçenit të Shkodrës (BEKTESHI, 2007, KAPITI, 2012; KAPITI, 2013).

Ky punim ka për qëllim të studiojë ndikimin e formave të ndryshme të fosforit që ndodhet në sedimente dhe përqendrimin e fosforit që ndodhet në shtresën ujore pranë sedimentit, si dhe të paraqesë mekanizmin e kalimit të fosforit nga sedimentet e liçenit në shtresën ujore pranë sedimentit.

Materiali dhe metodat

Mostrat e ujit dhe të sedimenteve janë marrë gjatë muajve qershor, korrik dhe tetor, 2013 në tri pika në liçen. Mostrat e sedimenteve dhe shtresës së ujit mbi sediment janë marrë në pikat e shënuara në hartë në figurën 1. Për marrjen e mostrave është përdorur Ponar Gap. Pika 1 ndodhet pranë fshatit Stërbeq, pika 2 pranë fshatit Grizhë, pika 3 ndodhet në qendër të liçenit.

Mostrat e marra janë transportuar në laborator ku janë bërë analizat e sedimenteve për përmbajtjen e formave të ndryshme të fosforit dhe analizat e ujit për përmbajtjen e fosforit. Mostrat e sedimenteve janë pastruar nga gurët dhe fragmentet e bimëve. Mostrat e sedimenteve janë tharë në ajër, homogjenizuar



Figura 1. Pikat e marrjes së mostrave

në havan porcelani dhe janë situr në sitë me përmasa 71 mikrometër vrima. Përmbajtja e fosforit total dhe fraksioneve të fosforit $\text{NH}_4\text{Cl-P}$, NaOH-P dhe HCl-P janë përcaktuar sipas rekomandimeve të KAPANEN, 2008. Mostrat e ujit janë filtruar në filtër 45 mikrometër dhe analiza e fosforit ka vazhduar sipas rekomandimeve të literaturës. (APHA, 2002).

Rezultatet dhe diskutimi

Rezultatet e analizave jepen në tabelën 1 për format e fosforit në shtresën e ujit pranë sedimentit dhe në tabelën 2 për format e fosforit në sedimente

Tabela 1. Përqendrimi i formave të fosforit në shtresën ujore sipër sedimentit.

Mostrat	Muaji	SRP në mg/l	SP në mg/l	SUP në mg/l	TP në mg/l
M1	Qershor	0.262	0.480	0.218	0.524
	Korrik	0.131	0.532	0.401	0.784
	Tetor				0.330
M2	Qershor	0.206	0.392	0.186	0.450
	Korrik	0.104	0.516	0.412	0.660
	Tetor				0.368
M3	Qershor	0.596	0.695	0.099	0.640
	Korrik	0.104	0.330	0.226	0.920
	Tetor				0.330

Nga tabela vërehet se përqendrimi i fosforit të tretshëm reaktiv (SRP) varioi nga 0.104 në 0.596 mg/l ndërsa përqendrimi i fosforit total (TP) varioi nga 0.33 në 0.92 mg/l. Nga tabela shihet se vlera më e lartë për fosforin reaktiv të tretshëm u vërejt në qendër të liqenit në muajin qershor, ndërsa vlera më e ulët gjatë muajit korrik. Fosfori total paraqiti vlerë më të lartë gjatë muajit korrik në qendër të liqenit ndërsa vlerë më të vogël 0.33 mg/L gjatë muajit tetor. Këto vlera tregojnë se gjatë muajve të vjeshtës ujërat e liqenit nuk formojnë shtresime dhe përqendrimi i fosforit zvogëlohet, pasi ndodh përzierja e ujërave, ndërsa gjatë stinës së nxehtë të verës ujërat e liqenit veçanërisht në qendër ku thellësia është më e madhe krijojnë shtresime dhe nuk përzihen kështu që përqendrimi i fosforit në shtresën pranë sedimentit është më i lartë. Ky fenomen raportohet për disa liqene dhe nga BOEHRER and SCHULTZE, 2010.

Tabela 2. Përmbajtja e formave të fosforit në sedimente

Mostrat	Fraksioni ne mg/kg	Qershor 2013	Korrik 2013	Tetor 2013
M ₁	NH ₄ Cl - P	12.5	10.9	8.1
	NaOH - P	389.4	103.7	177.8
	HCl - P	502.6	398.4	533.2
	TP	1138.1	666.6	964.5
M ₂	NH ₄ Cl - P	9.9	13.3	8.8
	NaOH - P	299.3	170.9	157.2
	HCl - P	484.8	423.5	500.7
	TP	1124.2	993.7	1132.4
M ₃	NH ₄ Cl - P	9.1	16.1	9.4
	NaOH - P	214.6	145.0	129.2
	HCl - P	488.7	502.0	523.4
	TP	1026.4	1353.3	1231.9

Nga tabela vërehet se përmbajtja e Fosforit total në sedimentet e liqenit të Shkodrës varion nga 666.6 mg/kg sediment në 1353.3 mg/ kg sediment. Këto vlera të përmbajtjes së fosforit në sedimentet e liqenit të Shkodrës janë të krahasueshme me ato të raportuara nga KAPITI & BEKTESHI 2012 dhe KAPITI & BEKTESHI; 2013. Ndër ekstraktet e fosforit në sedimente sasi më e madhe e fosforit ekstraktohet nga HCl- fosfori i lidhur me Ca dhe Mg, e ndjekur nga fosfori i ekstraktueshëm nga NaOH–fosfori i lidhur me fe dhe Al. Përmbajtja më e ulët e fosforit në sedimente është pjesa që ekstraktohet më NH₄Cl- ose pjesa e fosforit e lidhur dobët me sedimentin. Është kjo sasi fosfori që ndodhet në sediment dhe që kryesisht kontribuon në përqendrimin e fosforit në shtresën ujore që ndodhet pranë sedimentit, pasi ky lloj fosfori kalon me lehtësi nga sedimenti në ujë (OLILA ET AL. 1995).

Për rezultatet e marra për përqendrimin e fosforit total në ujëra dhe përqendrimin e formave të ndryshme të fosforit në sediment, është vënë re një korelacion mjaft i lartë ndërmjet përqendrimit të fosforit total në ujëra dhe fosforit të ekstraktuar me NH₄Cl, koeficienti Pearson ka vlerën $r = 0.782$ ($P = 0.013$). Vija e regresit linear paraqitet në figurën 3. Vlera e R-Sq (adj)=55.6% tregon se 55.6% e variacionit të përqendrimit të TP në ujëra varet nga përqendrimi i P të ekstraktueshëm me NH₄Cl që ndodhet në sediment. Ky korelacion sugjeron se fosfori i lidhur dobët në sediment (fosfori i ekstraktueshëm me NH₄Cl),

është kontribuesi kryesor i fosforit në ujë.




Figura 2. Vija e regresit linear ndërmjet TP në ujë dhe NH₄Cl-P në sediment

Përfundime

Përmbajtja e fosforit në shtresën sipërfaqësore të sedimenteve të liqenit të Shkodrës varion nga 666.6 mg/kg sediment në 1353.3 mg/kg sediment. Përmbajtja e fosforit në shtresën ujore pranë sedimentit varion nga 0.33 në 0.92 mg/l. Rezultatet treguan se përmbajtja e fosforit në ujëra varet nga përzierja e ujit të liqenit. Në pranverë dhe vjeshtë kur ujërat e liqenit përzihen, përmbajtja e fosforit në shtresën ujore pranë sedimentit ishte e ulët ndërsa në verë kur nuk ndodh përzierja e ujërave përmbajtja e fosforit në shtresën ujore pranë sedimentit ishte e lartë.

Përmbajtja e fosforit në shtresën ujore pranë sedimentit, përcaktohet më së shumti nga sasia e fosforit në formë të lidhur dobët në sediment (NH₄Cl e ekstraktueshme).

Referencat

- APHA, 2002: Standard methods for examination of water and wastewater. APHA, AWWA, WEF, Washington DC 22nd.
- BEKTESHI, A. 2007: Përmbajtja e formave të fosforit në sedimentet e liqenit të Shkodrës. / Contents of the different forms of phosphorus in the sediments of Shkodra Lake. Buletini Shkencor i USH, Nr. 57, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 43-49.
- BEKTESHI, A. 2011: Përcaktimi i indeksit të gjendjes trofike (TSI) për Liqenin e Shkodrës / Determination of trophic state index (TSI) for

- Shkodra Lake. Buletini Shkencor i USH, Nr. 61, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 45 – 51.
- BOEHRER, B. AND SCHULTZE, M. 2010: Density stratification and stability. In : Lake ecosystem ecology: A global perspective a derivative of encyclopedia of inland waters. Editor Gene E. Likens, Elsevier inc.
- BOSTRÖM, B. ANDERSEN, J.M. FLEISCHER, S. & JANSSON, M. 1988: Exchange of Phosphorus Across the Sediment-Water Interface Developments in Hydrobiology Volume 48, pp 229-244
- CONLEY, D. J., HUMBORG, C., RAHM, L., SAVCHUK, O. P., & WULFF, F. 2002: Hypoxia in the baltic sea and basin scale change in phosphorus biogeochemistry. Environ. Sci. Technol. 36, 5315-5320.
- EDWARDS A.C., WITHERS P.J.A. 2007: Linking phosphorus sources to different types of water body. Soil Use Manage 23: 133–143.
- HOLDREN, G. C. AND AMSTRONG, D. E. 1980: Factors affecting phosphorus release from intact lake sediment cores. Environmental Science and technology, 14: 79-87.
- HOUSE, W.A., DENISON, F.H., SMITH, J.T., ARMITAGE, P.D. 1995: An investigation of the effects of water velocity on inorganic phosphorus influx to sediments. Environ Pollut 89: 263–271.
- KAPANEN, G. 2008: Phosphorus fractionation in lake sediments. Estonian Journal of Ecology, 57, 4, 244-255
- KAPITI, D., BEKTESHI, A. 2012: Forms and distribution of phosphorus in sediment of the Shkodra lake, Proceedings book of: International Conference on "Research and education – challenges toward future", Shkodra, ISBN:
- KAPITI, D., BEKTESHI, A. 2013: Phosphorus bioavailability in sediments of sludge-disposal Shkodra lake "Proceedings of 2nd International Conference on" Research and Education in Natural Sciences", Shkodra,
- LENNOX, L. J. 1984: Laboratory studies on sediment phosphorus release under varying mixing aerobic and anaerobic condition. Freshwater Biology, 14: 183-187.
- MORE, P. A., REDDY, K.R. AND GRAETZ, D.A. 1991: Phosphorus geochemistry in the sediment-water column of a hypereutrophic lake. Journal of Environ. Quality. 20: 869-875.
- OLILA, O.G., REDDY, K.R. & HARRIS, W.G. 1995: Forms and distribution of inorganic phosphorus in sediments of two shallow eutrophic lakes in Florida. Hydrobiologia 302: 147-161.
- REDDY, K.R., KADLEC, R.H., FLAIG, E., GALE, P.M. 1999: Phosphorus retention in streams and wetlands: a review. Critical Rev Environ

- SciTechnol 29: 83–146.
- STUTTER, M.I., LUMSDON, D.G. 2008: Interactions of land use dynamic river continuum conditions on sorption equilibria between benthic sediments and river soluble reactive phosphorus concentrations. *Water Res* 42: 4249–4260.
- WITHERS, P. J. A., JARVIE, H.P. 2008: Delivery and cycling of phosphorus in rivers: a review. *Sci Total Environ* 400: 379–395.

Përcaktimi i proteinave në qumësht me metodën Kjeldahl: Rezultate testimi ndërlaboratorik

Boci Ilirjana ¹, Bardhi Gentiana ²

¹Departamenti i Kimisë Industriale, Fakulteti i Shkencave të Natyrës,
Universiteti i Tiranës, Tiranë

²Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Tiranë

PËRMBEDHJE

Në kuadër të Projektit “Infrastruktura e Cilësisë në Vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi” IPA 2008, Laboratori i Qumështit dhe nënprodukteve të tij, pjesë e Departamentit të Cilësisë së Ushqimit në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në Tiranë, mori pjesë në një Test Proficience për krahasimin e rezultateve të përcaktimit të yndyrës, proteinës dhe lëndës së thatë të tretshme në qumështin e trajtuar termikisht (*UHT*). Morën pjesë gjithsej 8 laboratorë në këtë test ndërlaboratorik. Laboratori pilot (Laboratori i qumështit dhe nënprodukteve të tij në Fakultetin e Bioteknologjisë-Podgoricë, Mal i Zi) dërgoi 7 mostra tek secili nga laboratorët pjesëmarrës dhe pas marrjes së rezultateve, u kryen përpunimet statistikore. Në këtë artikull ne paraqesim punën e kryer nga laboratori i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Tiranë për përcaktimin e përmbajtjes së proteinës në 7 mostra qumështi të analizuar sipas Metodës Kjeldahl. Fillimisht u përcaktua koeficienti i rifitimit të azotit nga një solucion standard i acetanilidit për stadin e mineralizimit dhe rifitimin e azotit për stadin e distilimit duke analizuar solucionin standard të një kripe amoniumi.

Rezultatet e përfuara për të dyja testet janë paraqitur në këtë artikull. Rezultatet për përmbajtjen e proteinës për çdo mostër të analizuar jepen në tabelat përkatëse, si edhe rezultatet për vlerësimin e saktësisë, dmth krahasimin me rezultatet e referencës dhe përsëritshmërinë e arritur nga laboratorët pjesëmarrës. Vlera e referencës paraqet vlerën mesatare të vlerave të 8 laboratorëve. Në llogaritjen e vlerës mesatare, organizatorët bënë testin për përjashtimin e vlerave të papranueshme sipas testit statistikor të *Cochran & Grubb*. Diskutimi i rezultateve të arritura nga laboratori ynë dhe analizimi i shkaqeve për renditjen në këtë test proficience, jepen gjithashtu në këtë artikull.

Determination of protein in milk by Kjeldahl
method: interlaboratory study

ABSTRACT

Under the frame of IPA 2008 Project “Regional Quality Infrastructure in the Western Balkans and Turkey”, the Dairy Laboratory, part of Food Quality Department, in the Institute of Food Safety and Veterinary in Tirana, took part in a Proficiency Testing for comparison on fat, proteins and total solids in heat-treated milk (UHT). There were 8 laboratories that participated in PT. The pilot laboratory (Dairy Laboratory in Biotechnology Faculty- Podgorica Montenegro) sent 7 samples to each participant laboratories and after getting back the results, the statistical calculations were done. In this paper we have presented our work for proteins content determination in seven milk samples analyzed according to the Kjeldahl Method. First we determined the nitrogen recovery from acetanilide solution for the mineralization step and the nitrogen recovery for the distillation step by analyzing the ammonium salt solution.

The results obtained for both test are presented in the paper as well. The results for protein content for each sample analyzed are listed in the table as well as the results for accuracy assessment, i.e, comparison with the reference results and repeatability achieved by the individual laboratories. The reference value represents the average value of the eight participant laboratories. In calculating the averages, the organizing body made the test for excluding the outliers according to the Cochran & Grubb’s statistical tests. Discussion of our results for protein content determination are presented at the end of this paper.

FJALET KYÇE: Test profiçience, proteine, metode Kjeldahl, koeficient rifitimi

Hyrje

Në kuadër të aplikimit të Sistemeve të Menaxhimit të Cilësisë, Testet e Profiçiences (*PT*) janë bërë një mjet i rëndësishëm dhe i vlefshëm për krahasimin e rezultateve midis laboratorëve dhe për të verifikuar në këtë mënyrë kompetencën teknike të laboratorëve të testimit. Veç kësaj, në kërkesat e akreditimit sipas Standardit ISO/IEC 170125 laboratorëve u kërkohet të marrin pjesë në Testet e Profiçiences pavarësisht nga aktivitetet e tjera të sigurimit të cilësisë për të kontrolluar vlershmërinë e rezultateve të testimit.

Ky artikull përshkruan rezultatet analitike në përcaktimin e proteinës në qumështin UHT të kryer në Laboratorin Analitik të Departamentit të Cilësisë së Ushqimit në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në Tiranë.

Këto rezultate u arritën nga pjesëmarrja në një Test Proficiencie si pjesë e Protokollit të Testimit të Proficiences 5 (PT 5) organizuar nga Laboratori i Qumështit, Fakulteti i Bioteknologjise-Podgorice, Mal i Zi. Ky laborator u caktua si “Laborator Pilot” nga Laboratori i Metrologjisë dhe Cilësisë, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike-Ljubljane, Slloveni si koordinator i Projektit IPA 2008 “Infrastruktura e Cilësisë në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi”. Laboratorëve pjesëmarrës iu kërkua të kryenin tri teste në të njëjtën mostër: yndyrë, proteinë dhe lëndën e thatë.

Ky artikull jep dhe analizon rezultatet e arritura në përcaktimin e proteinës. 8 laboratorë morën pjesë në këtë Test Proficiencie. Laboratori pilot dërgoi 7 mostra tek secili laborator pjesëmarrës dhe pas marrjes së rezultateve, u bë llogaritja dhe vlerësimi statistikor. Çdo laborator ka kodin e tij individual. Kodi i laboratorit tonë ishte L8.

Materiali dhe metoda

Materiali i provës

7 mostra qumshti të trajtuara termikisht (qumësht UHT) të mbledhura nga tregu i brendshëm, të ruajtura në +4° C para shpërndarjes ishin materiali i provës për këtë test proficiencie. Sasia e mostrës ishte 100 ml/secila.

Enti organizator i dërgoi mostrat tek secili pjesëmarrës pas vlerësimit të homogjenitetit në përputhje me *ISO Guide 43*. Integriteti i mostrave gjatë tërë procesit të shpërndarjes deri tek laboratorët e testimit u garantua duke i ambalazhuar në shishe polietilene të mbyllura hermetikisht dhe të konservuara me shtesë *Bronopol*[®] në përqendrim 0.02%. Afati për raportimin e rezultateve ishte 5 ditë pune, duke filluar nga momenti i mbërritjes së tyre në laborator. Pjesëmarrësve iu kërkua të kryenin testet në dublikatë për secilën mostër dhe të raportonin metodën analitike të përdorur.

Metoda analitike

Laboratori ynë përdori Metodën Kjeldahl (*ISO 8968 /IDF 20-1; 20-3*) për përcaktimin e përmbajtjes së proteinës së përgjithshme në 7 mostrat e qumështit. Disa ndryshime u bënë, për shkak të mungesës së reagenteve apo mjeteve të nevojshme. Nuk u përdor potenciometër për dallimin e pikës fundore të reaksionit gjatë stadit të titullimit, por rezultatet u raportuan duke u bazuar në dallimin e pikës fundore në mënyre vizuale.

Pajisjet

U përdor një Aparat Kjeldahl gjysmëautomatik “Velp Scientifica” me dy pjesë të veçanta: bllokun e disgregimit me 6 vende dhe njësinë e distilimit. Stadi i titullimit të amoniakut të çliruar nga stadi i distilimit u krye duke përdorur acid sulfurik. Dallimi i pikës fundore u krye në mënyrë vizuale me anë të ndryshimit të ngjyrës së indikatorit Tashiro nga jeshile në violet.

Prova e saktësisë

Para testimit të mostrave u përcaktuan koeficientet e rifitimit të azotit amoniakal për dy stadet e procedurës. Protokollin e metodës kërkon analizën e një tretësire të kripës së amoniumit dhe një tretësire të triptofanit si standard të brendshëm të kontrollit të cilësisë me një rifitim minimal të azotit midis 99-100% për kontrollin e stadi të distilimit dhe të paktën 98% për kontrollin e stadi të disgregimit duke përdorur tretësirë triptofani. Për shkak të mungesës së triptofanit, u përdor acetanilid për kontrollin e stadi të disgregimit. Sidoqoftë rezultatet e procedurës së autokontrollit nuk u kërkuan të raportohen në raportin final.

Procedura e testimit

Koha totale për disgregimin e mostrës ishte 2 orë. Përdorimi i sulfatit të bakrit si katalizator për përcaktimin e proteinës në qumësht është propozuar vite më parë.(GRAFFIN & HORWITZ,1988). Në të vërtetë u rekomandua sasia prej 0.2 g\ 5 ml acid. Që atëherë ky katalizator është përdorur gjerësisht për përcaktimin e proteinës në mostra të ndryshme ushqimore duke zëvendësuar me sukses oksidet toksike të merkurit apo dhe selenin metalik. Laboratori ynë ka përdorur gjerësisht sulfatin e bakrit si katalizator për një numër të madh mostrash ushqimore dhe rezultatet kanë qenë mëse të kënaqshme, megjithëse koha për disgregim shpeshherë ka rezultuar më e gjatë se sa kur përdorej selen për disa lloj produktesh ushqimore.

Një sasi mostre prej 5 ml e përzier mirë u përdor për analizë. Për të shmangur disgregimin e vrullshëm, u bë një programim i moderuar i temperaturës së bllokut të disgregimit. Mostrat u mbajtën në 150° C për 15 minuta dhe pastaj temperatura u lejua të ngrihej deri në 400° C. Disgregimi vazhdoi për 20 minuta të tjera në temperaturën e arritur 400° C. Një sasi shtesë H₂O₂ e përmirësoi mjaft intensitetin e disgregimit.

Rezultatet dhe diskutimi

Provat e saktësisë- Përcaktimi i koeficientëve të rifitimit

Rezultatet për koeficientët respektivë të rifitimit jepen në tabelën 1.

Tabela1. Rifitimi në %

Stadet analitike	Stadi i disgregimit me acetanilide	Stadi i distilimit me sulfat ferro amoniakal- hidrate
Rifitimi ne %	99.40	99.80

Siç tregohet në tabelën 1, rifitimi i azotit për stadin e distilimit i arritur nga laboratorit ynë, duke përdorur tretësirë sulfat ferro amoniakal- 6- hidrat (Kripa Mohri) ishte mjaft i mirë në 99.8%.

Ky rifitim u konsiderua si i pëlqyeshëm për të dhënë rezultate të besueshme në stadin e distilimit. Rifitimit i azotit për stadin e disgregimit duke përdorur acetanilid rezultoi në 99.4%. Të dy koeficientët e rifitimit rezultuan mjaft të lartë dhe në përputhje me protokollin e procedurës së testimit (GRAFFIN & HORWITZ,1988).

Rezultatet e mostrave

Rezultatet e arritura nga laboratorit ynë jepen në tabelën 2. Rezultatet e mostrave tregojnë që megjithëse laboratorit ynë shfaqti një performancë të mirë dhe të krahasueshme me 8 laboratorët e tjerë, përpikmëria nuk ishte e kënaqshme dhe për me tepër kishte gabime sistematike.

6 nga shtatë mostrat paraqitnin vlera më të larta krahasuar me vlerën e referencës respektive pak a shumë në të njëjtën masë përveç mostrës së fundit, e cila rezultoi me të njëjtën vlerë me vlerën e referencës.

Tabela 2. Rezultatet e përmbajtjes së proteinës së arritur nga laboratorit ynë shprehur në g/100 g qumësht për 7 mostrat

Mostra	1	2	3	4	5	6	7
Testi 1, g proteine/100 g qumësht	3.48	3.63	3.59	3.8	3.61	3.4	3
Testi 2, g proteine/100 g qumësht	3.54	3.59	3.59	3.78	3.59	3.42	3.04
Vlera mesatare	3.51	3.61	3.59	3.79	3.6	3.41	3.02
Vlera referencës	3.24	3.34	3.37	3.39	3.24	3.22	3.03

Shmangia standarde e përsëritshmërisë së laboratorit tonë ishte 0.024

krahasuar me 0.013 sipas të dhënave të kërkuara nga metoda e testimit (Fig 1) (MIRECKI, 2010).

Tabela 3 jep të dhëna të tjera të nevojshme për të interpretuar rezultatet tona lidhur me saktësinë dhe përpikmërinë.




Fig.1 Paraqitja grafike e shmangies standarde për përcaktimin e proteinës për 8 laboratorët.

Tabela 3. Të dhëna për vlerësimin statistikor të rezultateve tona nga Testi i Proficiencës

Numri i mostrave	Diferenca midis dublikatave min	Diferenca midis dublikatave max	Diferenca mesatare midis dublikatave	Shmangia standarde përsëritshm.	Vlera mesatare e të gjithë dublikatave tona	Ndryshimi mesatar midis laboratorit tonë dhe referencës
7	-0.06	0.04	-0.006	0.024	3.50	0.2473

Lidhur me saktësinë, Testi Statistikor i Studentit për $P < 0.01$ ($t_{\text{test}} = 4.808 > t_{\text{tab}} = 3.71$), tregonte prezencën e gabimeve sistematike sinjifikative.

Sidoqoftë asnjë vlerë e papranueshme- *outlier*- nuk rezultoi në vlerat tona, bazuar kjo në testin statistikor të Cochran dhe Grubb (MIRECKI, 2010).

Duke analizuar rezultatet e testimit me qëllim identifikimin e shkaqeve të

mundshme, ne kontrolloam të gjitha stadet e procedurës.

Vlerat e larta të koeficientit të rritimit të marra nga ne mbuluan problemet e tjera të mundshme gjatë stadeve të mëtejshme të testimit të mostrave reale. Problemet e mundshme mund të kenë qenë ndër të tjera, tretësira jo e saktë titulluese (më e holluar se ajo e pretenduar), papastërtia e reagenteve të përdorur apo dallimi jo i qartë i ndryshimit të ngjyrës së indikatorit gjatë stadi të titullimit. Përdorimi i një pH metri do të kishte rezultuar më i vlefshëm.

Pëfundime

Testet e proficiencies janë një mjet shumë i rëndësishëm për laboratorët analitike për të garantuar rezultate të besueshme dhe të qëndrueshme. Ky test proficiencies ku laboratorin ynë mori pjesë, rezultoi mjaft i dobishëm për të vlerësuar metodën analitike të përcaktimit të proteinave në matricën ngjashme me anë të Metodes Kjeldahl, duke lejuar të identifikohen burimet e mundshme të gabimeve gjatë analizës. Për më tepër kjo është shumë e rëndësishme, pasi Metoda Kjeldahl, shërben për ne si metodë e brendshme reference, meqë ne përdorim Analizatorin e Qumështit për përcaktime rutinë të përmbajtjes së proteinave të përgjithshme në qumësht.

Referencat

GRAFFIN & HORWITZ. 1988: Determination of Protein Content by Kjeldahl Method. Journal of AOAC, vol.71, nr.5:893-897
ISO 8968 /IDF 20-1;20-3, “ Nitrogen (total) in Milk by Kjeldahl method ”
MIRECKI, S. 2010: Proficiency testing protocol (PT 5). Results Sheet

Përcaktimi i mbetjeve të pesticideve klororganike në lumin Buna dhe bregdetin e Velipojës

Anila Neziri¹, Eralda Dano²

¹Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Fakulteti i Shkencave të Natyrës

²Universiteti "Vitrina", Fakulteti i Mjekësisë

PËRMBLEDHJE

Bregdeti i Velipojës shtrihet përgjatë detit Adriatik në Veri - Perëndim të Shqipërisë, afër lumit Buna, i cili është lumi i vetëm i lundrueshëm në Shqipëri. Burimet kryesore të ndotjes antropogjene në zonë janë: bujqësia, mbeturinat e ngurta, ujërat e zeza dhe të gjitha ujërat e transportuara nga liqeni i Shkodrës dhe lumit Drin përmes lumit Buna në detin Adriatik. OCP-të janë klasat më të njohura të ndotësve organikë të qëndrueshëm (POP-et), që për shkak të potencialit për t'u akumuluar në zinxhirin ushqimor, shkaktojnë efekte të dëmshme për njerëzit dhe kafshët. Rezultatet e analizave kimike të paraqitura në këtë punim tregojnë praninë e pesticideve klororganike (OCP) në ujin e bregdetit të Velipojës dhe deltën e Bunës, në 18 mostra të ujit sipërfaqësor për 6 stacione të kampionimit në tri sezona të 2011-2012. OCP-të janë identifikuar dhe kuantifikuar në ujë duke përdorur metodën e kombinuar ekstraktimit të lëng-lëng (LLE) dhe GC- μ ECD të analizave instrumentale.

FJALË KYCE: POPs, GC- μ ECD, efekte të dëmshme

Determination of organochlorine pesticides residues in river Buna and Velipoja coast

ABSTRACT

Velipoja coast lies along the Adriatic coastline in the North – West of Albania, near Buna River, which is the only navigable river in Albania. The main anthropogenic pollution sources in the area are agriculture, solid waste, sewage and at all waters transported from the Lake Shkodra and river Drin through the Buna River to the Adriatic Sea. OCPs are among the most widely known class of persistent organic pollutants (POPs) because of their ubiquity,

potential for magnification in the food chain, and harmful effects on humans and wildlife. The results of chemical analyses presented in this paper show the presence organochlorine pesticides (OCP) in the Velipoja coast water and delta Buna in 18 surface water samples at 6 sampling sites were collected in three seasons of 2011-2012. OCPs were identified and quantified in the water by using combined method LLE and GC- μ ECD instrumental analyses.

KEYWORDS: POPs, GC- μ ECD, harmful effects

Hyrje

Direktiva për Sistemet Ujore (WFD) e adoptuar nga Komisioni Evropian në vitin 2000, është një sistem legjislativ për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë të të gjithë burimeve ujore, duke përfshirë liqenet, lumenjtë, ujërat e përkohshëm, bregdetarë dhe ujërat nëntokësorë në Bashkimin Evropian. Sistemi synon të zëvendësojë pjesën më të madhe të legjislacionit ujqor ekzistues me qëllim që në 2015 të realizohet “good quality status” në të gjithë ujërat sipërfaqësorë, nëntokësorë dhe bregdetarë të Evropës”. (WFD, 2000). Zona e grykëderdhjes së lumit Buna dhe e bregdetit të Velipojës është e ekspozuar ndaj ndikimit të fortë të lëvizjeve të ujit dhe është e karakterizuar nga ndryshimet e shpeshta dhe periodike të kushteve fizike dhe kimike. Bregu është zhvilluar në mënyrë tipike si plazh me rërë. Problemet serioze në ujërat bregdetare janë shkaktuar për shkak të ndikimit antropogjen. Problemi i pazgjidhur i asgjësimit të ujërave të zeza të çon në ndotjen me baktere toksike dhe eutrofikim. (REGNER et al., 2001 & 2002). Pjesa juglindore e bregut të Adriatikut është shumë e interesante për hulumtime, sepse bregdeti Malazet dhe Shqiptar, janë studiuar pak për ndotësit e mundshëm. (Joksimoviq, 2010). Pesticidet klororganike dhe PCB-të janë ndotës të përhapur dhe janë përcaktuar larg nga burimi i tyre i ndotjes për shkak të transportit nga atmosfera dhe uji (ZHANG et al., 2007). Prania e OCP-ve në mjedis është pasojë e natyrës së tyre lipofilike dhe të qëndrueshme. Këto veti shkaktojnë bioakumulimin e tyre në indet e biotës duke çuar në rritje të përqendrimit përmes zinxhirit ushqimor. (DE VOOGT et al., 1990).

Vihet re një diferencë në profilin e pesticideve midis Velipojës (deti Adriatik) dhe lumit Buna për shkak të influencës së rrymave ujore në detin Adriatik (NURO and Marku 2012). Nëpërmjet lumit Buna kalojnë 13 specie migratore të peshkut drejt detit. Numri total i individëve të zogjve të numëruara në Bunës është rreth 8 000 (DHORA et al., 2001). Qëllimi i studimit është përcaktimi i mbetjeve të pesticideve klororganike në ujin e lumit Buna dhe bregdetin e Velipojës.

Materiali dhe metodat

Pikat e kampionimit u zgjedhën duke u bazuar në influencën antropogjenike në zonën e studiuar. (Figura 1). Mostrat e ujit u morën në tri periudha të ndryshme tetor, qershor dhe shtator 2011-2012.



Figura. 1 Harta e pikave të kampionimit (: V1(Plazhi ADA), V2(Qendër), V3 (Derdhja e Bunës), V4 (Fishta), V5 (Zues), V6(Dajç)

Pikat e kampionimit në lumin Buna janë marrë për të parë ndikimin e bujqësisë në praninë e pesticideve dhe më pas për t'i krahasuar këto vlera me mostrat e marra në bregdet. Në zonën e bregdetit të Velipojës vihet re një rritje e aktiviteteve private si bare dhe restorante për qëllime turizmi, të cilat mbetjet e ngurta, ujërat e zeza dhe të bardha i derdhin në det. Enët që përdorëm për marrjen e mostrave u siguruan nga vetë laboratori. U përdorën shishe xhami 500 ml, të cilat një ditë para ekspeditës u shplanë me n-Hekzan. Për marrjen e mostrave u shfrytëzua sampleri UWITEC, që lejon përdorimin e enëve të ndryshme për marrjen e mostrave. Ekstraktimi që u realizua me metodën lëng-lëng dhe procedura e ndjekur është e tillë. Në një hinkë ndarëse u hodh 500 ml ujë të mostrës së marrë ku më parë në të u hodhën 10 μ l standard i brendshëm TCB (200 μ g/ μ l). Si tretës ekstraktues u përdor n-hekzani për analizën gjurmë. Në hinkën ndarëse u hodhën 20 ml

n-hekzan. Ekstraktet u pastruan në një kolonë Florisil i aktivizuar. Ekstraktet u eluan me 7 ml n-hekzan. Të gjithë eluatet u mblodhën në balona 50 ml dhe u bë avullimi i tyre në Rotary Evaporator (LABOROTA 4000, Heidolph) deri në 5 ml. Më pas ekstraktet u transferuan në provëza qelqi dhe u evaporizuan me azot deri në 1 ml. Pastaj ekstrakti u hodh në viale kromatografike për t'u injektuar në mënyrë automatike në GC-ECD. Pasi u realizua përqendrimi i ekstrakteve deri në 1 ml u bë injektimi në gazkromatograf. Injektimet u realizuan në aparatën Agilent 7890 i pajisur me detektor me kapje elektronesh ^{63}Ni (μECD). Metoda e injektimit ishte "split" dhe si gaz mbartës u përdor azoti dhe u përdor kolona e tipit HP-5MS (5% fenil metilsiloksani).

Rezultatet dhe diskutimi

Në figurën 2 paraqiten përqendrimet mesatare të HCH-ve, ku vihet re se përqendrimi i lindanit i kalon vlerat e lejuara për të gjitha pikat e kampionimit. Përqendrimet e alfa-HCH dhe beta -HCH janë relativisht të ulëta, gjë që tregon se ato janë degraduar me kalimin e viteve. Vlerat më të larta vihen re tek pikat V5 dhe V6 ku bujqësia është më e zhvilluar. Përqendrimet mesatare të HCH-ve variojnë nga 13.02 -674 ng/L.




Figura 2. Përqendrimet mesatare të HCH-ve

Përqendrimet e DDT dhe metabolitëve të saj paraqiten në figurën 3. Nivelet e DDT-ve janë më të larta në pikat V5 (Zues), V6 (Dajç) ku dhe bujqësia është e zhvilluar. Përqendrimet më të larta paraqet 2,4 -DDE. Edhe në figurën 4 vihet re se përqendrimet e heptaklorit dhe HCB-së janë më të larta

në pikat e lumit Buna dhe paraqiten në nivele të ulëta në pjesën e bregut të detit. Nivelet e HCB arrijnë vlera të larta deri në 1550 ng /L. Në figurën 5 tregohen përqendrimet totale të OCP-ve dhe vihet re që përqendrimet e tyre janë më të larta në pikat V6, V5 dhe V3. Profili i pesticideve në sedimentet e Velipojës tregoi përqendrime të larta të HCH-ve heptaklorit të ndjekura nga DDT-të dhe aldrin. (NURO and MARKU 2012).




Figura 3. Përqendrimet mesatare të DDT dhe metabolitëve të saj




Figura 4 Përqendrimet mesatare të heptaklor dhe HCB




Figura 5. Përqendrimet totale të OCP-ve

Përfundime

Nivelet maksimale për pesticidet klororganike në mostrat e ujit të analizuar janë gjetur për heksaklorbenzen (HCB) në stacionin Zues me (1.5 µg/L), por u vu re që ky pesticid ishte i përhapur në vlera të larta edhe në pikat e tjera të lumit Buna si në Dajç, Derdhja e Bunës që lidhet me zhvillimin e bujqësisë në këto zona. Këto nivele të larta mund të shpjegohen me përdorimin edhe në ditët e sotme të HCB. Nivele minimale u vunë re për DDT dhe heptaklor në të gjitha pikat e kampionimit gjë që tregon se këto pesticide janë degraduar dhe nuk po përdoren në ditët e sotme. Edhe sasia totale e pesticideve ishte më e madhe për zonën e Zuesit dhe Dajçit. Përqendrimet e lindanit janë relativisht të larta në të gjashtë stacionet duke kaluar vlerat vlerat e lejuara të Komunitetit Evropian për ujërat sipërfaqësorë.

Referencat

- DE VOOGT, P., WELLS, D.E., REUTERGARDH, L., BRINKMAN, U.A.TH.(1990): Biological activity, determination and occurrence of planar, monoortho PCBs. Int. J. Environ. An. Ch. 40, 1
- DHORA, DH., BEQIRAJ, S., & DHORA, D. 2001: Report on biodiversity of river Buna : Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe (REC), Hungary. Tirana
- JOKSIMOVIC, D. 2010: Eutrophication in Sea Water of the Montenegrin

Coast at Adriatic Sea in 2005-2007; BALWOIS 2010 – Ohrid, Republic of Macedonia.

NURO, A; MARKU, E. 2012: Study of Organchlorinated pollutants in Sediments of North Albania, International Journal of Ecosystems & Ecology Sciences, Vol. 2 Issue 1, p15

REGNER, D., VUKSANOVIĆ, N., STJEPČEVIĆ, B., DUTINA, M. AND JOKSIMOVIĆ, D. (2002): Seawater quality and the level of eutrophication in the Montenegrin costal sea. Studia Marina.

WFD 2000, <http://ec.europa.eu/environment/Water/Water-framework/>

ZHANG, G., LI, J., CHENG, H.R., LI, X.D., XU, W.H., JONES, K.C.(2007). Distribution of organochlorine pesticides in the northern South China Sea: implications for land outflow and air–sea exchange. Environmental Science and Technology 41, 3884–3890.

Vlerësimi i parametrave mikrobiologjikë dhe fiziko-kimikë i ujërave të liqenit të Shkodrës dhe të lumenjve Drini e Buna

Nevila Bushati*, Adem Bekteshi*, Fiqiret Bushati*, Margarita Hysko**

*Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Fakulteti i Shkencave të Natyrës

**Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Departamenti i Biologjisë

PËRMBLEDHJE

Cilësia e ujërave të liqenit të Shkodrës, lumit Buna dhe Drin ka qenë objekt i studimit të këtij punimi. Për një periudhë tri vjeçare 2010-2012, janë përcaktuar disa karakteristika fiziko-kimike dhe mikrobiologjike të këtyre ujërave.

Rezultatet e analizave treguan se ujërat e studiuara kishin karakter të lehtë bazik, gradë të ulët mineralizimi në periudhën në studim, temperatura mesatare rezultoi 20°C.

Nga shpërndarja probabilitare e koliformëve totalë të përcaktuar, ujërat e studiuara përmbushin kërkesat për klasifikim në Klasën A të Direktivës 76/160/EC. Përsa i përket vlerave mesatare të treguesve mikrobiologjikë *MPN/E.coli*, *Escherichia coli*, *Enterokokë intestinalë*, klasifikohen ndërmjet Klasës A dhe B të Direktivës 76/160/EC dhe në Klasën A të Direktivës 2006/7/EC, si ujëra që përdoren për larje.

Evaluation of microbiological and physico-chemical parameters
of Lake Shkodra waters, Drini and Buna rivers

ABSTRACT

Water quality of Lake Shkodra, Buna and Drin River has been the subject of this study. For a three years period 2010-2012 have been defined physico-chemical and microbiological characteristics of these waters.

Results of the analysis showed that studied waters had a slight basic character, low-grade of mineralization and the average temperature in the study period resulted -20.

From the probability distribution of a total coliform studied waters meet the

requirements for classification in Class A of Directive 76/160/EC. Regarding the average values of microbiological indicators *MPN / E. coli*, *Escherichia coli*, *intestinal enterococci* studied waters can be classified between Class A and B of Directive 76/160/EC and Directive 2006/7/EC Grade A as water used for washing

Hyrje

Karakteristikat fiziko-kimike dhe mikrobiologjike të ujërave të pellgut ujëmbledhës të liqenit të Shkodrës, nuk ndikohen vetëm nga ndotjet antropogjene, por dhe nga ndryshimi i kushteve atmosferike, veçanërisht kur shoqërohen me shtimin e prurjeve, të përrenjve dhe të lumenjve që derdhen në liqen, e theksuar kjo në stinën e pranverës dhe të vjeshtës nga shtimi i reshjeve të shiut, dëborës, erozionit, përmytjeve etj (BUSHATI 2013). Mikroorganizmat më të përdorura si tregues të ndotjes fekale për ujërat sipërfaqësorë janë bakteret koliforme, sidomos *Escherichia coli* dhe koliformët e tjerë fekale (CHAPMAN 1992). Prania e *Escherichia coli* dhe *Enterokokëve intestinalë* në ujërat sipërfaqësorë varet nga derdhja e ujërave të zeza, bujqësia, mbeturinat e kafshëve, shpërlarja e sipërfaqes së tokës gjatë reshjeve etj (TODAR, 2007). *Enterokokët intestinalë* janë përdorur për të diferencuar ndotjen fekale me prejardhje nga njeriu nga ajo e kafshëve me gjak të ngrohtë. Ky artikull paraqet një vlerësim të vlerave për parametrat fiziko-kimikë dhe mikrobiologjike të liqenit të Shkodrës dhe të lumenjve Drini e Buna. Vlerësimi i cilësisë së ujërave është bërë duke krahasuar Direktivën e vjetër 76/160/EC me Direktivën e re 2006/7/EC të Parlamentit Europian, e cila ka si qëllim ruajtjen, mbrojtjen, përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut.

Materiali dhe metodat

Marrja e mostrave është bërë një herë në muaj në periudhën mars-korrik 2010-2012. Stacionet e monitorimit u përzgjedhën në bazë të ndikimit të burimit të ndotjeve antropogjene duke u pozicionuar në afërsi të zonave të banuara (Fig. 1). Marrja e mostrave të ujërave dhe ruajtja, u realizua në përputhje me metodat standarde të ekzaminimit të ujërave (APHA, AWWA, WEF 1995; WPCF 1998). *pH*, *temperatura* dhe *konduktiviteti* u përcaktuan “*in situ*” nëpërmjet pajisjeve të sistemit AQUALYTIC, ndërsa *turbiditeti* u përcaktua me Turb 430 IR/T. Për vlerësimin mikrobiologjik u përdoren dy metoda standarde, metoda e MPN-së me tuba të shumtë fermentimi në terren laktoze sipas (ISO-8199, 1986) dhe metoda e filtrimit me pompë vakuumi me membrana nitroceluloze




Figura 1. Pikat e marrjes së mostrave

sipas (AWWA 1992). *Escherichia coli* në mostrat e ujërave u përcaktua nga vlerësimi statistikor i quajtur *Most Probable Number (MPN)*, që është numri më i mundshëm i koliformëve në 100 ml ujë (WILRICH, 2010). 10 mL mostër uji u inokulua në tri tubat e parë, të cilat përmbajnë laktozë dyfish të përqendruar, 1mL ujë u inokulua në serinë e dytë me nga tri tuba, të cilat përmbajnë laktozë njëfish të përqendruar dhe 0,1 mL ujë u inokulua në tri tubat e tretë, të cilat përmbajnë terren laktozë njëfish të përqendruar. Mbas inokulimit u realizua vendosja e tubave në termostate për 48 orë në temperaturën 44°C. Rezultatet raportohen si *Most Probable Number (MPN)/100 ml ujë*, (APHA/AWWA, 1998). Gjatë aplikimit të analizave standarde u

zbatuan rekomandimet Evropiane: ISO 8199 (1986); ISO 5667-2 (1991); ISO 7704 (1985) ; ISO 9308-1 (2000) ; ISO 9308-2 (1990).

Metoda tjetër e përdorur është metoda e membranës së filtrit me pompë vakuumi. Nëpërmjet hinkave sterile, u filtruan sasi uji prej 100 ml në filtrat prej nitroceluloze me pore 0,45 µm, në të cilën mbetën bakteret. Filtrat me përmbajtjen e ujit të filtruar u vendosën në terrenet, Endo-Agar/koliformë totalë, për 24 orë, temperatura 37 °C; në terrenin Endo-Agar/*Escherichia coli* për 48 orë, temperatura 44.5°C. Slanetz-Bartley/*Enterokokë intestinal* për 48 orë në temperaturën 44.5°C.

Tabela 1. Direktiva e vjetër 76/160/EEC për ujërat sipërfaqësorë

	A	B	C
Parametër	Cilësi e shkëlqyeshme	Cilësi e mirë	E mjaftueshme
<i>Streptokoku fekal (cfu/100ml)</i>	50 koloni/100 ml	50-100 koloni/100ml	Mbi 100 koloni/100ml

<i>Escherichia coli</i> (cfu/100ml)	100 koloni/100 ml	100-2000 koloni/100ml	Mbi 2000 koloni/100ml
--	-------------------	-----------------------	-----------------------

Tabela 2. Direktiva 2006/7/EC e Parlamentit Europian

	A	B	C
<i>Parameter</i>	Cilësi e shkëlqyeshme	Cilësi e mirë	E mjaftueshme
<i>Enterokokë intestinal</i> (cfu/100ml)	200 (*)	400 (*)	330 (**)
<i>Escherichia coli</i> (cfu/100ml)	500 (*)	1000 (*)	900(**)


(*) bazuar në 95 % e vlerësimit, (**) bazuar në 90% e vlerësimit

Rezultatet dhe diskutimi


Rezultatet e marra paraqiten në formën e shpërndarjeve probabilitare fig. 2 (a-g). Vlerat e vërejtura të parametrave të përcaktuara nuk përputhen me shpërndarjen probabilitare normale për $P < 0.05$. Në rastin e pH predominojnë vlerat me pH lehtësisht bazik, 50% e matjeve kanë vlerë më të madhe se 8.5. Kjo vlerë pH lehtësisht bazike e ujërave të liqenit është raportuar dhe nga punimet e tjera të gjetura (BEKTESHI, 2000; 2002; BABANI, 2009; RIVA, 2010). Gjatë periudhës së matjeve vlera e pH varioi nga 7.36 në 8.94 njësi pH. Në periudhën e matjeve temperatura e ujit varioi nga 12.1°C në 26.9°C ku predominuan vlerat e temperaturës mbi 20°C, kjo sepse matjet janë bërë kryesisht në periudhën e nxehtë të vitit. Temperatura në këto ujëra konfirmohet dhe nga punimet e tjera të gjetura për liqenin e Shkodrës dhe lumenjtë Drini dhe Buna nga autorët (BEKA, 1994; BABANI, 2009; TADIC, 2010).

Vlerat e turbiditetit paraqiten me një mesatare prej 1.94 NTU. Gjatë periudhës së matjeve vlera e turbiditetit varioi nga 0.34 në 5.28 njësi NTU/FNU. Nga punimet e ndryshme rreth liqenit ka rezultuar se vlera mesatare e turbiditetit është 1.7 NTU (ANONIMOUS, 2006).


Vlera mesatare e përcjellshmërisë elektrike gjatë periudhës së matjeve ishte 212.5 $\mu\text{S}/\text{cm}$, e cila konfirmon se ujërat e liqenit, lumit Buna dhe lumit Drin janë ujëra me shkallë mineralizimi të ulët. Vlera e përcjellshmërisë në këto ujëra konfirmohet dhe nga punimet e mëposhtme (BEKTESHI, 1997-2000; TDA, 2006). Gjatë periudhës së matjeve vlera e përcjellshmërisë varioi nga 180.1 deri në 298.40 $\mu\text{S}/\text{cm}$.




a.



b.




c.




ç.

Figurë 2.(a,b,c,ç). Probabiliteti i shpërndarjes së vlerave, (a-temp, b-përcjellshmëria, c-pH, ç-turbiditeti)


Në figurat 3 (a-ç) paraqitet shpërndarja probabilitare e parametrave mikrobiologjikë të përcaktuar.



a.



b.



C.

Ç.

Figurë 3.(a,b,c,ç). Probabiliteti i shpërndarjes së vlerave, (a-*E.intestinal*, b-*E.coli*, c-koliformë total, ç.-MPN).

Në rastin e koliformëve totalë, 95% e vlerave janë më të vogla se sa 500 CFU/100 ml. Vlera mesatare e koliformëve totalë gjatë periudhës së matjeve ishte 242.4 e matur në njësi CFU/100 ml ujë. Duke u bazuar në vlerat e sugjeruara nga standardet evropiane (DIREKTIVA 76/160/EEC) tabela 1, për përmbajtjen e koliformëve totalë mund të thuhet se ujërat e liqenit, lumit Buna dhe lumit Drin klasifikohen në Klasën A, e cila lejon deri në 500* CFU/100 ml (* bazohet në 80% e përputhjes me mostrën). Vlerat e koliformëve totalë në këto ujëra konfirmohen dhe nga punimet e tjera të gjetura për liqenin e Shkodrës dhe lumenjtë Drini dhe Buna (ANONIMOUS, 2001; MIJOVIC, 2006; BUSHATI, 2006). Gjatë periudhës së matjeve vlera e koliformëve totalë varioi nga 24.0 në 830 CFU/100 ml.

Vlera mesatare e *Escherichia coli*, gjatë periudhës së matjeve ishte 101.31 e matur në njësi CFU/100 ml ujë. Bazuar në vlerat mesatare të *E.coli*, Direktiva 2006/7/EC, tabela 2, i klasifikon në klasën A. Vlerat e gjetura për *Escherichia coli*/MF për këto ujëra konfirmohet dhe nga punimet e tjera të gjetura për pellgun ujëmbledhës të liqenit të Shkodrës (ANONIMOUS, 2001; BUSHATI, 2002, 2003, 2006). Gjatë periudhës së matjeve vlera e *Escherichia coli* varioi nga 0.00 në 710 CFU/100 ml, duke treguar se këto vlera kanë luhajte në pika të ndryshme të liqenit bazuar dhe në kërkesat e rritjes që ka *Escherichia coli*. Vlerat më të larta për *Escherichia coli*, kanë rezultuar në Shtator 2011 me 710 CFU/100 ml për lumin Buna, këto vlera i klasifikojnë stacionet e kampionimit ndërmjet klasës A dhe B sipas Direktivës 2006/7/EC (500-1000 CFU/100ml) tabela 2. Në rastin e *E.coli-it*, 99% e vlerave të përcaktuara janë më të vogla se sa 500 CFU/100 ml mostër. Kjo tregon se ujërat e liqenit të lumit Buna dhe Drin, gjatë periudhës në studim mund të klasifikohen si ujëra që kanë cilësi shumë të mirë për nga përmbajtja e *E.coli*.

Vlera mesatare e *Enterokokëve intestinal* gjatë periudhës së matjeve ishte 59.42 e matur në njësi CFU/100 ml ujë. Ujërat e pellgut ujëmbledhës të liqenit të Shkodrës, përta i përket *Enterokokëve intestinal*, Direktiva 2006/7/EC e Parlamentit Evropian, tabela 2, i klasifikon në klasën A, e cila shkon deri në 200CFU/100 ml. Vlerat e *Enterokokëve intestinal* në këto ujëra konfirmohen dhe nga punimet e tjera të gjetura për liqenin e Shkodrës dhe lumenjtë Drini dhe Buna nga (ANONIMOUS 2001, BUSHATI, 2002, 2003, 2006). Gjatë periudhës së matjeve vlera e *Enterokokëve intestinal* varioi nga 0.00 në 650 CFU/100 ml. Për rastin e përmbajtjes së *Enterokokëve intestinal* 95% e rasteve kanë vlera më të vogla se sa 200 CFU/100 ml duke plotësuar kushtet e cilësisë së shkëlqyer për ujërat e ëmbla bazuar në treguesin *Enterokokë intestinal*. Direktiva 2006/7/EC e Parlamentit Evropian bazuar në mesataret e *Enterokokëve intestinal*, sipas stinëve i klasifikon këto ujëra në Klasën A, ndërsa maksimumi i vlerave për të gjitha stinët i klasifikon në klasën B përta i përket këtij parametri.

Vlera mesatare e MPN/*E.coli* gjatë periudhës së matjeve ishte 69.71 e matur në njësi CFU/100 ml ujë, bazuar në parametrin e MPN/terren laktozë ujërat e pellgut ujëmbledhës të liqenit të Shkodrës klasifikohen në klasën A bazuar në Direktivën 2006/7/EC, tabela 2. Vlerat e gjetura për MPN për këto ujëra konfirmohen dhe nga punimet e tjera të gjetura për liqenin e Shkodrës dhe lumenjtë Drini dhe Buna (ANONIMOUS 2001, BUSHATI 2002, 2003, 2006). Gjatë periudhës së matjeve vlera e MPN/*E.coli* varioi nga 0.00 në 1100 CFU/100 ml. Në rastin e MPN, 95% e rasteve të përcaktuara kishin vlerën më të vogël se sa 250 CFU/100 ml mostër. Direktiva 76/160/EEC i klasifikon në kategorinë A dhe B të cilësisë ndërsa Direktiva 2006/7/EC, i klasifikon në ujëra të klasës A.

Përfundime

Ujërat e liqenit të Shkodrës, lumit Buna dhe Drin, kanë karakter lehtësisht bazik dhe shkallë mineralizimi të ulët, në periudhën në studim temperatura e mesatare rezultoi 20°C.

Ujërat e liqenit të Shkodrës, lumit Buna dhe lumit Drin, gjatë periudhës në studim mund të klasifikohen në Klasën A të Direktivës 76/160/EC, duke u bazuar në vlerat mesatare të treguesve mikrobiologjikë për vlerën e koliformëve totalë, ndërsa përta i përket vlerave mesatare të treguesve mikrobiologjikë MPN/*E.coli*, *Escherichia coli*, *Enterokokë intestinalë* klasifikohen ndërmjet Klasës A dhe B të Direktivës 76/160/EC dhe në Klasën A të Direktivës 2006/7/EC, si ujëra që përdoren për larje.

Referencat

- ANNONYMUS 1, Council Directive 76/160/EEC of 8 December 1975 concerning the quality of bathing water.
- ANNONYMUS 2, DIRECTIVE 2006/7/EC. European Parliament and European Council (EU and EC). 2006. The management of bathing water quality and repealing directive 76/160/EEC, L64/37.
- APHA, AWWA, WEF 1995: Standard Methods for the Examination of Water and Wastewater 19th Edition Washington, American Public Health Association.
- APHA/AWWA/WPCF (1998): Standard Methods for the Examination of Water and Wastewater. 20th Edition. Part 9010. Microbiological examination. American Public Health Association, Washington.
- BABANI, F., YLLI, A., STAMO, I., KONGJIKA, E., KUKALI, E., 2009; Characterization of water quality of some Albanian Lakes, Proceedings of International Conference “Lakes and Nutrient Loads”, 24-26 April 2009, Pogradec.
- BEKA, I. 1994: Karakteristikat fiziko – kimike të ujit të liqenit të Shkodrës., Buletini i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Nr.1: 33-35.
- BEKA, I., KASTRATI, D., BUSHATI, N., RAKAJ, M; Integrated assessment of Water Quality of Buna River, helping in the Protection of Biodiversity of this Environment. JIEAS, Vol. 7(5):961-966 (2012). ISSN-1307-0428.
- BEKTESHI, A. 2000: Karakterizimi kimik i ujërave të liqenit të Shkodrës. Buletini i Universitetit të Shkodrës, Seria e Shkencave të Natyrës, Nr.52
- BEKTESHI, A., BEKA, I. & NEZIRI, A. 2002: Karakteristikat fiziko-kimike të ujërave të Lumit Buna, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Bul. Shk., Ser. Shk. Nat., 2002. Nr. 52: 35-41.
- BEKTESHI, A., 2006: Karakteristikat kimike të ujërave të disa burimeve ujore pranë liqenit të Shkodrës, BIO&EKO, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, dhjetor, 2006, Nr.6.
- BUSHATI, N., BUSHATI, F., 2002. Të dhëna paraprake mbi analizën bakteriale të ujërave të liqenit të Shkodrës. Bio & Eko, Botim i Sektorit të liqenit të Shkodrës, maj, 2002, Nr.4.
- BUSHATI, N., BUSHATI, F., 2003. Disa Rezultate Mikrobiologjike të Ujërave të liqenit të Shkodrës. Bio & Eko, Botim i Sektorit të liqenit të Shkodrës, maj, 2003, Nr.5.
- BUSHATI, N., BUSHATI, F., 2006. Studim i cilësive bakteriologjike të

- ujërave të liqenit të Shkodrës. Bio & Eko, Botim i Sektorit të liqenit të Shkodrës, maj, 2006, Nr.6.
- BUSHATI 2013: Vlerësimi i cilësisë së ujërave të liqenit të Shkodrës dhe lumenjve Drini nëpërmjet analizave mikrobiologjike dhe fiziko-kimike (pjesa shqiptare), (Disertacion) Universiteti i Tiranës, Libraria e Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Tiranë, Shqipëri.
- CHAPMAN, D., 1992. Water Quality Assessments - A Guide to Use of Biota, Sediments and Water in Environmental Monitoring.
- ISO 8199:1988, Water quality -- General guide to the enumeration of microorganisms by culture TC 147/SC 4.
- ISO 5667-2:1991, Water quality -- Sampling -- Part 2: Guidance on sampling techniques, TC 147/SC6.
- ISO 7704:1985, Water quality -- Evaluation of membrane filters used for microbiological analyses TC 147/SC 4.
- MIJOVIC, S., VUKOVIC, Z., MAZGALJ, A., A pan European classification of the Skadar Lake according to Environmental Standards, Physics, Chemistry and Technology Vol. 4, N=1, 2006, pp. 35 – 43
- SMEWW (1995), Standards methods for the Examination of Water and Wastewater 20th Edition, Part 9010, Microbiological examination, American Public Health Association (APHA), American Water Works Association (AWWA), and Water Environment Association (WEF). Washington, DC.
- TODAR, K., (2007) Pathogenic Escherichia coli, Online Textbook of Bacteriology, University of Wisconsin-Madison.

Studim i krahasuar i diversitetit të protozoarëve në aufwuchs-in e liqenit të Shkodrës dhe të lumit Drin

Violeta Alushi

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Shkencave të Natyrës,
Departamenti i Biologjisë.

PËRMBLEDHJE

Komunikohet për herë të parë gjetja e 32 specieve të protozoarëve (Protozoa) në lumin Drin. Jepet një listë me 55 specie të protozoarëve të gjetura në aufwuchs-in e brigjeve të liqenit pranë Zogaj dhe në lumin Drin, prej të cilave 9 specie: *Brachonella spiralis*, *Bursellopsis spumosa*, *Diffugia corona*, *Diffugia urceolata*, *Diplophrys archeri*, *Epistylis plicatilis*, *Heleopera petricola*, *Pyxidicula operculata* dhe *Vahlkampfia debilis*, përfaqësojnë gjetje të reja për ujërat e rajonit dhe Shqipërisë. Diversiteti i specieve të protozoarëve të aufwuchs-eve të dy ekosistemeve, rezulton i ndryshëm në përshtatje me diversitetin e kushteve ekologjike e veçanërisht me saprobinë e ujit.

FJALË KYÇE: Protozoa, aufwuchs, liqeni i Shkodrës, lumi Drin, specie indikatore.

The comparative study of the diversity of protozoans in
the aufwuchs's of Shkodra Lake and Drini River

ABSTRACT

The 32 protozoa species found in Drini River represent the first research of studying protozoa in this River. In this study, a list of 55 protozoa species found in aufwuchs's composition of the Lake and Drini River is given, from where 9 of these species: *Brachonella spiralis*, *Bursellopsis spumosa*, *Diffugia corona*, *Diffugia urceolata*, *Diplophrys archeri*, *Epistylis plicatilis*, *Heleopera petricola*, *Pyxidicula operculata* and *Vahlkampfia debilis* are new findings for Albania and the Region.

The diversity of protozoa species found in aufwuchs' composition of two

ecosystems is different, related with the diversity of ecological conditions and especially with the saprobia of the water.

KEYWORDS: Protozoa, aufwuchs's, Shkodra Lake, Drin River, indicator species.

Hyrje

Protozoarët janë një prej grupeve me biodiversitet më të lartë në ekosistemet limnike. Në zonën klimatike tranzitore, ku ndodhet vendi ynë, protozoarët janë grupi më larmishëm i botës shtazore. Duke pasur parasysh konsideratat e FOISSNER (1999), mikrozooplanktoni, ku bëjnë pjesë edhe protozoarët e liqeneve të zonave të temperuara, kanë strukturë më të ndërlikuar, biomasë relative dhe abundancë më të lartë se ato të liqeneve të zonave të tjera.

Për të gjykuar rreth diversitetit të protozoarëve duhet të merren në konsideratë speciet e fshehura në ciste, speciet me përhapje më të gjerë dhe nuk mund të flitet për larminë e protozoarëve vetëm duke studiuar speciet kozmopolite. Gjithashtu për një vlerësim real të biodiversitetit të protozoarëve, duhet të merren parasysh komunitetet lokale të tyre (speciet endemike) dhe ato të rralla ose kriptike në mjaft habitate, duke përfshirë edhe aufwuchs-in, i cili përfaqëson një mikrohabitat brenda habitatit të madh. Në komunitetet ujore aufwucks-i është një burim i rëndësishëm ushqimi për kafshët e ujit dhe dallohet për larminë e formave nga një mikrohabitat në tjetrin.

Komuniteti i aufwucks-it përfaqëson mikrofaunën e vërtetë. Ai jeton i ngjitur në të gjitha llojet e sipërfaqeve ku ai laget gjatë ditës nga uji i lumit, liqenit etj. Në këtë mënyrë diversiteti i specieve dhe popullatat e tyre shërbejnë si indikator për monitorimin e kushteve të ujit. Numri i popullatave të aufwucks-it është i varur nga përmbajtja organike, që është faktori kryesor për zhvillimin e ushqimit bakterial. Ndryshimet e oksigjenit të tretur dhe faktorëve të tjerë abiotik, përcaktojnë se cila specie dominon dhe mund të luajë rolin e predatorit. Komuniteti i aufwucks-it përfaqëson më shumë specie se ai i formave të ngulura që jetojnë në perifiton. Gjithashtu edhe zooplanktoni, ku ka edhe protozoarë, përdor sipërfaqe të ndryshme për t'u mbështetur. Studimet kanë treguar se mostrat e aufwucks-it, të marra në drekë, kanë një numër të madh të specieve të planktonit, pikërisht se ato migrojnë dhe vendosen në sipërfaqe të ndryshme.

Pjesa më e madhe e studimeve të bëra për komunitetin e aufwucks-it në substrate të ndryshme, si: liqene, lumenj dhe përrenj, i përkasin më shumë aspektit cilësor se sa sasior.

Gjatë këtij studimi ne kemi identifikuar përbërjen llojore të specieve të

protozoarëve në përbërje të aufwuchs-it të liqenit të Shkodrës dhe të lumit Drin.

Materiali dhe metodat

Mostrat e ujit janë marrë nga liqeni i Shkodrës dhe lumi Drin, për studimin e protozoarëve gjatë muajit maj dhe qershor të vitit 2012, si dhe gjatë muajve maj dhe korrik të vitit 2013. Përcaktimi i stacioneve të marrjes së mostrave, është bërë në përshtatje të qëllimit të këtij punimi, që i përket habitave të protozoarëve në përbërje të aufwuchs-it dhe bregut. Mostrat janë marrë në mjedise ujore ku ka pasur edhe gurë edhe makrofitet të zhytura në ujë, me qëllim identifikimin e specieve në këto mikrohabitete. Kemi marrë mostra në Zogaj, S 1 dhe në lumin Drin S 2. Pika e marrjes së mostrave në Zogaj ka qenë rreth



Fig 1. Harta e stacioneve të marrjes së mostrave

MARRJA E MOSTRAVE

MARRJA E MOSTRAVE është bazuar kryesisht tek MAGAZZU (1978) dhe FODEN et al. (2005). Në të njëjtin mjedis kemi marrë ujë nga bregu, makrofitet dhe gurët të këtij habitati. Me ndihmën e një spatule, janë hequr me kujdes pjesë nga substrati (bimët ose gurët) dhe këto janë ruajtur në shishe qelqi që janë studiuar në laborator, menjëherë pas marrjes së tyre. Sedimentet, në rastin tonë gurët dhe makrofitet, sipas FODEN et al. (2005), janë marrë nga uji dhe janë futur në shishe qelqi me ujë të distiluar, ku janë tundur mirë për 2 min, për të ndarë organizmat në përbërje të aufwuchs-it, i kemi lënë në qetësi për pak kohë dhe pastaj i kemi vërtitur direkt në mikroskop. Vërtimi në mikroskop është bërë në mënyrë periodike edhe pas

150 m nga qendra e fshatit Zogaj, kurse pika e marrjes së mostrave në lumin Drin, ka qenë rreth 100 m poshtë urës së Bahçallëkut. Duhet të theksojmë se në çdo stacion kemi marrë mostra të ujit të bregut, kemi marrë makrofitet dhe gurët e zhytur në ujë, me qëllim identifikimin e specieve mbi sipërfaqet e tyre. Stacionet paraqiten në hartën e mëposhtme fig. 1.

disa ditësh, për të ekzaminuar speciet që mund të kenë qenë potencialisht në formën e cistëve dhe që gjatë qëndrimit në kushte laboratorike, mund të kenë gjetur kushte për zhvillimin e tyre. Kur janë marrë mostrat është matur temperatura, pH dhe në rastin e lumit Drin edhe shpejtësia e rrjedhjes. Në terren janë mbajtur shënime për thellësinë, fundin, llojet e makrofitëve, janë bërë foto gjatë marrjes së mostrave si dhe gjatë punës. Përcaktimi i specieve të protozoarëve të mostrave të marra është bërë me mikroskop të tipit “LEICA DMLB”, duke u bazuar tek FOISSNER et al. (1999), STREBLE & KRAUTER (2002) dhe LEE et al. (2000). Speciet indikatore dhe vlerat e klasave të saprobisë që indikojnë janë marrë sidomos prej STREBLE & KRAUTER (2002) dhe FOISSNER et al. (1999), në përshtatje me speciet e protozoarëve që kemi gjetur në mostrat tona. Gjithë kjo punë është bazuar edhe tek përvoja jonë shumëvjeçare në studimin e protozoarëve të ujërave të ëmbla, veçanërisht tek botimet e bëra nga V. Alushi dhe Dh. Dhora, të cilat janë të renditura tek referencat.

Rezultatet dhe diskutimi

Në tabelën 1 paraqitet lista e 55 specieve të gjetura në dy stacionet, së bashku me të dhënat mbi stacionin, muajin e gjetjes, mikrohabitatit, gjetjen për herë të parë dhe indikacionin e saprobisë.

Tabela 1. Lista e specieve të gjetura në aufwuchs-in e liqenit të Shkodrës dhe lumit Drin, bashkë me të dhënat shoqëruese (* - speciet e gjetura për herë të parë, i - speciet indikatore të saprobisë)

Numri i specieve të gjetura dhe shpërndarja sipas taksa-ve

Gjatë studimit të mostrave të marra në stacionet e përshkruara më sipër dhe për çdo stacion sipas mikrohabitateve të përcaktuara, janë gjetur 55 specie të protozoarëve, ku 9 specie: *Brachonella spiralis*, *Bursellopsis spumosa*, *Diffugia corona*, *Diffugia urceolata*, *Diplophrys archeri*, *Epistylis plicatilis*, *Heleopera petricola*, *Pyxidicula operculata* dhe *Vahlkampfia debilis* përfaqësojnë gjetje të reja për liqenin e Shkodrës dhe për Shqipërinë.

Grupi Chromalveolata përfaqësohet me numrin më të madh të specieve – 39 specie, Amoebozoa me 10 specie, Excavata me 5 specie dhe Insertae sedis Protozoa me 1 specie. Kjo jepet në mënyrë grafike në fig 2. Përsa i përket grupit Alveolata dhe më konkretisht grupit Ciliophora, klasa Litostomatea ka numrin më të madh të specieve, 7 specie dhe Spirotrichea, 6 specie. Klasa Armophorea ka numrin më të vogël, 1 specie. Për grupin Amoebozoa, numrin më të madh të specieve e ka Tubulinea me 7 specie.

Tabela 1. Lista e specieve te gjetura ne aufwucks-in e liqenit të Shkodrës dhe lumit Drin, bashkë me të dhënat shoqëruese (* - speciet e gjetura për herë të parë, i - speciet indikatore të saprobisë)

Nr	Stacionet e marrjes se mostrave																								
	Maj 2012			Qershor 2012			Maj 2013			Drin (S2) Maj 2013			Zogaj (S1) Korrik 2013			Drin (S2) Korrik 2013									
			S1			S2			S1			S2			S1			S2							
			breg	gure	bime	breg	gure	bime	breg	gure	bime	breg	gure	bime	breg	gure	bime	breg	gure	bime	breg	gure	bime		
1	<i>Acropisthium mutabile</i>																								
2	<i>Amoeba proteus (i)</i>																								
3	<i>Amoeba gorgonia</i>																								
4	<i>Amphileptus claparedi (i)</i>																								
5	<i>Amphileptus pleurosigma</i>																								
6	<i>Arcella vulgaris</i>																								
7	<i>Aspidisca cicada (i)</i>																								
8	<i>Brachionella spiralis (i)*</i>																								
9	<i>Bursellopsis spumosa *</i>																								
10	<i>Chilodonella cucullus (i)</i>																								
11	<i>Chilodonella uncinata (i)</i>																								
12	<i>Cochliopodium bilimbosum</i>																								
13	<i>Coleps hirtus hirtus (i)</i>																								




Fig 2. Numri i specieve sipas ndarjeve taksonomike

Numri i specieve sipas stacioneve dhe periudhave të marrjes së mostrave.

Në fig 3, është dhënë numri i specieve të gjetura sipas mikrohabitave të marra për çdo stacion dhe për periudha të ndryshme të marrjes së mostrave. Siç shihet numri më i madh i specieve është gjetur mbi sipërfaqen e bimëve në S 1, në muajin korrik, me 16 specie dhe nga 15 specie janë gjetur në S 2 mbi sipërfaqen e bimëve në maj 2013 dhe mbi sipërfaqen e gurëve në S 1 në maj 2012.

Numri më i vogël i specieve është gjetur në S 2, në ujin e bregut në muajin korrik. Numri më i madh i specieve në mikrofaunën e bimëve dhe gurëve lidhet me faktin se aty gjejmë specie që kanë nevojë për një substrat mbështetës, si dhe lloje që ushqehen me periftonin mbi sipërfaqen e tyre, që është një mjedis i bollshëm me lëndë ushqyese. Numri më i vogël i specieve, 4 specie, është gjetur në ujin e marrë në breg të lumit Drin, ky numër i vogël lidhet edhe me karakteristikat e këtij habitati, me ujë të rrjedhshëm dhe me një temperaturë jo shumë të përshtatshme për zhvillimin e tyre (14°C).

Në fig 4. është dhënë numri i specieve të gjetura sipas stacioneve. Numri më i madh i specieve është gjetur në S 1, në mikrohabitatet e ujërave të liqenit, në Zogaj dhe përkatësisht 41 specie. Kjo lidhet me kushtet më të përshtatshme të jetesës që ofron ky mjedis meqë është më i pasur me lëndë ushqyese dhe ka një temperaturë më të përshtatshme për zhvillimin e tyre, kështu që mund të konsiderohet si strehë e përshtatshme për zhvillimin e protozoarëve. Numri




Fig 3. Numri i specieve sipas habitateve dhe periudhave kohore

më i vogël i specieve është në S 2, me 32 specie. Kjo lidhet me veçoritë e këtij mjedisi me ujë të rrjedhshëm, një temperaturë më e ulët krahasuar me ato të ujërave të liqenit, një mjedis i cili është më i predispozuar ndaj ndryshimit të faktorëve klimaterikë, si: temperatura, era, shiu etj. Megjithatë duhet të theksojmë se në këtë stacion, numri i specieve të gjetura në mikrofaunën mbi sipërfaqen e gurëve dhe të bimëve është pak a shumë i përafërt, me diferenca të vogla në numër. Gjithashtu, kushtet për zhvillim të protozoarëve, janë më të mira se ato që ndodhen në ujin e bregut. Ndryshimet e shpeshta




Fig 4. Numri i specieve të gjetura sipas stacioneve

klimaterike influencojnë në formimin e cistëve të protozoarëve kur ato janë të papërshtashme, e cila ndikon edhe në numrin e tyre. Kjo reflektohet tek speciet që ndodhen në gjendje të lirë në ujin e bregut.

Speciet indikatorë dhe saprobia e ujërave

Vlerësimet lidhur me saprobinë e ujërave të liqenit të Shkodrës dhe lumit Drin, janë bërë bazuar në speciet indikatorë të protozoarëve të gjetura në mostrat e marra në studim. Speciet indikatorë dhe vlerat e klasave të saprobisë që indikojë janë marrë sidomos prej STREBLE & KRAUTER (2002) dhe FOISSNER et al. (1999). Është llogaritur indeksi i pastërtisë relative sipas formulës që jep KNÖPP (1954) në përshtatje me speciet e protozoarëve të gjetur në liqen dhe indikimi i saprobisë. Janë gjetur gjithsejt 17 specie indikatorë, ku nga këto kemi 1 specie të klasës I të saprobisë, 5 specie janë indikatorë të klasës II të saprobisë, 6 specie janë indikatorë të klasës III të saprobisë dhe 5 specie janë indikatorë të klasës IV të saprobisë.

Në fig. 5 janë paraqitur grafikisht numri i specieve indikatorë për çdo stacion. Siç e shohim në total kemi një numër të njëjtë të specieve indikatorë për të dy stacionet, me nga 11 specie, si në lumin Drin ashtu edhe në liqen. Megjithatë numri më i madh është gjetur në S 1 tek bimët dhe S 2 tek gurët, që përfaqësojnë më mirë luhatjet e pastërtisë së këtyre ujërave në periudha të nxehta. Në periudhën maj - korrik, bimët kanë qenë më të zhvilluara në liqen dhe organizmat e gjetura në sipërfaqen e tyre janë më të shumta, e si rrjedhojë edhe speciet indikatorë. Kurse përse i përket lumit Drin, ku makrofitet e ujit në breg janë më pak të zhvilluara, në sipërfaqen e gurëve mendojmë se kanë gjetur një mjedis më të përshtatshëm për zhvillimin e tyre.




Fig 5 Numri i specieve indikatorë sipas stacioneve.

Bazuar në vlerat e tyre të saprobisë, vlerat e indeksit relativ të saprobisë për S 1 dhe S 2 dhe sipas mikrohabitave, kanë luhatur sepse duke qenë ujëra të brigjeve, janë më të ndjeshme ndaj aktivitetit të njeriut në këto periudha. Vlerat e indikatorit të saprobisë për të dy stacionet, bazuar në speciet indikatorë luhaten mes vlerave 2 – 3, gjë që tregon se ujërat e brigjeve janë më të ndjeshme ndaj ndotjes dhe aktivitetit të njeriut. Veçanërisht rol të rëndësishëm luajnë bakteret dhe protozoarët.

Perfundime

Për herë të parë është kryer një studim mbi protozoarët e lumit Drin, si dhe mbi protozoarët në përbërje të aufwuchs-it të liqenit të Shkodrës dhe lumit Drin.

Lista përmban 55 specie të protozoarëve të gjetur në këto mikrohabitave, 32 prej të cilëve në lumin Drin. 9 specie përbëjnë gjetje të reja për Shqipërinë dhe rajonin. Shumica e specieve të gjetura janë ciliate.

Numrin më të madh të specieve e ka aufwuchs-i i liqenit të Shkodrës dhe kjo mendojmë për shkak të numrit të madh të cilioforeve të gjetura në kushtet e një mjedisi saprobik, me ujë të qetë dhe me një temperaturë më të favorshme. Speciet e gjetura në aufwuchs-in e bregut të lumit Drin, janë në numër më të madh ndaj diferencës së atyre të gjetura në zonën me ujë të rrjedhshëm dhe kjo mendojmë se ndodh për të njëjtat arsye që përmendëm më sipër.

Referencat

- ADL, S. M. et al 2005: The new higher level classification of eukaryotes with emphasis on the taxonomy of protists. *J. Eukaryot. Mikrobiol.* 52: 399-415
- ALUSHI, V. 2006: Kontribut për njohjen e protozoarëve (Protozoa) të liqenit të Shkodrës. (Aspekte faunistike, vlerësime ekologjike). Disertacion për marrjen e gradës shkencore “Doktor”. Universiteti i Tiranës. Tiranë.
- ALUSHI, V. & DHORA, DH. 2006: Protozoarët e liqenit të Shkodrës. Specie të reja, vlerësime të përgjithshme. *Buletin Shkencor USh “Luigj Gurakuqi”*, Nr. 56, Seria Shkencave të Natyrës, fq. 107 - 129. Shkodër.
- ALUSHI, V. & DHORA, DH. 2007: Vlerësime ekologjike mbi protozoarët e liqenit të Shkodrës. *Bul. Shk. USh. “Luigj Gurakuqi”*, Nr. 57, Seria e Shkenc. të Natyrës, fq. 120-149.
- ALUSHI, V. & MANI, E. 2011: The potentials of Protozoa diversity (Protozoa) of Shkodra Lake. *International Conference on Carstic Water Bodies Ablakes’ 2*. Elbasan, Albania, 09-11 June, Proceedings books. ISBN:

99956-16- 49-6, page 10-16

- ALUSHI, V. & RAKAJ, M. 2011: Overview of Protists of Shkodra Lake. ICE, International Conference on Ecosystems, Proceedings books, Essays on Ecosystem and Environmental Research, ICE_2011, ISBN: 978-9928-4068-1-1, June 4-6, Tirana, Albania. page 97 – 102.
- FODEN, J., PURDIE, D. A, MORRIS, S. & NASCIMENTO, S. 2005: Epiphytic abundance and toxicity of *Prorocentrum lima* populations in the Fleet Lagoon, UK. Elsevier. Volume 4, Issue 6, Pages 1063–1074
- FOISSNER, W., BERGER, H., & SCHAUMBURG, J. 1999: Identification and ecology of limnetic plancton ciliates. Bavarian State Office for Water Management (Editor and Publisher). Mynich.
- HELLAWELL, M. 1989: Biological indicators of freshwater pollution and environmental. Pollution monitoring series. Advisory editor: K. Mellany. Elsevier applied sci. p.52 – 58.
- KARINI, S. & DHORA, DH. 2012 : Zhvillimi i protozoarëve (Protozoa) gjatë dekompozimit të makrofiteve në breg të liqenit të Shkodrës. Bul. Shk. USh. “Luigj Gurakuqi”.
- LEE J. J., LEDALE G. F. & BRADBURY PH. 2000 : An illustrated guide to the Protozoa Second edition. Vol. I & II. Society of Protozoologists. Printed by Allen Press Inc., Lawrence, KS 66044 USA.
- RAKAJ, M., ALUSHI, V & DHORA, DH. 2006: Lista e protistëve të liqenit të Shkodrës. CP, 94 fq. Shkodër.
- STREBLE, H & KRAUTER, D. 2002: Atlante dei microrganismi acquatici La vita una goccia d'aqua. Franco editor 17 – 22, 35 – 45, 149 – 151, 213–26 Padova

Një rishikim sinonimik i florës së Shqipërisë

Marash Rakaj

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Shkencave të Natyrës
Departamenti i Biologji - Kimisë

PËRMBLEDHJE

Shumë taksa bimore, përfshi familje, gjini, specie dhe subspecie të Florës së Evropës, Florës së Mesdheut e më gjerë, janë revizionuar gjatë tri dekadave të fundit, duke u bazuar kryesisht në analizat molekulare dhe në ripërcaktimin e materialeve bimore të vjetra dhe të reja, të depozituara në herbaret e vendeve të ndryshme. Këto ndryshime nuk janë pasqyruar plotësisht në guidat kryesore të florës së Shqipërisë “Flora e Shqipërisë vol. 1-4” dhe “Udhëheqës fushor i Florës së Shqipërisë”.

Në këtë punim janë rregulluar dhe sistemuar 37 specie dhe 55 subspecie të bimëve me lule (Angiosperma) për Florën e Shqipërisë, prej të cilave 9 specie dhe një subspecie të përdorura gabimisht ose jokorrekt, 28 specie dhe 54 subspecie si sinonime.

KEY WORDS: Flora e Shqipërisë, bimë me farë, sinonim homotipik, sinonim heterotipik

A synonymous review of the flora of Albania

ABSTRACT

Many plants taxa, include families, generas, species and subspecies of the Flora Europea, Flora of the Mediterranean and others were revised during the last three decades, based primarily on molecular analysis and redetermination of old and new plant specimens stored in herbariums of different countries. Such changes were not completely reflected in the main guides of the flora of Albania “Flora of Albania vol. 1-4” and “Field guide of the Flora of Albania”. In this paper, 37 species and 55 subspecies of flowering plants (Angiosperma) are adjusted and systemized for Albanian Flora, of which 9 species and one subspecies of misapplied names or not correct used, 28 synonyms species and

54 synonyms subspecies.

Hyrje

Shqipëria karakterizohet nga një florë e pasur. Rreth 3230 specie dhe subspecie të egra janë raportuar dhe përshkruar në guidën “Udhëheqës fushor i Florës së Shqipërisë” dhe në guidën kryesore “Flora e Shqipërisë vol. 1-4”. Qindra specie dhe subspecie të tjera janë përshkruar në guidën “Flora Ekskursioniste e Shqipërisë”, ndërsa rreth 438 specie dhe subspecie janë raportuar ose konfirmuar për Shqipërinë nga botanistë të huaj dhe vendas gjatë dy dekadave të fundit, shumica e të cilave janë përmbledhur nga RAKAJ et al. (2013).

Mirëpo, ndërsa janë bërë shumë studime për florën e Shqipërisë, ku edhe janë raportuar shumë specie dhe subspecie, pak studime janë bërë për përditësimin e guidave kryesore të florës së Shqipërisë. Nga studimet e fundit, ne njohim atë të BARINA et al. (2013), i cili propozon të hiqen nga Shqipëria 17 specie të raportuara për Shqipërinë nga autorë të ndryshëm, por prej tyre vetëm 2 specie dhe një subspecie; *Ambrosia artemisiifolia* L., *Biscutella laevigata* L., *Dianthus haematocalyx* Boiss. & Heldr. subsp. *sibthorpii* (Vierh.) Hayek rezultojnë të përfshira në dy guidat kryesore të sipërpërmendura.

Rregullimi i plotë sinonimik i florës është një proces i gjatë, që kërkon shumë kohë dhe shumë punë studimore të koleksioneve bimore të ruajtura, por edhe punë në terren. Prandaj, kjo mbetet një detyrë e floristëve dhe institucioneve përkatëse për të ardhmen.

Në këtë punim kemi bërë rregullimin e dy grupeve taksash, të cilat ne i kemi konsideruar si më të rëndësishme: grupi i parë përfshin speciet dhe subspeciet e përdorura gabimisht ose jokorrekt; grupi i dytë përfshin taksa (specie dhe subspecie) në vend të të cilave, në florë janë përdorur dy ose më shumë sinonime të tyre.

Në emërtimin e taksave bimore vërehen dy lloj sinonimesh: Sinonimet homotipike përbëhen nga emra të ndryshëm që kanë ekzistuar në të kaluarën për të njëjtin tip ekzemplarësh.

Sinonimet heterotipike përbëhen nga emra të ndryshëm për tipe të ndryshme ekzemplarësh, të cilët nga një pikë janë konsideruar taksa të ndryshme (KEW 2010).

Materiali dhe metodat

Është bërë rregullimi i 38 specieve dhe 55 subspecieve të bimëve me lule (Angjiosperma) të dy guidave floristike “Flora e Shqipërisë vol. 1-4” (PAPARISTO et al. 1988; QOSJA et al. 1992, 1996; VANGJELI et al. 2000)

dhe “Udhëheqës fushor i Florës së Shqipërisë“ (VANGJELI 2003), pa përfshirë taksat e raportuara dhe të konfirmuara dy dekadat e fundit, (RAKAJ et al. 2013). Rregullimi është bërë vetëm për speciet e përdorura gabimisht dhe sinonimet homotipike ose heterotipike, duke u bazuar në Species-directories Infrastructure (www.eu-nomen.eu/portal/), Euro+Med plant base ([ww2.bgbm.org/EuroPlusMed/](http://www2.bgbm.org/EuroPlusMed/)), TUTIN et al. 1964-1980, GREUTER et al. 1984, 1986, 1989; World Checklist of Selected Plant Families 2010, WCSP (<http://apps.kew.org/wcsp/>).

Për çdo specie dhe subspecie të përdorur gabimisht është dhënë përhapja rajonale ose sipas shteteve së bashku me autorët që e kanë raportuar për vendin përkatës.

Speciet janë renditur sipas guidës kryesore të florës së Shqipërisë “Flora e Shqipërisë vol. 1-4”.

Rezultatet dhe diskutimi

Në këtë punim paraqitet rregullimi dhe sistemimi i 38 specieve dhe 55 subspecieve të bimëve me lule (Angjiosperma) të guidave floristike “Flora e Shqipërisë vol. 1-4” (PAPARISTO et al. 1988; QOSJA et al. 1992, 1996; VANGJELI et al. 2000) dhe “Udhëheqës fushor i Florës së Shqipërisë“ (VANGJELI 2003).

a. Rregullimi i specieve të përdorura gabimisht:

1. *Erysimum korabense* KÜMMERLE & JAV. 1921 (Shqipëri, Maqedoni, Serbi) - GREUTER et al. 1986, TUTIN et al. 1964-1980. E cituar - përfshihet për Shqipërinë (PAPARISTO et al. 1988).
Erysimum pulchellum (WILLD.) GAY 1842 (Armeni, Turqi). Përdorur gabimisht për Shqipërinë (PAPARISTO et al. 1988), ndoshta bazuar tek Flora e Evropës (TUTIN et al. 1964-1980).
2. *Erysimum kuemmerlei* JAV. 1921 (Shqipëri, Maqedoni, Serbi, Greqi) - GREUTER et al. 1986, TUTIN et al. 1964-1980. Raportuar si sinonim për Shqipërinë (PAPARISTO et al. 1988).
Erysimum pectinatum BORY et CHAUB. 1832 (Greqi). Përdorur gabimisht për Shqipërinë (PAPARISTO et al. 1988; GREUTER et al. 1986).
3. *Arabis sudetica* TAUSCH. 1836 (Shqipëri, Evropë Qendrore dhe Lindore, Turqi) – TUTIN et al. 1964-1980. Raportuar si sinonim për Shqipërinë (PAPARISTO et al. 1988).

- Arabis allionii* DC.1805 (Itali, Francë, Rumani, Ukrainë). Përdorur gabimisht për Shqipërinë (PAPARISTO et al. 1988).
4. *Fragaria viridis* WESTON 1771 subsp. *viridis* (Shqipëri, Evropë). Raportuar saktë për Shqipërinë (QOSJA et al. 1992).
Fragaria viridis WESTON subsp. *campestris* (STEVEN) PAWL.1968 (Rumani, Moldavi, Ukraine, Rusi). Përdorur gabimisht për Shqipërinë (QOSJA et al. 1992).
5. *Cotoneaster pyrenaicus* GAND. 1875 (Shqipëri, Evropë, Turqi) - DEMIRI 1983, QOSJA et al. 1992, TUTIN et al. 1964-1980.
Cotoneaster integerrimus MEDIK. 1793 (Skandinavi, Estoni, Letoni). Përdorur gabimisht për Shqipërinë (QOSJA et al. 1992), ndoshta bazuar tek Flora e Evropës (TUTIN et al. 1964-1980).
6. *Cotoneaster tomentosus* (AITON) LINDL. 1821 (Shqipëri, Evropë, Turqi, Transkaukaz) - DEMIRI 1983, TUTIN et al. 1964-1980. Raportuar si sinonim për Shqipërinë (QOSJA et al. 1992).
Cotoneaster nebrodensis (GUSS.) K. KOCH 1853 (Itali, Sicili). Përdorur gabimisht për Shqipërinë (QOSJA et al. 1992), ndoshta bazuar tek Flora e Evropës (TUTIN et al. 1964-1980).
7. *Crataegus orientalis* M. BIEB 1808 (Shqipëri, Maqedoni, Greqi, Bullgari, Ukrainë, Turqi, Transkaukaz) - KURTTO et al. 2009. Raportuar si sinonim për Shqipërinë (QOSJA et al. 1992).
Crataegus laciniata UCRIA 1793 (Marok. Algjeri, Spanjë, Sicili). Përdorur gabimisht për Shqipërinë (QOSJA et al. 1992).
8. *Fritillaria montana* HOPPE ex W. D. J. KOCH 1832 (Shqipëri, Ballkan, Itali, Francë, Ukrainë). Raportuar si sinonim për Shqipërinë (VANGJELI et al. 2000, 2003).
Fritillaria orientalis ADAM 1805 (Transkaukaz, Rusi) = *F. tenella* M. BIEB. Përdorur gabimisht për Shqipërinë (VANGJELI et al. 2000, 2003).
9. *Asphodelus ramosus* L. 1753 = *A. microcarpus* VIV (Mesdhe) – KEW 2010. Raportuar jokorrekt në florë (VANGJELI et al. 2000, 2003).
Asphodelus aestivus BROT. 1804 = *A. microcarpus* VIV var. *aestivus* (BROT.) NYMAN (Spanjë, Portugali). Përdorur gabimisht për Shqipërinë (VANGJELI et al. 2000, 2003), ndoshta bazuar tek Flora e Evropës (TUTIN et al. 1964-1980).
10. *Drimia numidica* (JORD. & FOURR.) J. C. MANNING & GOLDBLATT 2004 = *Urginea maritima* var. *numidica* (JORD. & FOURR.) MAIRE & WEILLER (Shqipëri, Ballkan, Itali, Afrika e Veriut) – GREUTER et al. 1989.
Drimia maritima (L.) STEARN 1978 = *Urginea maritima* (L.) BA-

KER 1873 (Itali, Francë, Spanjë, Marok, Algjeri). Përdorur gabimisht për Shqipërinë (VANGJELI et al. 2000, 2003), duke u bazuar tek Flora e Evropës (TUTIN et al. 1964-1980).

b. Rregullimi sinonimik i specieve:

1. *Quercus pubescens* WILLD. 1796 subsp. *pubescens*
Sinonim heterotipik: *Quercus virgiliana* (TEN.) TEN. 1896.
2. *Ranunculus concinnatus* SCHOTT. 1857
Sinonim: *Ranunculus croaticus* SCHOTT 1857
3. *Ranunculus millefoliatus* VAHL 1791
Sinonim: *Ranunculus garganicus* TEN. 1830
4. *Ranunculus thora* L. 1753
Sinonim: *Ranunculus scutatus* WALDST. & KIT. 1806
5. *Dianthus cruentus* GRISEB. 1843
Sinonim: *Dianthus brachyzonus* BORBAS & FORM. 1897
6. *Silene latifolia* POIR. 1789
Sinonim: *Silene alba* (MILLER) E.H.L. KRAUSE 1901 = *Meleandrum album* (MILL.) GARCKE
7. *Malcolmia orsiniana* (TEN.) TEN 1835 subsp. *angulifolia* (BOISS. & ORPH.) STORK 1972
Sinonim: *Malcolmia illyrica* HAYEK 1917
Sinonim homotipik: *Malcolmia angulifolia* BOISS. & ORPH. 1856
8. *Arabis glabra* (L.) BERNH. 1800
Sinonim: *Arabis pseudoturritis* BOISS. & HELDR. 1853
9. *Alyssum murale* WALDST. & KIT. 1799
Sinonime: *Alyssum chalcidicum* JANKA 1872
Alyssum chlorocarpum HAUSSKN. 1893
10. *Draba lasiocarpa* ROCHEL 1810
Sinonime: *Draba athoa* (GRISEB.) BOISS. 1853
Draba boueana ZAHLBR. ex O. E. SCHULTZ 1927
11. *Sedum album* L. 1753
Sinonim: *Sedum serpentini* JANCHEN 1920
12. *Rosa corymbifera* BORKH. 1790
Sinonim heterotipik: *Rosa obtusifolia* DEVS. 1809
13. *R. pulverulenta* M. BIEB. 1808
Sinonime heterotipike: *Rosa glutinosa* SIBTH. & SM. 1809
Rosa sicula TRATT. 1823
14. *Cytisus hirsutus* L. 1753

- Sinonime: *Chamaecytisus hirsutus* (L.) LINK. 1831
Chamaecytisus ciliatus (WAHL.) ROTH. 1944 = *Cytisus ciliatus* WAHL.
Chamaecytisus supinus (L.) LINK. 1831 = *Cytisus supinus* L.
15. *Geranium molle* L. 1753
 Sinonim heterotipik: *Geranium brutium* GASPARR. 1842
16. *Cuscuta planiflora* TEN. 1829
 Sinonim: *Cuscuta brevistyla* A. BRAUN 1852
17. *Campanula glomerata* L. 1753
 Sinonim heterotipik: *Campanula moesiaca* VELEN. 1893
18. *Campanula rotundifolia* L. 1753
 Sinonim heterotipike: *Campanula albanica* WITASEK. 1906
Campanula velebitica BORBAS 1930.
19. *Schoenus ferrugineus* L. 1753
 Sinonim heterotipik: *Schoenus karpatii* PENZES 1962
20. *Stipa pennata* L. 1753
 Sinonim heterotipik: *Stipa joannis* ČELAK 1884.

c. Rregullimi sinonimik i subspecie-ve:

1. *Thalictrum minus* L. 1753
 Sinonime: *Thalictrum minus* L. subsp. *minus*
Thalictrum minus L. subsp. *majus* (CRANTZ) ROUY & FOUC. 1893.
2. *Sagina apetala* ARD. 1764
 Sinonime: *Sagina apetala* ARD. subsp. *apetala*
Sagina apetala ARD. subsp. *erecta* (HORNEM.) F.HERM. 1912
3. *Cerastium alpinum* L. 1753
 Sinonime: *Cerastium alpinum* L. subsp. *alpinum*
Cerastium alpinum L. subsp. *lanatum* (LAM.) ASCH. & GRAEBN. 1917
4. *Dianthus armeria* L. 1753
 Sinonime: *Dianthus armeria* L. subsp. *armeria*
Dianthus armeria L. subsp. *armeriastrum* (WOLFNER) VELEN. 1898
5. *Dianthus cruentus* GRISEB. 1843
 Sinonime: *Dianthus cruentus* GRISEB. subsp. *cruentus*
Dianthus cruentus GRISEB. subsp. *turcicus* (VELEN.) STOJ. &

ACHT. 948

6. *Dianthus giganteus* D'URV. 1822

Sinonime: *Dianthus giganteus* D'URV. subsp. *giganteus*

Dianthus giganteus D'URV. subsp. *hyanaldianus* (BORBAS)

TUTIN 1963

7. *Silene latifolia* POIR. 1789

Sinonime: *Silene alba* (MILLER) E.H.L. KRAUSE 1901 subsp. *alba*

Silene alba (MILLER) E.H.L. KRAUSE subsp. *divaricata*

(REICHENB.) WALTERS 1964

8. *Silene vulgaris* (MOENCH) GARCKE 1869 subsp. *vulgaris*

Sinonime: *Silene vulgaris* (MOENCH) GARCKE subsp. *angustifolia*
(MILL.) HAYEK 1924

9. *Lepidium graminifolium* L. 1759

Sinonime: *Lepidium graminifolium* L. subsp. *graminifolium*

Lepidium graminifolium L. subsp. *suffruticosum* (L.) P. MONTS

1964

10. *Rapistrum rugosum* (L.) ALL. 1785

Sinonime: *Rapistrum rugosum* (L.) ALL. subsp. *rugosum*

Rapistrum rugosum (L.) ALL. subsp. *linnaeanum* ROUY et

FOUC. 1895

11. *Crataegus monogyna* JACQ. 1775

Sinonime heterotipike: *Crataegus monogyna* JACQ. subsp. *monogyna*

Crataegus monogyna JACQ. subsp. *azarella* (GRI-
SEB.) FRANCO 1968

12. *Lamium garganicum* L. 1763 subsp. *garganicum*

Sinonim heterotipik: *Lamium garganicum* L. subsp. *leavigatum* AR-
CANG. 1882

13. *Campanula glomerata* L. 1753

Sinonime heterotipike: *Campanula glomerata* L. subsp. *glomerata*

Campanula glomerata subsp. *cervicaroides*

(SCHULTES) P. FOURN. 1939

Campanula glomerata subsp. *hispida* (WITASEK)

HAYEK 1930

Campanula glomerata subsp. *serotina* WETTST.) O.

SCHWARZ 1949

14. *Campanula persicifolia* L. 1753

Sinonime heterotipike: *Campanula persicifolia* L. subsp. *persicifolia*

Campanula persicifolia L. subsp. *sessiflora* (VE-

LEN) FED. ex GREUTER & BURDET 1982

15. *Campanula sibirica* L. 1753
 Sinonime heterotipike: *Campanula sibirica* L. subsp. *sibirica*
Campanula sibirica L. subsp. *divergentiformis*
 (JAV.) DOMIN 1936
16. *Campanula sparsa* FRIV. 1836
 Sinonime heterotipike: *Campanula sparsa* FRIV. subsp. *sparsa*
Campanula sparsa FRIV. subsp. *frivaldszkyi*
 (STENDEL) HAYEK 1930
17. *Campanula spatulata* SIBTH. & SM. 1806
 Sinonim heterotipik: *Campanula spatulata* SIBTH. & SM. subsp. *spruneriana* HAMPE) HAYEK 1930
18. *Campanula trachelium* L. 1753 subsp. *trachelium*
 Sinonim heterotipik: *Campanula trachelium* L. subsp. *athoa* (BOISS. & HELDR.) HAYEK 1930
19. *Galatella albanica* DEGEN 1901
 Sinonime: *Aster albanicus* (DEGEN) CSIKI & al. 1926 subsp. *albanicus*
Aster albanicus (DEGEN) CSIKI & al. subsp. *paparistoi* QOSJA
 1982 (nom.inval.)
20. *Anthemis cretica* L. 1753 subsp. *tenuiloba* (DC.) GRIERSON 1975
 Sinonim homotipik: *Anthemis tenuiloba* (DC.) BOISS. 1856 subsp. *tenuiloba*
 Sinonim heterotipik: *Anthemis tenuiloba* (DC.) BOISS subsp. *cronia*
 (BOISS. & HELDR.) HAYEK 1931
21. *Centaurea deusta* TEN. 1811
 Sinonim homotipik: *Centaurea alba* L. 1753 subsp. *deusta* (TEN.) NYMAN 1879
Centaurea alba L. subsp. *splendens* (L.) ARCANG.
 (nom. inval.)
22. *Cyanus triumfetti* (ALL.) Á. LÖVE & D. LÖVE 1961 subsp. *triumfetti*
 Sinonim: *Centaurea triumfettii* ALL. 1773 subsp. *triumfettii*
 Sinonim heterotipik: *Centaurea triumfettii* ALL. subsp. *aligera*
 (GOGLER) DOSTAL 1976.
23. *Pilosella leucopsilon* (ARV.-TOUV.) GOTTSCHL. 2011
 subsp. *pilisquama* (NÄGELI & PETER) GOTTSCHL. 2011
 Sinonim homotipik: *Hieracium hoppeanum* SCHULTES 1814
 subsp. *pilisquamum* NÄGELI & PETER 1885
 Sinonime heterotipike: *Hieracium hoppeanum* subsp. *testimonia-*

lis PETER 1884

Hieracium hoppeanum subsp. *troicum*

ZAHN 1923.

24. *Pilosella officinarum* VAILL. 1754

Sinonime heterotipike: *Hieracium pilosella* L. 1753 *subsp. *melanops* PETER 1884

Hieracium pilosella L. subsp. *micradenium*

NAEGELI & PETER 1885

Hieracium pilosella L. subsp. *tricholepium*

NAEGELI & PETER 1885

Hieracium pilosella L. subsp. *trichoscapum*

NAEGELI & PETER 1855.

25. *Anacamptis coriophora* (L.) R. M. BATEMAN, PRIDGEON & M. W. CHASE 1997

Sinonim: *Orchis coriophora* L. 1753 subsp. *coriophora*

Sinonim heterotipik: *Orchis coriophora* L. subsp. *fragrans* (POLLINI) K. RICHT 1890

26. *Neotinea tridentata* (SCOP.) R. M. BATEMAN, PRIDGEON & M. W. CHASE 1997 subsp.

tridentata

Sinonim heterotipik: *Orchis tridentata* SCOP. subsp. *commutata* (TOD.) NYMAN 1882

27. *Carex muricata* L. 1753 subsp. *muricata*

Sinonim homotipik: *Carex muricata* L. subsp. *lamprocarpa* ÇELAK. 1879

28. *Carex ornithopoda* WILLD. 1805

Sinonim heterotipik: *Carex ornithopoda* WILLD subsp. *ornithopodoides* (HAUSM.) NYMAN 1882

29. *Poa cenisia* ALL. 1789

Sinonim heterotipik: *Poa cenisia* ALL. subsp. *contracta* E. I. NYARADY 1931

Nga revizionimi 37 specieve dhe 55 subspecieve të bimëve me lule (Angjiosperma) të raportuara në guidat floristike “Flora e Shqipërisë vol. 1-4” dhe “Udhëheqës fushor i Florës së Shqipërisë” rezulton se,

9 specie dhe një subspecie që ndodhen në Shqipëri (a) duhet të zëvendësojnë taksat analoge të përdorura gabimisht ose jokorrekt për Shqipërinë.

28 speciet që rezultojnë sinonime homotipike ose heterotipike (b) duhet të

konsiderohen të tilla deri në ndonjë rikonfirmim tjetër.

54 subspeciet që rezultojnë sinonime homotipike ose heterotipike (c) të specieve apo subspecieve përkatëse duhet të konsiderohen të tilla deri në ndonjë rikonfirmim tjetër.

Referencat

- ALSTON, A. H. G. & SANDWITH, N. Y. 1940: Results of two botanical expeditions to South Albania. *J. Bot. London* 74: 219-246.
- BARINA, Z., RAKAJ, M. & PIFKÓ, D. 2013: Contributions to the flora of Albania, 4. – *Willdenowia* 43: 165 – 184. – Online ISSN 1868-6397; © 2012 BGBM Berlin-Dahlem.
- DEMIRI, M. 1983: Flora eskursioniste e Shqipërisë. – Shtëpia Botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 986pp.
- EURO+MED PLANTBASE 2010: The information resource for Euro-Mediterranean plant diversity. Botanic Garden and Botanical Museum Berlin-Dahlem.
- GREUTER, W., BURDET, H. M. & LONG, G. 1984: Med-checklist. A critical inventory of vascular plants of the circum-mediterranean countries 1 Pteridophyta (ed. 2), Gymnospermae, Dicotyledones (Acanthaceae-Cneoraceae). – Conservatoire et Jardin botaniques de la Ville de Genève, Genève, 330pp.
- GREUTER, W., BURDET, H. M. & LONG, G. 1986: Med-checklist. A critical inventory of vascular plants of the circum-mediterranean countries 3 Dicotyledones (Convolvulaceae-Labiatae). Conservatoire et Jardin botaniques de la Ville de Genève, Genève, 395+129 pp.
- GREUTER, W., BURDET, H. M. & LONG, G. 1989: Med-checklist. A critical inventory of vascular plants of the circum - mediterranean countries 4 Dicotyledones (Lauraceae - Rhamnaceae). Conservatoire et Jardin botaniques de la Ville de Genève, Genève, 458+129 pp.
- INOCENCIO, C., RIVERA, D., OBON, M. C., ALCARAZ, F. & BARRENA, J. A. 2006: A systematic revision of *Capparis* section *Capparis* (Capparaceae) - *Ann. Missouri Bot. Gard.* 93: 122-149.
- KEW 2010: Kew Glossary - definition of heterotypic synonym: www.kew.org/Glossary/heterotypic-synonym.htm?prefix=h
- PAPARISTO, K., DEMIRI, M., MITRUSHI, I. & QOSJA, XH. 1988: Flora e Shqipërisë, Vol. 1. Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Qendra e Kërkimeve Biologjike, Tiranë, 457 pp.
- QOSJA, XH., PAPARISTO, K., DEMIRI, M., VANGJELI, J. & BALZA, E. 1992: Flora e Shqipërisë, Vol. 2. Akademia e Shkencave e Republikës

- së Shqipërisë, Qendra e Kërkimeve Biologjike, Tiranë, 446pp.
- QOSJA, XH., PAPANISTO, K., VANGJELI, J. & RUCI, B. 1996: Flora e Shqipërisë, Vol 3.
- Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Kërkimeve Biologjike, Tiranë, 331pp.
- RAKAJ, M., PIFKÓ, D., SHUKA, L. & BARINA, Z. 2013: Catalogue of newly reported and confirmed vascular plant taxa from Albania during 1990 – 2012. *Wulfenia* vol. 20: 17-42. Mitteilungen des Kärntner Botanikzentrums Klagenfurt.
- TUTIN, T. G., HEYWOOD, V. H., BURGESS, N. A., VALENTINE, D. H., WALTERS, S. M. & WEBB, D. A. (eds) 1964 – 1980: *Flora europaea* 1-5. Cambridge University Press Cambridge.
- VANGJELI, J. 2003: Udhëheqës fushor i florës së Shqipërisë. Tiranë, 598pp.
- VANGJELI, J., RUCI, B., MULLAJ, A., PAPANISTO, K. & QOSJA, XH. 2000: Flora e Shqipërisë, Vol. 4. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë Instituti i Kërkimeve Biologjike, Tiranë, 502pp.
- WCSP 2010: World Checklist of Selected Plant Families. Copyright © The Board of Trustees of the Royal Botanic Gardens; <http://apps.kew.org/wcsp/>.

Vlerësime ekofiziologjike të rritjes së drurëve dhe të shkurreve dekorative në ekosistemin urban të Shkodrës

Anila Mesi (Dizdari), Loreta Brahimi, Arjola Kurtalija, Klejda Pysqyli

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Fakulteti i Shkencave të Natyrës,
Departamenti i Biologji-Kimisë

PËRMBLEDHJE

Në këtë punim bëhen disa vlerësime ekofiziologjike të rritjes së drurëve dhe të shkurreve dekorative në ekosistemin urban të Shkodrës përmes analizës së spektrit florik, të formës biologjike Phanerophyta dhe nënformave përkatëse të evidentuara, mbulesës gjethore, antezës ose periudhës së lulëzimit, tipit korologjik, funksioneve ekologjike sipas kategorive të gjelbërimit urban, si dhe të ndikimit në shëndetin psikofizik të popullatës së zonës.

Eco-physiological evaluation of decorative trees and shrubs
growth in the urban ecosystem of Shkodra

ABSTRACT

The present paper has evaluated some eco-physiological features of the decorative trees and shrubs growth in the urban ecosystem of Shkodra through analyzes of floral spectrum and situation of the phanerophyta biological form and respective highlighted subforms, presence of leaf coverage, anthesis, chorological type, ecological functions according to urban greening categories and the impact on the psycho-physic health of area's human population have been done.

Hyrje

Bimësia dhe flora e një vendi janë pjesë tejet e rëndësishme e ekosistemeve. Ato ndikohen nga faktorët ekologjikë dhe janë hallka bazë e zinxhirëve ushqimorë për zhvillimin e formave të tjera të jetës. Bimësia dhe flora e Shqipërisë,

sikurse edhe ajo e Evropës në përgjithësi është e pasur në lloje (MITRUSHI, 1955, 1966; DEMIRI, 1979, 1983; PAPANISTO et al., 1992; Qosja et al., 1992, 1996; VANGJELI et al., 2000; VANGJELI, 2003). Pasuria florike e një zone ose vendi, kushtëzohet dhe ndikohet së tepërmi nga pozita gjeografike, faktorët klimatikë e pastërtia e mjedisit (CARMINATI & RANGHETTI, 2006; RUSSELL, 2011). Rajoni i Shkodrës, si rrjedhojë e relievit tejet të larmishëm dhe klimës së favorshme, që varion vijimësisht, dallohet për shumëllojshmëri ekosistemesh me një biodiversitet të pasur, ku bimësia dhe flora zënë vend dhe kryejnë funksione tejet të rëndësishme.

Rrallimi dhe mungesa e gjelbërimit ndjehet më shumë nga popullsia e qendrave urbane, sidomos e qyteteve, ku shpeshherë zënia e sipërfaqeve të mëdha me ndërtime, karakterizohet nga ndrydhja e bimësisë dhe pamjaftueshmëria (shpesh edhe mungesa) e programimit të sipërfaqeve të gjelbra dekorative, qofshin publike apo private (SICURELLA, 2003). Shumica e qyteteve shqiptare vuajnë mungesën e sipërfaqeve të gjelbra. Bimët drunore e shkurre janë komponentë tejet të rëndësishëm në ekosistemet urbane, siç është edhe qyteti i Shkodrës. Kultivimi tyre si bimë dekorative ka vlerë ekologjike, ekozhvillimore dhe mjedisore, sepse bimët drunore e shkurre veprojnë si “banka” të oksigjenit dhe eliminojnë ndotësit kimikë të ajrit; rregullojnë e normalizojnë temperaturën, pakësojnë zhurmat dhe i bëhen pritës erës (LASSINI, P. 2007). Ato kanë ndikim specifik tek mikroklima, ruajnë biodiversitetin, bëhen strehë për kafshët e egra dhe grumbullojnë energji. Për më tepër shërbejnë edhe si burim vlerash edukative, çlodhëse e argëtuese duke u përdorur në kopshtari, lulishtari, planifikim bio-estetik, art, kulturë e besim fetar (FORRAI et al. 2012).

Qëllimi i këtij punimi ka qenë hulumtimi i disa veçorive të rritjes së drurëve e shkurreve dekorative në ekosistemin urban të qytetit të Shkodrës, që e konsiderojmë të rëndësishëm dhe të domosdoshëm, sepse studime të mirëfillta shkencore në këtë fushë për Shqipërinë janë të pakta dhe kanë pasur më tepër karakter floristik dhe përshkrues (JANCHEN, 1920; MITRUSHI 1955, 1966; HOPFLINGER 1964; DINGA 1976; DEMIRI 1983; RUCI 1986; BARINA ET AL. 2013).

Materiali dhe metodat

Ekzaminimi dhe vlerësimi i diversitetit florik të shkurreve e drurëve dekorativë në parqe, në lulishte, në bulevarde, në rrugë, në rrugica, në oborret e shtëpive apo të institucioneve publike dhe private, në njësi shërbimi, në shkolla, në spitale, në objekte kulturi, në varreza. Ekzaminimi i nënformave biologjike të Fanerofiteve të evidentuara, si dhe ekzaminimi i tipareve morfologjike dhe të karakteristikave të rritjes e zhvillimit sipas llojit, pranisë së mbulesës gjethore

(bimë gjithmonë të gjelbra dhe gjetherënëse), periudhës së antezës (lulëzimit), variacioneve morfofiziologjike stinore, është bërë në terren gjatë periudhës tetor, 2011 deri në dhjetor, 2013. Kjo është shoqëruar me fotografim, duke përdorur aparat profesional FUJIFILM FinePix S4200, si dhe me marrje të materialeve bimore për qëllime taksonomike, duke i vendosur në dosje, qese plastike si dhe duke përdorur: gazeta për tharje e ruajtje, letër thithëse, etiketa, etj.




Figura 1. Harta e pikave të vëzhgimit dhe marrjes së mostrave në terren

Vlerësimi taksonomik është bërë sipas guidave të Florës së Shqipërisë [“Flora e Shqipërisë” vol. 1-4 (1988-2000); “Flora Eskursioniste e Shqipërisë” (1983); Dendroflora e Shqipërisë (1966)]. Janë intervistuar 32 specialistë të fushës në institucionet shtetërore (Prefekturë, Bashki, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Ndërmarrjen e gjelbërimit të qytetit, Drejtorinë e Shërbimit Shëndetësor Parësor, Laboratorin e Toksikologjisë dhe Higjienës së Punës, Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Ndërmarrjen e mirëmbajtjes së rrugëve), inxhinierë të pyjeve dhe të ish-serës së luleve, lulishtarë, punonjës të fidanishteve private, tregtarë të bimëve zbukuruese) me qëllim marrjen e informacionit në lidhje me përcaktimin e saktë të përbërjes llojore të shkurreve e drurëve dekorative të florës së ekosistemit urban të Shkodrës, përhapjes dhe gjendjes së llojeve të vjetra, të neofiteve, të kërkesave ekofiziologjike të tyre ndaj mjedisit e kujdesit nga njeriu, të faktorëve dëmtues natyrorë dhe antropogjenikë, të fakteve

historike që lidhen me përcaktimin e moshës së bimëve dhe rëndësisë së tyre historike, edukative e didaktike.

Rezultatet dhe diskutimi

Në ekosistemin urban të qytetit të Shkodrës kemi evidentuar praninë e 132 specieve bimore të përdorura si drurë e shkurre dekorative, të cilat u përkasin 80 gjinive dhe 54 familjeve të ndryshme (Tab. 1). Siç vihet re në figurën 2, pjesa më e madhe (86.2%) e bimëve të gjendura rezultojnë të jenë farëveshura (Magnoliophyta). 1 një gjini me 1 specie i përket Cycadophyta-ve, 6 gjini me 17 lloje Pinophyta-ve (Gymnospermae), ndërsa 73 gjini me 114 specie u përkasin Magnoliophyta-ve (Angiospermae).





Figura 2. Spektri taksonomik i bimëve të evidentuara

Magnoliophyta-t e evidentuara si bimë dekorative drunore e shkurre (Fig. 3a) janë në masën 90.9% dythelbore (Dycotiledonae) e pjesa tjetër njëthelbore (Monocotiledonae). Familjet me më shumë gjini (Fig. 3b) rezultuan: *Rosaceae* (11), *Fabaceae* (7), *Oleaceae* (6), *Arecaceae* (5), *Cupressaceae* dhe *Pinaceae* (3). Ndërsa familjet me më shumë specie rezultuan respektivisht: *Rosaceae* (20), *Oleaceae* (9), *Arecaceae* dhe *Cupressaceae* (9), *Pinaceae* (8), *Fabaceae* (7), *Salicaceae* (6), *Moraceae* (4), *Asparagaceae* dhe *Betulaceae* (3), etj. Figura 3c demonstroi se gjinitë me numrin më të madh të llojeve rezultuan: *Cupressus*, *Pinus* dhe *Rosa* (5), *Citrus* (4) dhe *Abies*, *Ligustrum*, *Pinus*, *Populus* dhe *Salix* (3).



numrin më të madh të llojeve të evidentuara

Trëndafiloret janë një ndër familjet me numrin më të madh të llojeve dhe përfshijnë shumë bimë drunore e shkurre të kultivuara si bimë dekorative për

formën, pigmentet dhe aromat e luleve (kryesisht trëndafilat) (Pignatti, 1982). Kjo familje përmbledh edhe një pjesë të konsiderueshme (pjesën më të madhe të trëndafiloreve në këtë punim) të drufrutorëve. Shumë familje në Shkodër (sidomos në pjesën jugore e jug-perëndimore të qytetit), kultivojnë si bimë dekorative në oborret e kopshtet e tyre private variete të ndryshme: kumbullash (7), qershish (3), dardhash (3), pjeshkash (3) e më pak mollësh (2), si dhe ftoin, bajamen (Draçin, Ndocej, Perash), kajsinë (zerdelinë), vishnjën (e rrallë, e gjetur vetëm në pak familje në lagjen “Tepe”, “Draçin”, “Luguçesme”, “Ndocej” e tek bar-restorant “Legjenda”); mushmollën e dimrit e të verës (Ndocej, Kiras, tek ish-fidanishtja në Rus). Trëndafiloret shkurre e të perkasit më së shumti gjinisë *Rosa* dhe janë gjetur të përhapur si bimë dekorative gjithandej në qytet në mjedise publike: lulishtja tek shatërvani përpara Prefekturës, sheshi “Isa Buletini”, sheshi “Demokracia”; objekte kulti si: oborri i Xhamisë së Madhe, Kisha e Madhe (Katedralja); si dhe shumë oborre shtëpish private e njësisht shërbimi; më pak në oborre shkollash, si: Shkolla Pyjore, Shkolla “Jordan Misja”, “Ndoc Mazi”, “Salo Halili”, “Ismail Qemali”, etj. Veçojmë *maragjylin* ose trëndafilin e Damaskut, i cili pas një periudhe pothuaj zhdukjeje po ripërtërihet, ndonëse përfaqëson një ndër llojet më delikate të trëndafilave. Është konstatuar prania e tij në lulishten tek Shatërvani, në oborrin e Xhamisë së Madhe, si dhe në disa familje në lagjet: “Gjuhadol”, “Perash”, “Xhabije”, “Tophanë”, “Garuc”. Lulekaçja si shkurre kacavjerrëse është gjetur në muret e dyerve të oborrit në disa familje sidomos në lagjen “Ndocej”, “Dudas”, “Kiras”, “Rus”, në “Gjuhadol”, “Serreq”, në rrugën “Pogej”, “Ludovik Saraçi”, etj. Ushinthe është gjetur si shkurre që formon gardhe dekorative ndarëse, sidomos në sajë të ngjyrës së spikatur të frutave në shumë familje e njësi shërbimi në qytet. *R. villosus*, është konstatuar të kultivohet në bar-restorant “Legjenda”, në një familje në lagjen “Vasil Shanto”, ndërsa manaferra (*R. Ulmifolius*) gjendet si bimë e egër në “Draçin”, “Luguçesme”, “Alibegaj”, “Kiras”, “Dudas”, “Rus”, “Bahçellek”, “Perash”, në ish-zonën industriale, etj., dhe ka vlerë për frutat e saj, por nuk është përfshirë në listën e specieve, sepse nuk përdoret si shkurre dekorative. Nga pikëpamja ekofiziologjike *Ullioret*, i janë përshtatur mirë jetesës në pellgun e Mesdheut ku rritet një numër i konsiderueshëm llojesh (RUSSELL, 2011, Web 1). Bima me rëndësinë ekonomike më të madhe konsiderohet ulliri (SEITH, 2004). Është gjendur i mbjellë si bimë dekorative sidomos në pjesën jugore të qytetit, në mjedise publike, në fshatin e Paqes (i *vetmi vend* ku kemi konstatuar edhe praninë e *ullastrës*), në bar-restorantet buzë lumit Buna, në parkun tek ish-pazari i Bexhistenit, si dhe në shumë familje të lagjeve afër bregut të liqenit. *Frashri* është gjetur në fshatin e Paqes, në një familje

në lagjen “Vasil Shanto” dhe “Serreq”, ndërsa ligustrat janë bimët më të përhapura (si drurë në rrugën: “Kolë Heqimi”, “Bashkimi”, bulevardin “Zogu I”, etj.; si shkurre ndarëse buzë rrugës, në lulishte publike e oborre private kudo nëpër qytet). Duke qenë gjethembajtëse këto bimë plotësojnë dekorin e zhveshur dimëror të natyrës në qytet, duke pasur edhe ndikim psikosocial pozitiv mbi popullsinë. *Jasemini* e *jargavani* janë bimë të familjes *Oleaceae* që gjenden gjithandej duke u kultivuar në mjedise private kryesisht për lulet e tyre, që kanë efekt dekorativ të spikatur në stinën e pranverës. Nga intervistat me specialistë të fushës rezulton se jargavani kultivohet në Shkodër prej më se 150 vjetësh, duke përbërë bashkë me maragjylin dy ndër shkurret më të vjetra në historinë e lulëtarisë në traditën shkodrane. Kjo bimë quhet ndryshe lulja e majit dhe ndikimi i saj në sferën emocionale të qytetarisë shkodrane është memorizuar edhe në tekste këngësh.

Bishtajoret kanë aftësinë të bashkëjetojnë në simbiozë me bakteret azotofiksuese, prandaj prania e këtyre bimëve edhe si bimë dekorative ndihmon edhe bimët e të njëjtit asociacion bimor për të përfituar nga sasia e azotit në rizoferën e përbashkët. Sallgami është bimë që kërkon sasi të madhe uji dhe rritet shumë shpejt. Gjendet në gjendje të egër kudo buzë liqenit, ndërkohë që kultivohet po jashtë vijës së verdhë të qytetit e në periferi të saj në shumë familje, pak në oborre, më shumë në kopshte. E kemi evidentuar të kultivuar në disa njësi shërbimi private në Bahçellek, buzë lumit Buna, etj. Lofata kultivohet për lulet me pigmente tipike rozë të errët, është gjetur e kultivuar (11 ekzemplarë) në bar-restorant “Legjenda”, “Shqiponja”, në sheshin “Isa Buletini”, lulishten tek shatërvani, etj. *Xhixhibanuzi* është bimë e familjes bishtajore që nuk e kemi ndeshur shpesh në ekosistemin urban të qytetit të Shkodrës, e gjetur vetëm në një njësi shërbimi në lagjen “Alibegaj” dhe në një familje në lagjen “Ndocej”. Mimoza lulëzon herët në pranverë dhe lulet prodhojnë komponime aromatike tipike. Është bimë delikate, që nuk përshtatet mirë me klimën, pasi me vështirësi përballon dimrat e ftohtë e me reshje të vazhdueshme e ngrica, Prania e saj është konstatuar në Luguçesme, Draçin e Ajasëm, oborrit e Spitalit rajonal Shkodër. Albicja është bimë relativisht e re në Shkodër, lulet e saj janë tejet dekorative dhe frytet e gjatë bishtajë, krijojnë një sfond interesant për lokalet e shërbimit ku është kultivuar këto 10-15 vitet e fundit. Rritet shpejt dhe është gjendur në lulishten e shatërvanit, oborrit e Xhamisë së madhe, në breg të Bunës, rruga “Vëllezërit Frashëri”, etj. Nga kultivuesit e bimëve dekorative kjo bimë rekomandohet për t’u mbjellë në kopshte e parqe, sepse gjethet e saj ekstraktojnë komponime volatile që largojnë insektet si mizat e mushkonjat në stinën e pranverë-verës (GUILTE et al. 2006).

Arecaacet, që në gjuhën e përditshme njihen si palma, janë bimë dekorative të

futura relativisht vonë në qytetin e Shkodrës (sidomos në 10 vitet e fundit). Projektet e gjelbërimit të zonës urbane në Shkodër kanë inkurajuar mbjelljen e rritjen e këtyre bimëve nëpër hapësirat publike në qytet (ANONIMA, 2012), si dhe kultivimin në fidanishte private, që si përparësi kryesore kanë plotësimin e nevojave të tregut për bimë dekorative. Ka 7 fidanishte të lokalizuara jashtë vijës së verdhë të qytetit ku kultivohen palma. Ndërkohë që këto bimë po përhapen e gjenden tashmë në sheshin “Demokracia”, në lulishten “Luigj Gurakuqi”, në sheshin “Isa Buletini”, rruga “Teuta”, në oborrin e Xhamisë së Madhe, në parkun e Pazarit e në shumë lokale shërbimi e shtëpi private.

Selviolet i kemi konstatuar të mbjella dhe të rritura si bimë dekorative në të gjitha lulishtet publike të qytetit, në oborrin e Xhamisë së Madhe, në lulishten e Katedrales Katolike, në Kishën ortodokse dhe në *C. sempervirens* është e vetmja bimë dekorative në territorin e vogël rrethues të Teqes në lagjen “Ndocej”. Lulishtja “Luigj Gurakuqi” i përmban në gjendje të mirëmbajtur e në shëndet të plotë të 5 përfaqësuesit e gjinisë *Cupressus*. Përveç kësaj përfaqësuesit e gjinive *Cupressus* dhe *Thuja* përbëjnë florën mbizotëruese të varrezave. Në oborret e shkollave: “Oso Kuka”, “Ismail Qemali”, “28 Nëntori”, “Jordan Misja”, e sidomos në fidanishten e Shkollës Pyjore, si dhe në oborrin e Spitalit Rajonal, Fshati i Paqes, etj., gjenden selvi e më pak tuja. Këto bimë kultivohen me shumicë edhe në fidanishtet që tregtojnë bimë dekorative shkurre e drunore për qytetin e më gjerë.

Përfaqësuesit e familjes *Pishore*, që rriten si bimë dekorative në ekosistemin urban të qytetit të Shkodrës përmbledhen në 8 lloje, që u përkasin tri gjinive. Vlera e tyre qëndron në faktin se janë gjithmonë të gjelbra. Ato dekorojnë me të gjelbrën e thellë deri në gri, disa nga rrugët, lulishtet dhe oborret private. Prodhojnë sasi të konsiderueshme oksigjeni gjatë gjithë vitit dhe tërheqin gaze të helmëta e thërmija pluhuri, etj. CHAKRAVERTY & JAIN, 1984; KOHLI, 1996). Bredhat, pishat dhe cedruset janë gjendur të pranishëm në lulishten “Luigj Gurakuqi”, në oborrin e Xhamisë së Madhe, në lulishten e shatërvanit, në sheshin “Demokracia”, përpara ndërtesës së Rektoratit, tek bar-restorant “Shqiponja”, “Marku”, “Shkodra park”, Muzeu, në oborrin e Shkollës Pyjore, etj. Bredhat në përgjithësi rriten shpejt dhe në fidanishte po kultivohen sidomos në periudhën e dimrit para festës së Krishtlindjes e Vitit të Ri.

Në pjesën jug-perëndimore e jugore të qytetit është vënë re me shumicë prania e shelqeve, kryesisht shelgu i bardhë e gri. Sipërfaqja e mbjellë me shelqe ka zbritur ndjeshëm pas viteve 90’, si pasojë e mbylljes së Ndërmarrjes xunkth-kashta, që i ka përdorur gjerësisht shelqet për përgatitjen e karrigeve, tryezave, shportave e çantave. Sot kjo traditë ka humbur plotësisht. Zënia e sipërfaqes së tokës në afërsi të bregut të liqenit të Shkodrës me ndërtime, sidomos shtëpi

banimi, ka reduktuar ndjeshëm numrin e llojeve dhe ekzemplarëve. Për realizimin e një fiziologjie normale të rritjes e zhvillimit, këto bimë kërkojnë shumë ujë, pjesa më e madhe e shelqeve ornamentale është e përqendruar në buzë të lumit Buna e Drin (Bahçellek), e sidomos në baret e restorantet e kësaj zone; në shumë oborre e kopshte private të lagjeve “Dudas”, “Tophanë”, “Ndocej”, tek ish-fabrika e tullave, Kiras, ish-zooteknika, etj. *Salix babylonica* gjendet rëndom si bimë dekorative nëpër qytet si p.sh., tek lulishtja publike tek shatërvani, sheshi “Isa Buletini”, Fshati i Paqes, etj.

Në punim janë evidentuar të jenë të pranishme një numër i konsiderueshëm familjesh me numër të pakët gjinish (1 ose e shumta 2) e po ashtu me nga një përfaqësues të vetëm llojor. Kështu vjen të përmendet *arra e butë*, një bimë drunore gjetherënëse që jeton gjatë. Më tej duhet veçuar përhapja në shtim e sipër e *cikës*, e vetmja përfaqësuese e Ndarjes Cycadophyta. Kjo bimë është evidentuar si dru në njësi shërbimi e lulishte dhe më tej në shumë familje shkodrane. Bafra në formë shkurreje e rritur deri në 1.2 m, është gjetur në bar-restorant “Legjenda”, si dhe në 12 familje në lagjet “Tepe”, “Qafë”, “Tophanë”, “Serreq”, “Ndocej”. Rritet shumë ngadalë dhe preferon, sipas kultivuesve, toka gëlqerore të ajrosura mirë dhe shumë diell.

Objekt i studimit të këtij punimi kanë qenë bimë të cilat i përkasin formës biologjike Fanerofite (Phanerophyta). Fanerofitet (P) janë bimë shumëvjeçare të drurëzuara me sythe që vendosen në një lartësi mbi 30 cm nga sipërfaqja e tokës dhe që u rezistojnë temperaturave të ulëta kushtet e papërshtatshme të klimës në stinën e ftohtë. Sipas klasifikimit të ELLENBERG & MUELLER-

DOMBOIS (1967) ato përmbledhin disa nënforma biologjike: *Nanofanerofitet* (NP), *Fanerofitet drunore* (P scap), *shkurrore* (P caesp), *kacavjerrëse* (P lian) dhe *sukulente* (P succ).

Siç mund të vihet re në figurën 4 në sipërfaqet e gjelbra brenda qytetit të Shkodrës predonimojnë dukshëm fanerofitet dekorative drunore.

Bimët e studiuara në këtë punim paraqesin dy tipe grupesh funksionale në lidhje me praninë e mbulesës gjethore (BGH, 2010).

Në përputhje me kushtet tipike klimaterike të zonës gjeografike ku




Figura 4. Spektri i nënformave biologjike të evidentuara

gjendet qyteti i Shkodrës dhe pjesa urbane e tij (me dimër të lagësht e të butë dhe verë të thatë e të nxehtë) pjesa më e madhe e llojeve të evidentuara si drurë e shkurre dekorative rezultojnë gjetherënëse (70), pjesa tjetër gjithmonë të gjelbra (59), ndërsa 2 lloje respektivisht *Solanum crispum*, është pothuaj gjethembajtëse dhe hibridet e trëndafilave, të cilët në stinën e dimrit më së shumti i hedhin gjethet (Fig. 5). Përgjithësisht trëndafilat gjatë verës 2013, u zhveshën në masë nga mbulesa gjethore, jo për shkak të temperaturave të larta (faktor mjedisor abiotik i tipik për klimën e zonës), por rezultoi se dukuria u shkaktua nga dëmtimi në masë prej krimbave (faktor biotik). Shkatërrim masiv të pigmenteve fotosintetike manifestoi edhe *Aesculus hippocastanum*, gjë që u bashkëshoqërua edhe me rrëzim të parakohshëm dhe të pjesshëm të mbulesës gjethore, duke paralajmëruar simptoma të vjeshtës së hershme në gusht të vitit 2012, gjë që u konstatua edhe tek *Acer platanoides* në shtator të vitit 2013.

Gjatësia e antezës (periudha e jetës së bimës, gjatë së cilës lulet janë të hapura dhe strukturat lulore plotësisht funksionale) si një tipar gjenetikisht i trashëgueshëm i çdo specieje ndryshon sipas llojit, varietetit, ndikimit të faktorëve mjedisorë abiotikë e biotikë, etj., (FITTER & HAY, 2009). Anteza zakonisht ndodh në një periudhë të caktuar të vitit që është karakteristike për çdo specie dhe është e lidhur me fotoperiodën. Për këtë arsye dallohen bimë *longidiurne*, të cilat lulëzojnë kur dita është më e gjatë se nata, *brevidiurne*, që lulëzojnë kur gjatësia e ditës shkurtohet ndjeshëm krahasuar me natën dhe bimë *neutrodiurne*, lulëzimi i të cilave nuk varet nga raporti mes gjatësisë së ditës e natës (Miho & Shuka, 2003). Paraqitja grafike e antezës së bimëve drunore e shkurre të përdorura për dekoracion në ekosistemin urban të qytetit të Shkodrës në figurën 6, ka përjashtuar bimët e Familjes *Pinaceae* si dhe disa bimë, në të cilat nuk është vërejtur prania e lules gjatë periudhës kur është kryer studimi (palma kaliforniane, fikusi, etj.). Pjesa më e madhe e llojeve rezultuan longidiurne (lulëzojnë nga marsi deri në korrik), pjesa tjetër janë brevidiurne.

Korologjia studion shpërndarjen gjeografike të organizmave të gjallë si dhe faktorët fizikë mjedisorë (kryesisht ata klimatikë) që kushtëzojnë dhe ndihmojnë përhapjen dhe aklimatizimin e gjallesave. Vlerësimi i tipit korologjik të bimëve është bërë në këtë punim me qëllimin për të evidentuar aftësinë e bimëve të kultivuara autoktone për t'i rezistuar streseve mjedisore si dhe aftësive të adaptimit të bimëve neofite. Nga analiza korologjike e bimëve drunore e shkurre, që kemi evidentuar të pranishme në ekosistemin urban të qytetit të Shkodrës (sipas PIGNATTI, 1982; RUSSELL, 2011 dhe Web 1-3, 6), rezulton se vetëm 58% e bimëve kanë origjinë e përhapje nga Evropa e

vetëm 1.5% janë specie tipike mesdhetare Kjo tregon se shumica e bimëve autoktone kanë humbur aftësinë për të mbisunduar në florën e kultivuar, e cila dominohet nga bimë të introduktuara sidomos nga Azia, Amerika e Veriut dhe e Jugut, Afrika Veriore e deri edhe Australia. Rezulton vetëm një bimë Ilirike (Ballkani Perëndimor), e cila ruan origjinalitetin e saj në mjedisin e origjinës (*A. hippocastanum*).

Gjelbërimi urban klasifikohet në zona dhe kategori që kanë karakteristikat




Fig. 5 Evidentimi i pranisë së mbulesës gjethore




Fig. 6 Evidentimi i periudhës së antezës

e veta fizike dhe floristike, por sidomos funksionale (SICURELLA, 2003; GAIA, 2011).

1. Zona “Gjelbërim rrugor” përfshin disa kategori, ndërsa drurët e shkurret që më me shumicë kemi konstatuar të pranishme në këtë zonë sipas kategorive përkatëse në Shkodër (Fig. 7) janë:

- a. rrugë të gjelbëruara (*A. platanoides*, *A. altissima*, *C. australis*, *M. grandiflora*, *T. Platiphyllus*),
- b. ndarëse rrugësh të gjelbëruara (*N. oleander*, *B. sempervirens*, *L. vulgare*, *R. Ferrugineum*);
- c. rrethrotullime të gjelbëruara (*P. canariensis*, *Rosa sp.*, *H. macrophylla-hortensis*, *N. oleander*, *Ligustrum sp.*, *Cupressus sp.*),
- d. parkime të gjelbëruara (*S. babilonica*, *P. canadensis*, *A. Altissima*).


Ka disa bimë të cilat falë karakteristikave të tyre botanike dhe përshtatjes ekofiziologjike u kanë dhënë emrin lagjeve apo rrugëve si: “te Arra e madhe”, rruga e “kumbullave” në Kiras, etj.

2. Zona “Hapësira të gjelbra” klasifikohet në disa kategori, prej të cilave në ekosistemin urban të qytetit Shkodër (Fig. 8) kemi konstatuar:

a. *gjelbërim arredues*: përfshin kënde shumë të vogla të gjelbëruara e sidomos

vendosje bimësh në vazo të mëdha, aty ku nuk mund të mbillen direkt në dhé (trotuare, oborre, përpara dyqaneve, etj.). Bimët e konstatuara më së shumti në këtë kategori janë: *P. canariensis*, *Rosa sp.*, *F. elastica*, *B. sempervirens*, *C. limon*. *C. cyparis*, *R. ferrugineum*, etj. Faqatat e gjelbëruara të ndërtesave (kryesisht shtëpi private) të veshura me fotinia, urth e partenocis janë gjithashtu pjesë e kësaj kategorie dhe gjenden të përhapura gjithandej në qytet;

Figura 7. Gjendshmëria e llojeve të evidentuara (në % të totalit të



përgjithshëm) në zonën “Gjelbërim rrugor” sipas kategorive përkatëse

b. *lulishte publike*: hapësira e gjelbër më e madhe në qytet është Parku Pazar, i cili ka një sipërfaqe prej 17000 m² (69 drurë e 183 shkurre dekorative, të mbjella e të mirëmbajtura nga Bashkia). Aktualisht qyteti ka vetëm 7 lulishte (Bashkia Shkodër, 2012), të cilat minimalisht plotësojnë kriteret e parkut të lagjes (sip. deri në 4 dynym): Lagja “Perash” (ish-arka e kursimit dhe sheshi “Isa Buletini”), Shatërvani, Gjimnazi “28 Nëntori”, Stacioni i trenit, Parku “Luigj Gurakuqi” dhe Zona industriale. Përbërja florike më heterogjene dhe më pak e sistemuar i takon kësaj kategorie dhe përmbledh kryesisht: *Abies sp.*, *A. hippocastanum*, *B. sempervirens*, *C. citrinus*, *Cedrus sp.*, *C. siliquastrum*, *C. humilis*, *Cupressus sp.*, *H. macrophylla-hortensis*, *Ligustrum sp.*, *M. grandiflora*, *N. oleander*, *O. europea*, *R. ferrugineum*, *Pinus sp.*, *R. pseudoacacia*, *Rosa sp.*, *S. babilonica*, *T. platiphylos*, *T. orientalis*, *T. plicata*, *T. fortune*, *Washingtonia sp.*, *Yucca sp.*, etj.;

- c. *gjelbërim i ndërmjetëm* (pedonalja buzë liqenit, oborret dhe kopshtet private në hapësirën buzë liqenit dhe në lagjet periferike të pjesës jug-perëndimore të qytetit), ku mbizotërojnë si drurë e shkurre dekorative: *A. platanoides*, sallgami e shelqet, drufrutorët.;
- d. *gjelbërim shkollor* (oborre të gjelbëruara shkollash): më e pasur në lloje është Shkolla Pyjore, e cila është e pajisur edhe me fidanishte, ku kemi evidentuar praninë e cedrit, dëllinjës, bredhit, pishave, selvisë, ilqes, tujës, selvisë. Ilqes, tujës, albicjes, plepave, akacies, murrizit, dafinës, lajthisë, katalpës, frashrit, shelgjeve, arrës, blirit, eukaliptit, luleviles, manjolës, lofatës, bushit, mimozës. Po ashtu shkolla “Jordan Misja” ka oborr të gjelbëruar, i cili shfrytëzohet si vend rekreacioni nga nxënësit e stafi mësimdhënës. Oborri i gjimnazit “28 Nëntori”, ndonëse realisht i gjelbëruar, është kthyer në një mjedis publik, megjithatë ai nuk përdoret nga nxënësit, pasi disa lokale shërbimi private gjenden në të njëjtën hapësirë. Përpara ndërtesës së Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe ndërtesës së Rektoratit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” ka disa bimë dekorative, si: *T. orientalis*, *T. bacata*, *L. lucidum*, *M. grandiflora*, *C. arizanica*, *A. alba*, *P. canariensis*, *Y. filimentosa*, etj. Ndërsa në oborrin e Fakultetit të Shkencave të Edukimit mbizotëron oleandri;
- e. *gjelbërim spitalor* (oborre në Spitalin Rajonal Shkodër): është hapësira e gjelbër më e reduktuar në ekosistemin urban të qytetit, pothuajse mungon në afërsi të repartit të psikiatrisë, ku do të kishte vlerë të jashtëzakonshme në kurimin specifik të pacientëve. Kemi evidentuar praninë e selvive, mimozës, lofatës, shelqeve, palmave, manjolare, ligustrave, blirit, oleandrit, fojletës, albicjes, larit, ilqes, rrënjës, etj.;
- f. *gjelbërim i objekteve të kultit*: predominon *Cedrus sp.*, *Cupressus sp.*, *T. orientalis*, *P. pinea*, *A. alba*, *Rosa sp.*. Nga vëzhgimet dhe puna në terren e zhvilluar gjatë përgatitjes së këtij punimi, më i pasur në lloje rezultoi të jetë oborri i Xhamisë së Madhe dhe lulishtja pranë Katedrales ku kemi evidentuar edhe jaseminin, luleborën, ullirin, kivin, luledimrin, etj.;
- g. *gjelbërim i varrezave*: analizohet për herë të parë në këtë punim. Kemi konstatuar se varrezat publike janë tejet të varfra në bimësi. Llojet më të përhapura janë: *C. sepervirens*, *A. altissima*, *Rosa sp.*, *B. sepervirens*, *Ligustrum sp.* Ka bimë shumë të reja në moshë, si: *A. hippocastanum*, *A. alba*, *Cedrus sp.*, *T. bacata*, palmat e lartpërmendura, etj. Varrezat katolike kanë të veçantë praninë e 2 ekzemplarëve *Platanus orientalis*. Selvitë janë bimët më tipike edhe të kësaj varreze, si dhe vihet re (si pasojë e mungesës së sipërfaqes së tokës) mbivendosje e bimëve, gjë që pengon edhe rritjen e zhvillimin e tyre normal si dhe prishjen e varreve;


- h. gjelbërim i ndërmarrjeve*: është pothuaj inekzistent, përveç disa mbetjeve të ish-ndërmarrjeve të vjetra në ish-zonën industriale që tashmë janë privatizuar ku spikat: *H. syriacus*, *H. helix*, *C. cyparis*, *L. vulgare*, *P. Pinea*;
- i. fidanishte*: kemi konstatuar praninë e 7 fidanishteve, të cilat janë të vendosura përtej vijës së verdhë të qytetit (Bahçellek 2, Pentar 2, Stomgolem 1, Vau I Dejës 1, Beltojë 1), ku realisht mungon hapësira e duhur për të kultivuar në mënyrë të suksesshme fidanë. Fanerofitet dekorative që kultivohen me shumicë janë: bredhat, selvitë, ligustrat, trëndafilat, palmat, tisi, fikusi, bushi dhe të gjithë drufrutorët;
- j. gjelbërim i oborreve e kopshteve private*: bimët e përfshira në tabelën 1 janë gjendur pothuaj të gjitha edhe në kopshte e sidomos oborre të shtëpive e vilave private. Kultura e hershme e kultivimit të bimëve dekorative po ripërtërihet sidomos në dekadën e fundit në Shkodër;
- k. gjelbërim i lagjeve* përfaqësohet nga lulishtet publike po edhe nga disa kënde të gjelbëruara kryesisht në rrugë private ose fondacione të evidentuara në Xhabije, tek monumenti i Prek Calit, shtëpia muze “Oso Kuka”, në zonën që njihet si Bahçja e Çakejve, etj.

Ndikimi i fanerofiteve dekorative në zvogëlimin e efektit serë

Temperatura mesatare e sipërfaqes së rruzullit tokësor është rritur me $\sim 0.6^{\circ}\text{C}$ dhe shkak kryesor është efekti serë. Prania e niveleve të larta të gazit karbonik ($\sim 400\text{ppm}$, Web, 4), avujve të ujit, metanit dhe ozonit, kontribuon për të ngadalësuar jashtëzakonisht shumë shpejtësinë e shpërhapjes së energjisë diellore në hapësirë (WILLIAMS et al. 2009). Siç dihet bimët tërheqin nga atmosfera CO_2 -shin, duke e fiksuar karbonin gjatë fotosintezës dhe duke e magazinuar atë në formën e biomasës. Është shumë e vështirë të vlerësohet nga pikëpamja sasiore përthithja e CO_2 -shit nga një bimë e vetme në një interval të shkurtër kohe. Në fakt përmasat e çdo bime (që më së shumti ndikojnë në këtë proces) ndryshojnë në varësi të llojit të bimës, moshës, vëllimit të kurorës dhe ndërhyrjeve për mirëmbajtjen e saj nga ana e njeriut (në rastin konkret të bimëve dekorative të studiuara në këtë punim: ujitja, plehërimi, krasitja, etj.). Aktualisht Shkodra ka përafërsisht 100000 kërkesa për mobilitet motorik në ditë, e gjithë Prefektura ka në qarkullim 35173 automjete, prej të cilave rreth 10% janë automjete të rënda (kamionë, autobuza, furgona). Gjithsesi duke iu referuar studimeve të bëra mund të thuhet se një bimë shumëvjeçare (kryesisht fanerofitet) tërheq nga atmosfera mesatarisht 30g CO_2 në vit (FORRAI et al., 2012). Duke ditur se një automjet i vogël dhe një kamion emetojnë përafërsisht

130 dhe 700 g CO₂/km do të nevojitej minimalisht 10-fishi i fanerofiteve të pranishme në ekosistemin urban të Shkodrës për të mënjanuar ndotjen e ajrit dhe zvogëluar efektin serë.

Figura 8. Numri i llojeve të evidentuara (në % të totalit të përgjithshëm) në zonën



“Hapësira të gjelbra”, sipas kategorive përkatëse

Filtrimi i ndotësve të ajrit

Njësia e masës e përdorur për të vlerësuar nga pikëpamja sasimore ndotjen nga grimcat ose thërrmijat që rrinë pezull në ajër është PM₁₀, pjesëz thërrmijore që ka diametër më të vogël se 10µm e matshme në µg/m³ të ajrit. Këto lloj thërrmijash përbëjnë pjesën më të madhe të thërrmijave të pranishme në atmosferë. PM₁₀ formohen nga përbërje me origjinë organike dhe inorganike dhe çlirohen në atmosferën qytetëse kryesisht nga gomat e automjeteve dhe përdorimi i naftës si karburant. Ndërsa PM_{2.5} (Φ më e vogël se 2.5 µm), thërrmija tejet të imëta, përmban në pjesën më të madhe pjesëza të shpërhapura nga aktiviteti antropogjenik: bloza, nitrate e sulfate. Qendrat urbane përmbajnë sasinë më të madhe të PM-ve, kryesisht si pasojë e sasisë së madhe të mjeteve të motorizuara që qarkullojnë përditë. Është pikërisht kjo përqindje e ulët e thërrmijave të imëta të pranishme në atmosferë (krahasuar me PM₁₀) shkaktarja e shumë sëmundjeve të aparatit të frymëmarrjes, sëmundjeve kardiovaskulare e lodhjes fizike. Problemi përkeqësohet, sepse në mjediset urbane si qyteti i Shkodrës (përveç PM₁₀, që vjen në rritje nga mosrespektimi i legjislacionit mjedisor, nga industria e ndërtimit dhe mospastrimi i mjediseve publike nga entet përgjegjëse) pjesa më e madhe e këtyre ndotësve vijnë nga trafiku rrugor. Në figurën 13 janë paraqitur vlerat e monitorimit të ndotësve kryesorë të ajrit të kryera gjatë vitit 2013 (monitorimi bëhet një herë në muaj në Laboratorin e Toksikologjisë dhe Higjienës së Punës pranë Drejtorisë së

Shërbimit Shëndetësor Parësor, Shkodër, dhe në grafik janë paraqitur vlerat mesatare për periudhën janar-dhjetor 2013). Vihet re qartë se vlerat e PM-ve të pranishme në ajër janë shumë më të larta sesa kufiri maksimal i lejueshëm nga KE.

Gjethet e bimëve kanë aftësinë të “kapin” thërmijat që depozitohen mbi sipërfaqen e tyre. Pjesëza të tilla mund të depërtojnë epidermën gjethore, *bioakumulohen* dhe të bëhen pjesë e metabolizmit të bimëve (duke shkaktuar shpesh simptoma të ndotjes kimike në bimët e kontaminuara) ose akumulohen në sipërfaqe dhe depozitohen përfundimisht në dhé nga bimët gjetherënëse (Web 5). Përllogaritet se një bimë drunore me lartësi 5-7 m mund të tërheqë mesatarisht 1000g PM_{10} ~57 $\mu\text{g}/\text{m}^3$. Bimë si *T. platiphyllus* e *C. australis* të evidentuara si pjesë e gjelbërimit rrugor në Shkodër përllogaritet se në një periudhë 30 vjeçare në këtë kategori gjelbërimi urban përthithin deri në 3660 kg CO_2 , ndërkohë që janë të afta të tërheqin sasi maksimale ndotësish të gaztë të pranishëm në ajër (kryesisht NO_x) dhe PM_x , po ashtu *A. glutinosa* tërheq mesatarisht 3310 kg CO_2 , mesatarisht gazra ndotës e sasi të larta thërmijash, *P. cerasifera var. atropurpurea* 2160 kg CO_2 , sasi shumë të larta gazrash e mesatare thërmijash pluhuri (GAIA, 2011).




Figura 13. Të dhëna për monitorimin e ndotësve të ajrit në qytetin e Shkodrës

Shënim: Të dhënat janë siguruar nga Drejtoria e Shërbimit Shëndetësor Parësor dhe Shëndetit Publik që monitoron në vazhdimësi praninë dhe nivelin e ndotësve të ajrit në stacionin pranë Fakultetit të Shkencave të Edukimit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.

Rregullimi i mikroklimës

Procesi fiziologjik që qëndron në bazë të rregullimit të mikroklimes së bimësisë është *transpirimi*. Në këtë mënyrë temperatura përreth kurorës së bimëve zbrit dhe vëllimi i ajrit të thatë e të tejngarkuar me ndotës, furnizohet me ajër të freskët e të lagësht. Forma e kurorës së bimës, shpejtësia me të cilën rritet bima, ndikojnë mbi potencialin e hijezimit të saj dhe për pasojë edhe uljen e temperaturës. Studime të kohëve të fundit kanë treguar se disa bimë drunore që rëndom përdoren si bimë dekorative të rrugëve në zonat urbane të pellgut të Mesdheut, të evidentuara edhe në Shkodër, si: plepi, panja rrapë, akacia, etj., transpirojnë 229-1686 g ujë/ditë/m² të sipërfaqes gjetshore, që i korrespondojnë një zvogëlimi nxehtësie me 133 dhe 978 kkal/ditë/m² (SICURELLA, 2003; LEUZINGER et al., 2010; FORRAI et al. 2012).

Kurora në sajë të zhvillimit të saj tredimensional ka aftësinë të përthithë rrezatimin diellor dhe të reduktojë sasinë e energjisë që arrin sipërfaqen e dheut, falë dukurisë së reflektimit të dritës. Kështu jo vetëm transpirimi, por edhe aftësia reflektuese ndikojnë në vlerën reale të temperaturës në vëllimin e ajrit përreth bimëve. Studime specifike në këtë fushë tregojnë se fanerofitet buzë rrugëve mund ta ulin temperaturën 3-5°C (SICURELLA, 2003; LEUZINGER et al. 2010). Kjo dukuri perceptohet qartë gjatë stinës së verës në Bulevardin “Bujar Bishanaku” dhe në rrugën “Martin Camaj”, ku veshja me *A. platanoides* dhe *C. australis* zbut efektin e jashtëzakonshëm negativ të ndotjes së mjedisit (pluhur, gaze, rritje temperature) nga trafiku i dendur. E kundërta ngjet në rrugën “Kolë Idromeno”, ku rindërtimi i pedonales largoi *dhunshëm* disa ekzemplarë të *T. Platiphylos*, duke lënë zbuluar një pjesë të rrugës që gjatë dy verave të fundit, vuajti një rritje të madhe të temperaturës nga mungesa totale e hijezimit dhe shtrimi i rrugës me pllaka. Fanerofitet shkurre dhe kacavjerrëse, si: *C. grandiflora*, *H. helix*, *P. quiquefolia*, *L. japonica*, *S. Crispum*, *V. vinifera*, përveç efektit të mirëfilltë dekorativ, të gjelbërimit që u bëjnë mureve e sipërfaqeve vertikale dhe luleve me forma interesante, si dhe pigmente shumëngjyrëshe dhe aroma të spikatura, i mbrojnë këto sipërfaqe nga tejngrohja, duke ruajtur një temperaturë të brendshme të ndërtesave dhe oborreve shumë më të ulët sesa ajo e mjedisit të jashtëm. Evidentojmë faktin se në shumë lagje sidomos ato periferike këto bimë i kemi gjetur gjithandej të pranishme.

Prania e bimësisë urbane përmirëson e redukton rrjedhjen sipërfaqësore të ujërave të reshjeve, që përbën një faktor të rëndësishëm ndotës për mjediset e gjelbra (GAIA, 2011). Paaftësia dhe pamjaftueshmëria e dheut për të kulluar ujin e reshjeve, dukuri që ndodh rëndom në Shkodër për shkak të klimës së lagësht veçanërisht në vjeshtë-dimër dhe mungesës dhe dëmtimit të kanaleve kulluese, çon në bllokimin e këtyre të fundit, si dhe përmytjen e sipërfaqeve

të gjelbra e rrugëve. Mekanizmat kryesorë përmes të cilëve fanerofitet e pranishme në ekosistemin urban të Shkodrës ndikojnë në përmirësimin e kësaj dukurie me natyrë fizike dhe antropogjenike janë:

Sipërfaqja e gjetheve, degët horizontale, degëzimet e kërcellit (sidomos e fletëgjerëve si *Populus sp.*, *A. altissima*, *A. hippocastanum*, *A. platanoides*, të gjithë drufrutorëve, *P. quenquifolia*, etj.), mbajnë një pjesë të ujit duke reduktuar vëllimin e reshjeve, duke vonuar e lehtësuar mbingarkimin e rrjetit të kullimit.

Shtimi i masës rrënjore dhe shkatërrimi e ripërtëritja e vazhdueshme e saj gjatë rritjes së fanerofiteve gjithandej në ekosistemin urban të Shkodrës (shpesh dalin edhe në sipërfaqe si tek *C. australis*), bën që terreni të jetë më poroz dhe për pasojë lehtëson filtrimin e ujit drejt thellësisë.

Lëvorja e trungjeve e kërcjeve redukton impaktin mekanik e dëmtues të shiut mbi sipërfaqen e dheut, duke kufizuar erozionin. Kjo dukuri duket qartë sidomos në lagjet pranë lumit Buna.

Transpirimi i realizuar nga masa e konsiderueshme gjethore, sidomos e gjetherënësve në pranverë e vjeshtë, rrit ndjeshëm kapacitetin akumulues të ujit nga fanerofitet, duke bërë që zonat e pakta të gjelbëruara në Shkodër të kenë dheun më të thatë, krahasuar me bregun e liqenit dhe të Bunës. Dukuria ka qenë tejet e evidente gjatë përmbytjeve të 2011-tës, kur pjesët e zhveshura nga bimësia drunore e shkurre në qytet kanë qenë më të dëmtuarat, si dhe kanë vuajtur më gjatë pasojat e përmbytjes. Cikli i qarkullimit të ujit në qytetin e Shkodrës, i rrethuar nga një rrjet hidrik i pasur, si dhe prania e Alpeve, afërsia e detit Adriatik, përshpejtohet nga prania e fanerofiteve. Nëse numri i llojeve dhe popullatave të këtyre bimëve në ekosistemin urban të Shkodrës, do të ishte shumë më i madh (sidomos në kurorën rrethuese), problemet e lagështirës së vazhdueshme që pengojnë qarkullimin e automjeteve e të këmbësorëve, si dhe dëmtojnë shëndetin e popullsisë (Shkodra njihet si një ndër qytetet shqiptare me numrin më të madh të pacientëve që vuajnë nga reumatizma), do të ishin dukshëm më të pakta (shih më poshtë). Fanerofitet gjithashtu qarkullojnë një masë të madhe uji, duke e pasur rizosferën më të pasur me ujë në krahasim me pjesët e qytetit të zhveshura nga bimësia sidomos në qendër.

Fanerofitet dekorative si pjesë e biodiversitetit dhe rrjeteve ekologjike

Çdo specie ndryshon nga të tjerat edhe për mënyrën se si aftësitë përshtatëse të saj përcaktojnë vendin që zë në ekosistem. Për këtë arsye shumë fanerofite të studiuara në këtë punim, paraqesin tolerancë të ndryshme ndaj stresit hidrik, termik dhe të rrezatimit, kërkesa të ndryshme për cilësinë e dheut ku rriten,

mbrohen në mënyra të ndryshme ndaj herbivorëve dhe përdorin strategji të ndryshme për polenizimin dhe shpërndarjen e farave. Këto ndryshime mund të kenë origjinë gjenetike, por edhe mund të zhvillohen në mënyra të ndryshme në përputhje me variacionin e parametrave të faktorëve ekologjikë abiotikë e biotikë. Korridoret e nënjësive të ekosistemit urban të qytetit, sigurojnë ndërlidhjen mes habitateve artificiale të krijuara nga njeriu në qytet, në sipërfaqe tejet të reduktuara në Shkodër dhe rrethinave. Këtë funksion e luajnë kopshtet private të lagjeve periferike e sidomos “Draçini”, “Qafa”, “Luguçesmja”, “Ajasma”, livadhet në lagjen “Kiras”, oborret e bahçet në “Bahçellek”, “Dobraç”, etj. Aty bimësia e kultivuar e fanerofiteve ndërthuret me bimë të egra duke siguruar: mbijetesën e biocenozës, funksionimin e zinxhirëve dhe rrjeteve ushqimore, reduktimin e nivelin e ndotjes dhe zhurmës së shkaktuar nga trafiku, eliminimi i papërshtatshëm i plehrave (djegia), etj.

Ndikimi në shëndetin psikofizik të popullatës së qytetit të Shkodrës

Drurët dhe zonat e gjelbëruara në përgjithësi kontribuojnë në përmirësimin e ekuilibrit të brendshëm psiko-fizik të njeriut.

Studime të shumta kanë vërtetuar që zhurmat natyrore të shkaktuara nëpër pemë nga era e shiu, bukuria dhe parfumet e luleve dhe tokës së mbjellë me bimë zbukuruese (*R. odorata*, *L. japonica*, *S. vulgaris*, *A. altissima*, *A. hippocastanum*, *A. julibrisin*, *C. japonica*, *M. grandiflora*, *C. grandiflora*, *Citrus sp.*, *R. officinalis*, *N. oleander*, *F. magellanica*, *Hibiscus*, *Hydrangea*, *J. officinale*, *C. siliquastrum*, *Ē. sinensis*, *T. platiphylos*, etj.), ndryshimi stinor i ngjyrës së bimësisë (pothuaj të gjitha bimët gjetherënëse, tab. 1) krijojnë ndjeshmëri pozitive që ndihmojnë në përmirësimin e mirëqenies psiko-fizike (Carminati & Ranghietti, 2006). Duhet veçuar prania e *C. Praecox*, e cila lulëzon në mes të dimrit (dhjetor-janar) dhe lulet e saj lëshojnë komponime aromatike të avullueshme tejet specifike. Kjo bimë që u gjend shumë rrallë vetëm në disa mjedise private (5 oborre familjare), duhet kultivuar edhe në mjedise publike Personat që rregullisht vëzhgojnë peizazhe urbane të dekoruara me bimë drunore dhe sipërfaqe të gjelbëruara paraqesin vlera më normale të presionit arterial dhe veprimtari cerebrale më pak të tensionuar krahasuar me të tjerë që zakonisht vëzhgojnë mjedise të privuara nga vegjetacioni. Studime të tjera tregojnë se fëmijët më së shumti rrinë brenda mureve të shtëpisë, sepse në afërsi mungojnë mjedise të gjelbëruara ku të luajnë dhe lagjet janë të mbingarkuara me trafik, zhvillojnë kapacitete motorike dhe ndërtojnë relacione sociale të një niveli shumë më të ulët se sa bashkëmoshatarët e tyre që kanë mundësinë të luajnë lirshëm përjashta (GUILTE et al, 2006). Ky është

rasti tipik i qytetit të Shkodrës ku mini-lulishtet e dikurshme të lagjeve janë zënë nga ndërtime kryesisht informale, gjelbërimi i shkollave e institucioneve është shkatërruar. Po ashtu edhe bimësia e pakët e dikurshme e pranishme në oborrin e ish-spitalit civil, sanatoriumit dhe azilit të pleqve është reduktuar në maksimum dhe pothuajse zhdukur. E njëjta dukuri ka ndodhur me parkun në hyrje të qytetit, lulishten e zhdukur tek poliklinika qendrore, lulishten pranë stadiumit, që janë kthyer tashmë në hapësira *gri*, etj.

Fakti që në ekosistemin urban të qytetit të Shkodrës kemi evidentuar 58 fanerofite gjithmonë të gjelbra, përbën një faktor psikosocial pozitiv të rëndësishëm. Kjo do të thotë se qyteti në stinën e vjeshtë-dimrit nuk është i zhveshur (edhe pse sipërfaqet e gjelbra dhe numri i ekzemplarëve krahasuar me numrin e popullsisë janë të reduktuara, shumë larg plotësimit të standardeve ndërkombëtare). Kjo është arsyeja pse bimë gjithmonë të gjelbra, si: *E. globulus*, *H. syriacus*, *Citrus sp.*, *Ligustrum sp.*, *C. citrinus*, *R. ferugineum* (një pjesë e të cilave edhe lulëzojnë shumë bukur e për një kohë relativisht të gjatë), duhen ruajtur dhe kultivuar në masë.

Në këtë punim janë konsideruar si bimë ornamentale edhe disa dru-frutorë, sepse vlera e tyre nuk qëndron vetëm në prodhimin e frutave bio, përgatitjen e shurapeve (maragjyli, thana, vishnja), reçelrave e kompostove. Në lagjet e qytetarëve (kryesisht në ato periferike), ka një tendencë të rritjes së ambicies për të mbjellë në oborret e kopshtet e tyre private shumëllojshmëri dru-frutorësh. Ripërtëritjen e disa varieteteve pothuajse të zhdukura (fiku bajun, rushi rrazagi dhe ai i Rrojit, dardha rrakatele, kumbulla gabele, mushmolla e verës, etj.), si dhe futjen në masë të llojeve dhe të varieteteve të reja, të cilat nuk kanë qenë traditë e Shkodrës (me përjashtim të limonit që rezulton se mbillet në Shkodër, si pjesë e gjelbërimit arredues prej mëse 150 vitesh), siç është kivi, lajthia, agrumet, etj. Këtu duhet shtuar edhe kultivimi i larit dhe rozmarinës, që përdoren për qëllime kulinare. Kjo sigurisht shton spektrin florik të ekosistemit urban, numrin e ekzemplarëve të këtyre specieve, rritjen e sipërfaqes së dheut të mbjellë me bimë dhe shtimin e biomasës së tyre, gjë që drejtpërdrejt përmirësojnë cilësinë e mikromjedisit.

Shumë bimë drunore e shkurre (përfshi edhe drufrutorët e lartpërmendur) shërbejnë për të vendosur kufirin ndarës mes familjeve, siç është rasti i *L. nobilis* (lari) që në kohë të hershme përcaktonte fundin e kopshtit të një familjeje dhe fillimin e kopshtit të komshinjve. Gjithashtu shumë bimë formojnë edhe perde e tenda natyrale, për të evituar shikueshmërinë nga fqinjët (fiqtë, manat, tendat me urth, partenocis, jasemin, lulevile, ligustra, selvi, etj.).

Disa prej bimëve të përfshira në këtë punim kanë edhe efekte terapeutike dhe kultivohen edhe për këtë qëllim nga qytetarët shkodranë: çaji i gjetheve të

larit dhe lules së blirit për infeksionet e traktit të frymëmarrjes, çaji i bishtave të fryteve të qershisë për tretjen e gurëve në veshka, frytet e thata të fikut dhe kumbullës kundër kapsllëkut, çaji i gjetheve të rozmarinës kundër dhimbjes muskulore dhe rënies së flokëve (GODA et al., 1972; DEMIRI, 1979; NISHANI, 2004)).

Drurët e shkurret dekorative janë gjithashtu edhe pjesë e historisë së qytetit, siç është rasti i *P. orientalis* ose çinarit. Kemi evidentuar 5 ekzemplarë në Shkodër, mosha e të cilëve sipas të dhënave (duke i lidhur me ngjarje historike) varion përafërsisht nga 75-150 vjet. Çinari i Hoxhë Dheut në ditët e sotme një qendër të hapur tregtare, një nyje ndërlidhëse të qarkullimit në qytet, arrin një lartësi. Pema më e lartë (përafërsisht 25 m) e me biomasën më të madhe në qytet ka moshë rreth 75 vjeçare. Është monument natyre, por realisht nuk mbrohet nga shteti. Çinari i Tophanës konsiderohet shumë i vjetër dhe kjo lidhet me faktin se pranë tij grumbulloheshin vullnetarët që do të merrnin pjesë në luftën kundër sulmit malazez ndaj Shkodrës në shekullin e 18-të (BUSHATI, 1999). Është një bimë e dëmtuar, pasi është djegur dy herë dhe sot mbijeton falë një sipërmarrjeje private. Çinari i Veksharit ka marrë emrin e lagjes sikurse ai i Tophanës. Ka opinione që e konsiderojnë si bima më e vjetër në qytet, nisur nga fakti se Vekshari është ndër lagjet më të vjetra të qytetit, pas fillimit të zbritjes së popullsisë nga shpatet e kodrës së kalasë së Rozafës drejt fushës poshtë saj. Shpesh ndodh që themelimi i lagjeve të materializohet historikisht me bimë të tilla jetëgjata, si *P. orientalis*. Ka shumë mundësi që kjo traditë të jetë mbartur nga kultura osmane. Dy ekzemplarët e tjerë janë të vendosur në varrezat katolike. Sipas studiuesit Willy Kamsi, këto bimë janë mëse 100 vjeçare, mbasi pranë tyre vendosen varret më të vjetra që datojnë në 1890-tën, duke u lidhur edhe me ndërtimin e kishës së varreve katolike dhe vetë këtyre varrezave. Kemi vërejtur se njëri prej çinarëve është pjesërisht i dëmtuar për shkak të moshës dhe mungesës së mirëmbajtjes, duke u bërë shkak edhe për dëmtimin aktual të varreve si pasojë e rrëzimit të degëve anësore.

Planifikimi bioestetik duhet bërë mbi bazë llojesh që i rezistojnë kushte mjedisore të zonës, sepse përveç vlerës së tyre ekologjike, bukurisë estetike dhe futjes në mënyrë të drejtpërdrejtë në përdorim, këto bimë reduktojnë koston e mirëmbajtjes, pasi që janë të miraklimatizuara, ruajnë biodiversitetin dhe parandalojnë zhdukjen e llojeve (SICURELLA, 2003; GAIA, 2011). Shumica e bimëve drunore e shkurreve që evidentohen në ekosistemin urban të Shkodrës janë neofite, duke u konsideruar njëkohësisht edhe si aliene. Bimë aliene ose jovendase quhen bimët që janë futur nga njeriu në mënyrë të qëllimshme ose rastësore në një zonë në të cilën ato natyrshëm nuk duhet të ndodheshin. Një pjesë e llojeve aliene shndërrohen në invazive, të cilat

renditen të dytat në listën e shkaqeve të humbjes së biodiversitetit në rang global. Ato shpesh kanë shkaktuar dëmtim të ekologjisë së habitateve e deri edhe zhdukje të specieve autoktone, pasi kanë aftësi të aklimatizohen shpejt, rriten në hapësirë e në kohë në intervale relativisht të shkurtra, iu rezistojnë streseve mjedisore dhe përballojnë sulmet e patogjenëve (Web 7). Bimë, si: *A. altissima*, *P. quinquefolia*, *R. pseudoacacia*, *P. alba*, *C. humilis*, *P. canariensis*, etj., konsiderohen si specie aliene invazive (EPPO, 2013) dhe duke qenë pjesë e florës së Shqipërisë (BARINA et al. 2014) përhapja e tyre në mjediset e gjelbra në qytetin e Shkodrës duhet bërë e kontrolluar në mënyrë që ato të mosdëmtojnë përhapjen e bimëve autoktone, të mosdëmtojnë rrugët dhe mjediset ku janë vendosur, si dhe të mos bëhen shkak për alergji ndaj popullatës. Në të gjitha mjediset publike kemi konstatuar edhe praninë e bimëve, sidomos drunore të thara ose të dëmtuara nga shkaqe natyrore ose edhe antropogjenike: prerja pa kriter, kafshimi nga bagëtitë, depozitimi i mbetjeve të ngurta, derdhja e karburanteve, etj. Në hapësirat e gjelbra publike e private në Shkodër kemi evidentuar praninë e bimëve të tilla, si: *O. europea*, *Betula sp.*, *Populus sp.*, *Pinus sp.*, *Cupressus sp.*, *C. avellana* polenet e të cilave janë alergjike, sikurse edhe bimë të tilla si *N. oleander* dhe *T. Bacat*, që emetojnë komponime aromatike helmuese sidomos në periudhën e polenizimit. (GUTE et al. 2006). Duke pasur parasysh se atmosfera e qytetit është e mbingarkuar me pluhur dhe gaze të dëmshme për shëndetin, shtimi i këtyre substancave dhe poleneve alergjike rëndon situatën e rrit nivelin e ndotjes, prandaj administrata publike nuk duhet të imponojë mbjelljen e këtyre bimëve në sasi të konsiderueshme pranë ndërtesave të banimit dhe në lulishtet publike (*Cupressus*) ose ullirit e të mos marrë parasysh vetëm udhëzimet e arkitektëve e urbanistëve, por t'i kombinojë ato me studime ekofiziologjike dhe në bashkëveprim të ngushtë me specialistët e legjislacionit mjedisor dhe ata të shërbimit parësor shëndetësor.

Fanerofitet kanë edhe funksion shumë të rëndësishëm didaktik, sepse në ditët e sotme të rinjtë e veçanërisht fëmijët kontaktojnë shumë pak me natyrën. Për këtë arsye drurët e shkurret në qytet janë ndër të vetmet e të paktat bimë që mund të vëzhgojnë, prekin e njohin (SETH, 2004; CARMINATI & RANGHETTI, 2006). Mësuesit e disa shkollave e kopshteve në fakt i sjellin fëmijët pranë lulishtes tek shatërvani në qendër të qytetit, lulishtja “Luigj Gurakuqi” ose tek sheshi “Isa Buletini”, në mënyrë që të eksplorojnë gjelbërimin publik, duke i njohur me variacionin stinor të bimësisë, diversitetin e specieve të kultivuara, duke u përpjekur t’i ndërgjegjësojnë për rëndësinë që ka prania dhe mbrojtja e bimësisë dhe e mjedisit në përgjithësi. Edukimi mjedisor është pjesë e pandarë e procesit të mësimdhënies së çdo mësuesi e në veçanti e mësuesve të biologjisë

e kimisë në çdo hallkë të arsimit në qytetin tonë.

Kultura e topiarisë (BGH, 2010) nuk është e re në Shkodër. Familjet e vjetra në Shkodër i kanë krasitur vazhdimisht në oborret e tyre bimë të tilla si shemshiri ose bushi (*B. sempervirens*) për të nxitur rritjen e degëve anësore por edhe për t'u dhënë forma interesante duke shtuar efektin e tyre ornamental. Sot kjo dukuri e kulturë është e përhapur në të paktat lulishte që ka në Shkodër, po sidomos në njësitë private të shërbimit dhe nëpër oborre private. Përveç *B. sempervirens*, *Cupressus sp.*, *T. bacata*, *T. orientalis* dhe *A. Alba*, janë bimët që përdoren më shumë për këtë qëllim në ekosistemin urban të Shkodrës. Bimë si *F. Llastica*, zakonisht përdoren në mjedise të brendshme, sepse nuk përballojnë variacionet e faktorëve mjedisore të natyrës fiziko-kimike (MECHOY, 1998). E kemi konstatuar të përdorur për *dekoracion* në shumë mjedise të brendshme private e publike (kryesisht familje, njësi shërbimi, shkolla, spitale, etj.)

Përfundime

- VASIC, V., VIZI, O., SAVELJIC, D., VESOVIC, N. & BARJAKTAREV, D. 2006: Lake Shkodër waterfowl census, 1995 – 2005 (no counts in 2001 – 2003). In: GROUP AUTHORS. 2006: Lake Shkodër Transboundary Diagnostics Analysis. Final Raport. Royal Haskoning. World Bank (IBRD). 166 pp.

Dinamika sezonale e specieve të kërcënuara të shpendëve në Malin e Dajtit

Gjergji Peja, Ferdinand Bego

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës,
Departamenti i Biologjisë

PËRMBLEDHJE

Ornitofauna e malit të Dajtit përmban 30 specie të kërcënuara ose 24.6 % të saj, të klasifikuara sipas kategorive të IUCN-së. Realizimi i dinamikës sezonale të specieve të kërcënuara të shpendëve, përfaqëson një nga analizat më të plota, mbasi këto specie analizohen si në aspektin cilësor, ashtu dhe sasior. Analiza sasiore bazohet mbi të dhënat sasiore të grumbulluara në terren gjatë viteve 2012 dhe 2013; ajo shprehet me anë të frekuencës së species. Nga analiza rezulton se muajt prill dhe gusht, të të dy viteve, paraqesin frekuencën më të lartë dhe numrin më të madh të specieve. Viti 2012, muaji prill (Fr. 26 %, Nr. spec. 21) dhe muaji gusht (Fr. 23 %, Nr. spec. 18); viti 2013, muaji prill (Fr. 24.13 %, Nr. spec. 24) dhe muaji gusht (Fr. 23 %, Nr. spec. 18). Është vlerësuar gjithashtu edhe frekuenca e përgjithshme e secilës specie, duke bërë të mundur evidentimin e rolit që luan secila specie në funksionimin e ekosistemit. Kombinimi i Frekuencës së përgjithshme me Konstanten e përgjithshme të species, kanë lejuar që të përcaktohen speciet "bazë" të popullimit, brenda specieve të kërcënuara, p.sh., *Dendrocopos syriacus*, *Coccothraustes coccothraustes*, *Buteo buteo*, etj. Dinamika sezonale e specieve të kërcënuara është trajtuar edhe në lidhje me kategoritë fenotipike të specieve.

FJALËT KYÇE: Popullim, specie të kërcënuara, frekuencë, konstante, dinamikë.

Seasonal dynamics of threatened bird species at Dajti Mountain

ABSTRACT

30 species equivalent to 24.6% of Dajti Mountain Ornitofauna are classified as

threatened according to IUCN criteria. The seasonal dynamics of threatened bird species at Dajti Mountain represents one of the most complete analyses as these species are analyzed both quantitatively and qualitatively. The quantitative analysis is based on field data gathered during the years 2012 and 2013 and it is expressed as the relative frequency of species. The highest bird species frequency was found in April and August of both years. In April 2012 there were 21 threatened bird species (26%), while in August 2012 there were 18 threatened bird species (23%). In April 2013 we counted 24 threatened bird species (24.13%), while in August 2013 we counted 18 (23%). The role of each species in the ecosystem was assessed through the calculation of the relative frequency and the frequency of occurrence for each species. The correlation between the relative frequency and the frequency of occurrence helped to identify the “basic” species of the threatened bird species community in Dajti Mountain, such as *Dendrocopos syriacus*, *Coccothraustes coccothraustes*, *Buteo buteo*, etc. The seasonal dynamics of threatened species is discussed also in correlation with the phenotypic categories of species.

KEY WORDS: Population dynamics, threatened species, relative frequency, frequency of occurrence.

Hyrje

Në malin e Dajtit janë konstatuar 122 specie shpendësh (PEJA & BEGO 2013a), nga të cilat 30 specie janë të kërcënuara, bazuar në kriteret e IUCN-së. Speciet e kërcënuara përbëjnë 24.6 % të të gjitha specieve që janë konstatuar në këtë mal (PEJA & BEGO 2013b).

Realizimi i dinamikës sezonale të një popullimi përfaqëson një nga analizat më të plota, në krahasim me analizat e tjera, mbasi ajo vë në dukje situatën reale të popullatave që përbëjnë popullimin në fjalë (PEJA, GJ. & PEJA, N. 2013c). Realizimi i dinamikës sezonale të popullatave të shpendëve, bazohet në një analizë cilësore (DHORA 2011) dhe sasiore të popullatave, që përbëjnë popullimin. Vlerësimi i numrit absolut i individëve të shpendëve tokësorë, është jashtëzakonisht i vështirë, për të mos thënë i pamundur. Prandaj, kalkullohet frekuenca e secilës specie, e cila pasqyron një vlerë sasiore, në raport me speciet e tjera të popullimit. Me interes është edhe kalkulimi i konstantes së përgjithshme të secilës specie, e cila vlerëson praninë e species në ekosistemin ku jeton popullimi. Në rastin e dinamikës sezonale duhet studiuar dhe përcaktuar edhe përhapja fenologjike (kohore) e secilës specie, sipas kategorive: i përhershëm (P), veronjës (V), dimëruës (D) dhe migrator (M).

Materiali dhe metodat

Zona e studimit përfaqësohet nga mali i Dajtit, i cili ka lartësinë maksimale 1620 m. Ai është i mbuluar, pothuajse, krejtësisht nga 3 breza fito-klimatikë: brezi i shkurretave, brezi i dushqeve dhe brezi i ahut, duke filluar nga niveli i poshtëm i malit, drejt lartësisë maksimale (KALAJXHIU 2006). Popullimi i shpendëve në malin e Dajtit është i përhapur në të tri brezat fito-klimatik.

Metoda e përdorur për të grumbulluar të dhënat cilësore dhe sasiore të specieve të kërcënuara, janë po ato që u përdorën për të përcaktuar strukturën e popullimit të shpendëve, në malin e Dajtit (PEJA & BEGO 2013b), pra edhe për studimin e dinamikës sezonale, transektet e përshkuara nga ne, janë realizuar një herë në dy muaj, duke filluar nga muaji shkurt 2012 - dhjetor 2012 dhe shkurt 2013 – dhjetor 2013. Në përfundim të një itinerari nxirret numri mesatar i kontakteve (individëve) për secilën specie të konstatuar, si dhe numri mesatar i përgjithshëm i të gjithë individëve, të të gjitha specieve të konstatuara gjatë itinerarit. Mbi këto të dhëna është kalkuluar frekuenca e secilës specie, për muajt që janë kryer ekspeditat; frekuenca e secilit muaj, si dhe frekuenca e përgjithshme e secilës specie. Është kalkuluar gjithashtu edhe konstantja e secilës specie, e cila shprehet me raportin e numrit të kampioneve ku është gjetur specia, mbi numrin e përgjithshëm të kampioneve, shprehur në përqindje (%). Ky indeks vlerëson se sa e pranishme është specia në atë ekosistem, gjatë gjithë vitit, në raport me speciet e tjera.

Rezultatet dhe diskutimi

Të dhënat sasiore dhe cilësore të popullatës, janë paraqitur me anë të tabelave, histogrameve dhe grafikëve. Tabelat 1/1 dhe 1/2 paraqesin të dhëna sasiore të specieve të kërcënuara të shpendëve, në malin e Dajtit. Konstatohet se në të dy periudhat (2012 dhe 2013) që janë kryer ekspeditat, numri i specieve të kërcënuara, të cilat janë konstatuar është i njëjtë; 30 specie për secilën periudhë. Por, konstatohet se numri i individëve të këtyre specieve është i ndryshëm. Në periudhën e vitit 2012 janë konstatuar 201 individë, ndërsa në periudhën e vitit 2013 numri i individëve është 257. Në këto tabela paraqitet frekuenca e secilës specie, në muajt që janë realizuar ekspeditat. Në muajin shkurt, 2012 janë konstatuar 7 specie, të përfaqësuara me 17 individë; pra, frekuenca e muajit shkurt, 2012 rezulton 8.5 %. Në muajin prill janë konstatuar 21 specie të përfaqësuara me 52 individë; pra, frekuenca e muajit prill, 2012 ka rezultuar 26 %, etj., tabela 1/1.

Po këto të dhëna janë kalkuluar edhe për të njëjtët muaj të vitit 2013, gjatë të cilit kanë rezultuar gjithsej 257 individë, tabela 1/2. Kështu, gjatë kësaj

periudhe, në muajin shkurt, 2013 janë konstatuar 11 specie me 29 individë; pra, frekuenca e muajit shkurt, 2013 rezulton 11.28 %. Në muajin prill, 2013 janë konstatuar 24 specie me 62 individë; pra, frekuenca e këtij muaji rezulton 24.13 %, etj., tabela 1/2.

Krahasimi i frekuencave, ndërmjet muajve të vitit 2012, vë në dukje se muaji me frekuencë më të lartë është muaji prill, me 21 specie, me 52 individë dhe frekuencë 26 %. Po kështu, muaji prill 2013, rezulton me 24 specie, 62 individë dhe me frekuencë mujore 24.13 %, tabela 2. Kjo tabelë vë në dukje se edhe muajt gusht, të të dy viteve, rezultojnë me frekuencë më të lartë se muajt e tjerë, përjashtuar muajt prill.

Tabela 2. Frekuenca e muajve dhe numri i specieve respektive.

MUAJI \ VITI	2012		2013	
	Frekuenca	Nr. specieve	Frekuenca	Nr. specieve
SHKURT	8.5 %	7	11.28 %	11
PRILL *	26.0 %	21	24.13 %	24
QERSHOR	17.5%	15	17.50 %	18
GUSHT *	23.0 %	18	23.35 %	21
TETOR	20.0 %	18	18.29 %	21
DHJETOR	5.0 %	5	5.45 %	11

Kështu, muaji gusht, 2012, paraqet 18 specie dhe frekuencën 23 %; ndërsa në muajin gusht, 2013 janë numëruar 21 specie dhe frekuenca rezulton 23.35 %. Pra, janë muajt prill dhe gusht ata që paraqesin numrin më të madh të specieve, por edhe të individëve (frekuenca), (PEJA & SMAJLAJ 2004).

Vlerat më të larta të të dy muajve, prill dhe gusht, argumentohen për faktin se në muajin prill, krahas specieve të përhershme, fillojnë të vijnë në malin e Dajtit edhe speciet veronjëse, duke kontribuar në rritjen e numrit të specieve dhe njëkohësisht, edhe të numrit të individëve. Në muajin gusht, speciet e shpendëve kanë përfunduar sezonin e riprodhimit; është edhe ky fakt i cili kontribuon në rritjen e numrit të individëve të specieve (ODUM 1988, PEJA 2007). Pra, janë këto dy muaj që paraqesin numrin më të madh të specieve dhe të individëve.




Fig. 1. Frekuenca e muajve të vitit 2012 dhe 2013.

Dinamika sezonale paraqet një lidhje të ngushtë me kategoritë fenologjike të specieve dhe sezoneve të vitit. Tek speciet e kërcënuara (KONVENTA BERNES 1979) të shpendëve në malin e Dajtit, kemi dalluar tri kategori fenologjike: shpend të përhershëm (P), shpend veronjës (V) dhe shpend migrator (M) (HUM 2009). Shpendët veronjës dimërojnë në jug të një zone të caktuar, por kthehen në këtë zonë për të folëzuar, pra për t'u riprodhuar. Është normale që speciet veronjës i kemi konstatuar, kryesisht, nga muaji prill deri në muajin tetor. Kështu, specien *Upupa epops* (pupëza) (V) e kemi kontaktuar, gjatë vitit 2012, në muajt: prill (Fr. 1.92 %), qershor (Fr. 11.42 %), gusht (Fr. 16.38 %), e cila paraqet një frekuencë të përgjithshme me 4.0%.

Numrin më të madh të specieve të kërcënuara në malin e Dajtit e përbëjnë shpendët e përhershëm (P) me 21 specie ose 70 %, shpendët veronjës kanë 8 specie ose 26.7 % dhe shpend migrator 1 specie ose 0.3 %. Muajt dhjetor paraqesin numrin më të vogël të specieve; 10 specie në vitin 2012 dhe 14 specie në vitin 2013. Ky fakt mund të shpjegohet me largimin e shpendëve veronjës dhe migrator, por edhe nga dukuria e dispersionit, e cila përfaqëson “zbritjen” e disa specieve nga lartësitë më të mëdha drejt ultësirave.

Një karakteristikë sinjifikative e një specie është edhe frekuenca e përgjithshme e species (Fr. përgjith.), e cila është paraqitur në tabelat 1/1 dhe 1/2. Ky tregues vë në dukje numrin total të individëve të një specie që kemi konstatuar në zonën e studimit, gjatë muajve që janë realizuar ekspeditat, në raport me numrin total të individëve të të gjitha specieve të kërcënuara, të konstatuara. Megjithëse, vlera e frekuencës së përgjithshme ka karakter relativ, ajo pasqyron rolin që luan një specie, në raport me speciet e tjera (me anë të individëve të saj), në

funksionimin e atij ekosistemi ku specia bën pjesë. Në tabelat e mësipërme kemi paraqitur edhe vlerën e konstantes së përgjithshme (Ko. përgjith.) për secilën specie, tabelat 1/1 dhe 1/2.





Figura 2. Vlerat (në %) të konstantës së përgjithshme (Ko. përgjith.) dhe frekuencës së përgjithshme, (Fr. përgjith.) gjatë viteve 2012 dhe 2013. Në boshtin e absisave janë vendosur numrat korrespondues të specieve të tabelës 1/1 ose 1/2.

Konstatohet që disa specie paraqesin vlera të larta si për frekuencën e përgjithshme, ashtu dhe për konstanten e përgjithshme. Këto specie konsiderohen “speciet bazë” në raport me speciet e tjera, Figura 2. Pra, speciet “bazë” paraqesin në total një numër më të madh individësh (Fr. e përgj.) si dhe praninë e tyre për një kohë më të gjatë (Ko. përgj.), në ekosistem. Nga speciet e kërcënuara veçojmë speciet: (19) *Dendrocopos syriacus* (Qukapiku i zakonshëm larosh) për vitin 2012 (Fr. 6.50 %, Ko. 83.3%); për vitin 2013 (Fr. 5.83 %, Ko. 100%); specien (30) *Coccothraustes coccothraustes* (Sqeptrash), për vitin 2012 (Fr. 8.0 %, Ko. 66.6 %), për vitin 2013 (Fr. 6.62 %, Ko. 83.3 %), specien (4) *Buteo buteo* (Huta) për vitin 2012 (Fr. 5.50 %, Ko. përgjith. 66.6 %), për vitin 2013 (Fr. 5.05 %, Ko. përgjith. 83.3 %). Duhet patur parasysh se vlerat e frekuencës dhe të konstantës kanë karakter relativ për faktin se edhe kontaktet me speciet dhe numri i këtyre kontakteve (individët) gjatë ekspeditave, ka karakter relativ. Relativiteti i konstantës së përgjithshme (Ko. përgjith.), përforcohet akoma më tepër, kur kemi të bëjmë me specie të përhershme (P) dhe vlerat e Ko. përgjith. rezultojnë më pak se 100 %. Si shembull sjellim specien e përhershme (24) *Prunella collaris* (Dredhuesi i alpeve) për vitin 2012 (Fr. përgjith. 11.5 %, Ko. përgjith. 50 %), për vitin 2013 (Fr. përgjith. 11.29 %, Ko. përgjith. 50 %). Një mangësi e tillë vërehet, në përgjithësi, tek kafshët që karakterizohen nga zhvendosje të përkohshme jo të mëdha, nga habitati i tyre.

Përfundime

Realizimi i dinamikës sezonale të shpendëve të kërcënuara, në malin e Dajtit, pasqyron mjaft mirë situatën e popullatave të këtyre specieve duke i vlerësuar ato si në aspektin cilësor (nr. e specieve) dhe në aspektin sasior (nr. i individëve për secilën specie).

Konkludohet se muajt prill dhe gusht paraqesin vlerat më të larta të numrit të specieve, si dhe të numrit të individëve, të pranishëm në këto muaj.

Kalkulimi i frekuencës së përgjithshme të secilës specie vë në dukje numrin relativ të individëve të takuar gjatë ekspeditave të kryera. Pra, kjo frekuencë paraqet edhe aspektin sasior të species në krahasim me speciet e tjera.

Kalkulimi i konstantes së përgjithshme të secilës specie, pasqyron praninë e species gjatë një periudhe të caktuar, duke bërë të mundur që specia të vlerësohet edhe në aspektin fenologjik (kohor).

Kombinimi i frekuencës së përgjithshme me konstanten e përgjithshme të species, vë në dukje rolin që luan specia në ekosistem. Speciet që paraqesin vlera të larta, për të dy karakteristikat, konsiderohen si specie “bazë” të popullimit.

Referencat

- DHORA, DH. 2011: Mbi diversitetin e specieve të faunës së Shqipërisë. Buletin Shkencor i Ush-së “Luigj Gurakuqi”, 61, Seria e Shkencave të Natyrës, fq. 61-75.
- HUM, R. 2009: Complete Birds of Britain and Europe. RSPB. Dorling Kindersley.
- KALAJXHIU, A. 2006: Vlerësimi i biodiversitetit floristik dhe fitosociologjik të Parkut Kombëtar (të propozuar) të Dajtit. (Disertacion). Rep. Shqip. Universiteti Bujqësor. Fakulteti Bujqësisë. Dep. Prodhimi bimor. Seksioni Botanikë.
- KONVENTA BERNES 1979: Annex II list (Birds) of the Berne International Convent. Berne.
- ODUM, E. P. 1988: Basi di ecologia. Piccin, Padova, Italia.
- PEJA, N. 2007: Ekologjia. P.S.H. 2 015, Tirana, Albania.
- PEJA, N. & SMAJLAJ, RR. 2004: Ornitofauna pyjore e Malësisë së Madhe. Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” Bul. Shk. Sec. Shk. Nat. Nr. 54 : 125-132.
- PEJA GJ. & BEGO, F. 2013a: Të dhëna paraprake mbi ornitofaunën e Malit të Dajtit. Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Bul. Shk. Sec. Shk. Nat. Nr. 63 : 174-183.
- PEJA, GJ. & BEGO, F. 2013b: Population Structure of Ornitofauna in the Dajti Mountain, Albania. 3-rd International Conference of Ecosystems. May 2013, Tirana, Albania.
- PEJA, GJ. & PEJA, N. 2013c: Influence of the ecological niche in bird species differentiation and coexistence at Dajti Mountain. 2nd International Conference Research and Education in Natural Sciences. November 15-16, Shkodër – Albania. Proceedings volume 1.

Comparative considerations on the response of some wheat varieties on late planting

Orjeta Jaupaj

Politechnic University of Tirana,
Institute of Geosciences, Energy, Water & Environment

ABSTRACT

Among many challenges agriculture faces nowadays, the main one remains the issue of agricultural plants' adaption with the expected trends of climate change.

As predicted by the climate models, this phenomenon is expected to increase the frequency and magnitude of extreme climatic events. That implies that more intense and prolonged rainy as well as dry periods are likely to strike the globe. Additionally, Albania is projected to be one of the most affected countries by this phenomenon, as compared to other countries of Europe and Central Asia.

This paper evaluates three wheat varieties and their reaction against late planting. Some of the physiological and morphological features are selected to be analyzed in crops which were sown in two different periods, i.e., November and January. The pigment concentration in flag leaves and their surface area as well as the kernels weight and their number per spike are estimated per each crop. The two first features have been analyzed in the end of the anthesis stage and the two second ones in the end of vegetative period.

Based on the given results, conclusions are drawn regarding the features which ought to be improved in the following research aiming at adapting the crops to the changing climatic conditions.

KEY WORDS: wheat, heavy rainfall, climate change, photosynthetic pigments, yield

Konsiderata krahasuese mbi reagimin
e disa varieteteve të grurit ndaj mbjelljes së vonë

PËRMBLEDHJE

Ngritja e sistemeve të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike është një çështje që preokupon mbarë botën në ditët e sotme. Ndër problemet më serioze në lidhje me këtë çështje është sigurimi i bazës ushqimore për popullsinë. Në kuadër të këtyre ndryshimeve, Shqipëria pritet të përballlet gjithnjë e më shumë me situata ekstreme klimatike, të shkaktuara nga reshje të forta dhe intensive kryesisht gjatë muajve të vjeshtës. Si pasojë, ngjarje të tilla mund të kërcënojnë herë pas here procesin e mbjelljes së kulturës së grurit në pjesën perëndimore të territorit shqiptar, e cila është e prirur të përmytet në rastet kur ndodhin ngjarje të tilla.

Ky studim ka për qëllim vlerësimin e qëndrueshmërisë së tri varieteteve të grurit, LB7, DXM dhe STF4 ndaj mbjelljes së vonuar. Për këtë qëllim, 1000 bimë të çdo varieteti janë mbjellë në dy periudha të ndryshme, të konceptuara si kohë normale dhe kohë e vonuar për mbjellje. Në fazën e kallëzimit, në bimët e secilës ngastër, është analizuar sipërfaqja e gjetheve flamur dhe përqendrimi i pigmenteve fotosintetike në to. Nga ana tjetër, në fund të periudhës vegetative është vlerësuar numri i kokrrave për kalli dhe pesha e tyre.

Bazuar në rezultatet e dhëna, janë ngritur rekomandime në lidhje me varietetet e sugjeruara për mbjellje në rast se ajo nuk është e mundur të realizohet në kohë normale. Për më tepër, janë dhënë konsiderata në lidhje me karakteristikat e nevojshme për t'u përmirësuar në kërkimet e mëvonshme me qëllim përshtatjen sa më të mirë të kulturës ndaj kësaj situatë.

Introduction

The adaption of the agricultural plants with the climatic and pedological conditions of different regions is an issue that has drawn the genetic improvers' attention for decades. Nevertheless, this issue remains strongly linked with the present day concerns such as provision of food security and sustainable exploitation of natural resources. However nowadays, due to the prediction of the most up-to-date global climate models regarding a increasing trend in the frequency and magnitude of extreme climatic events all over the globe (WB 2009), the adaption of these plants with the expected trend of these predicted changes poses one of the greatest challenges of all genetic improvement programs.

This adaption is even more essential in Albania, which, as compared to other

countries of Europe and Central Asia, is projected to be more affected by this phenomenon, the second after Russia (WB 2009) and as such, it is more likely to be greatly threatened by such extreme events.

As a matter of fact, wheat is an important agricultural plant greatly linked with a state's economy and security (MIKE & DAVIES 1997). Due to its high energetic content, it is extensively utilized in the food industry, and other light industries. Moreover, nowadays its usage as a biofuel is being promoted as well, as a means to reduce the usage of the fossil fuels for energy purposes (MIKE & DAVIES 1997) and as a consequence to trap the emission of greenhouse gases in the atmosphere.

The planting of this culture (winter varieties) actually, is being threatened by the rainfall intensity and duration, notably occurring in the autumn period due to the new climatic features of this country (JAUPAJ et al. 2013). As such, the successful adaption to the new climate conditions so that the planting, growth and the yield of this culture won't be affected, remains a great challenge.

This paper evaluates three wheat varieties and their reaction against late planting. Two varieties of bread wheat (LB7 and DxM) and one of durum wheat (STF4) are planted in two different time periods consisting of normal and delayed planting where the first period is designated in mid November and the second in the beginning of January. The physiological as well as morphological performance of the flag leaf, in the end of anthesis stage, is evaluated in both groups of plants. Besides, their yield performance in the end of vegetative period, is estimated as well. Our main goal has been to perform a general assessment of the negative effects of the late planting in each variety thus understanding the negative effects of the late planting in each variety and drawing recommendations on two main issues. The first one consists of the crucial features required to be improved in order to adapt these varieties with the incoming features of climate; whereas the second one consists of selecting the most robust variety toward the late planting as the Albanian territory faces constant inundations and farmers ought to know which variety could be more endurable. This experiment is carried out in Valias which is situated in the Middle-Western part of Albania 20 km far from Tirana. It is also worth emphasizing that the experiment was launched in autumn 2010 when Albania was struck by an extreme rainy season when vast arable lands were inundated and when the planting of wheat was not possible to be completed till the first days of January in almost all the western part of the country. Alongside this experiment, the same varieties were planted in the beginning of December in Lushnja which is situated in the south-western part of the country. As a matter of fact, Lushnja is considered to offer similar climatic conditions with Tirana

region (IHM 1982; Laska, 2009) but it has a high drained soil which enabled an earlier planting. The results of Lushnja experiment are shown in this paper just for comparison purposes as the recommendations are drawn from the results of Valias experimentation plots.

Material and methods

Two varieties of bread wheat (LB7 and DxM) and one of durum wheat (STF4) are planted in two different time periods consisting of normal and delayed planting where the first period is designated in mid November and the second in the beginning of January. The planting was based on a complete randomized block design consisting of similar agronomic works in the three plots.

In the beginning of anthesis stages, several flag leaves were collected randomly in each plot, and were then analysed for their photosynthetic pigment concentration utilizing the destructive spectrophotometric approach (LICHTENTHALER 1987). The collected leaves were extracted with 85% acetone [ACADEMIC PRESS 1976, KRAJA et al 2000] and measured for the optic densities by means of a spectrophotometer type 4802H UV/VIS Double Beam, in E663nm, E644nm and E452.5nm wave lengths. The calculation of the photosynthetic pigment content was based on the equations of Rebelen (HUNT 1982, SHEHU 2004, LICHTENTHALER 1987). The collected leaves were analysed for their surface area as well, multiplying their length and width with the cereal coefficient [axbx0.75] (STAMO 1995). Finally, the kernels weight and their number per spike were estimated in the end of vegetative period analyzing several plants per each crop.

The results retrieved from the later sown plants were compared with the results retrieved from the normal time sown plants. At the same time, for comparison purposes, have been shown in this paper the results revealed by the crops planted in the first days of December in Lushnja region, which is considered to have the same climatic features with Tirana region (LASKA 2009).

The results were subjected to two statistical tests, LSD post Hoc ANOVAs and the student test, in order to assess their statistical confirmation. The tests were performed using SPSS 17 software.

Results and discussion

Figures 1, 2 and 3 show an overview of the results revealed in the three targeted varieties as regarding the physiological and kernel formation of late planting, as compared to normal time crop planting. As shown in the first graph (fig.1/a), in the LB7 variety plants the flag leafs of the anthesis stage have

decreased significantly the concentration of their photosynthetic pigments but they haven't revealed significant changes in the surface area as compared to the normally planted crops (fig. 1/b). In real terms, the average values of the pigment concentration have decreased to 30% and were confirmed by statistical tests, LSD and t-test (table 1). The statistical analyses have confirmed the absence of changes in the leafy area as well (table 1).

Concerning the kernel-yield indicators, this variety has revealed a significant deterioration both in grain weight and number per spike (fig 1/a; fig.1/b; and table 1). Quite the contrary, the late planting seem to have induced in David x Mec crops a sharp increase of the pigment concentration occurring in their flag leaf (fig. 2), which has been confirmed by both statistical tests as well. As shown in the second figure, the pigment concentration of crops planted in January has been 146mg/gr as compared to 125 mg/g in those planted in November, which means 17% more dense pigments in flag leaf. However, to our surprise, the leafy area has been significantly reduced in the late planted crops as confirmed by both LSD and student test (Table 2).

In terms of yield indicators, these plants have revealed lower average values in their kernels weight and number per spike. Nevertheless, the changes have not been verified by both tests (LSD & student).

Interestingly enough, the STF4 variety crops have shown a great similarity in their response to the delayed planting time as compared to the DXM crops. Their photosynthetic system in the flag leaves has increased by 10% the pigments concentration as compared to the plants sown in November (fig. 3), confirmed as well by the statistical tests (table 3). The flag leaf surface as well has been significantly reduced, confirmed by LSD and t test also.

Additionally, there have not been significant changes, as far as yield indicators are concerned. Actually, unlike the DXM variety, average values in late planted crops have revealed a lower number of kernels in the spike and high grain. However, it is worth noting that such changes are not confirmed by any of the statistical tests.

The aforementioned results show that the late planted crops of LB7 variety, have undergone a significant reduction in both yield elements. Furthermore, such deterioration seems to have been caused mainly by the reduced concentration of photosynthetic pigments revealed in flag leaf of crops in their anthesis stage. Actually, it is a well-known fact that the photosynthetic pigments are responsible for the photons capture as well as for the conversion of their energy into crops' assimilates (BABANI 1995, ACEVEDO 2002, KONGJIKA 2004).




Fig. 1. Changes between November January planting. LB7 var.




Fig. 2. Changes between November January planting: DxM var.

On the other hand, regarding the results revealed by the crops of varieties DXM and STF4, it is evident that they have not been able to develop sufficiently the leafy organs until the anthesis stage. Nevertheless, this abnormality appears to have been compensated to some extent by the sharp increase of pigments concentration in them. This is confirmed by the fact that the plants have revealed a good performance of kernel features (weight and number). Furthermore, it is apparent that the plants have not suffered by the abortion of kernels' creation, which is well-known to happen in the case of

high temperatures strikes during the anthesis stage (ACEVEDO et al. 2002, LASKA 2009, FITOTEKNIA 1984).




Fig. 3. Changes between November January planting: STF4 var.

Conclusions

Firstly, it is apparent that the crops of varieties STF4 and DxM have had a better response to the late planting as compared to the LB7 variety.

Actually, the robustness of the durum wheat, STF4 variety, to the abiotic stresses is comprehensible, since many authors have affirmed the better resistance and resilience of durum wheat varieties toward a wide variety of stresses as compared to soft wheat varieties (Stamo, 1990).

Meanwhile, as far as soft varieties are concerned, DxM is much more resilient to the late planting as compared to the LB7 var. at least regarding the analyzed features.

Secondly, regarding the crucial features needed to be improved in order to adapt the varieties to the the late planting, it is worth noting the features to be focused on while dealing with each variety. So as foreseen:

LB7 variety crops need to be improved in their photosynthetic system and in their pigment concentration occurring in their flag leafs at the anthesis stage.

DxM variety crops need to be improved in their speed of development especially regarding their flag leaf so that the crops are ready to enter the anthesis stage when the photoperiod and the temperatures are induced at this stage.

Recommendations

This is a modest study regarding the issue of resilience to the late planting of wheat varieties imposed by the climate change in our country. We should also emphasise that other studies are required to tackle this question, such as:

Other features are needed to be analysed regarding the resilience of the above-mentioned varieties such as the germination vigor of seeds, the number of tillers and plant height, and detailed analyses of their photosynthetic system, assimilates distribution in plants, to name a few.

Additionally, other varieties are needed to be tested concerning this issue.

Finally, it is of high importance to carry out more extensive studies on the impact that the forecasted climate change is expected to have on crops especially cereals which are considered as key elements to human wellness.

Table 1. LSD test, evaluating the changes in average values of analyzed indicators in LB7 var. crops

Multiple Comparisons ^a						
(I) Optimal time	(J) delayed time	Mean Difference (I-J)	Std. Error	Sig.	95% Confidence Interval	
					Lower Bound	Upper Bound
November	Decemb	-1.308	2.406	.589	-6.155	3.538
	January	.000	2.610	1.000	-5.257	5.257
a. TRAIT = Leaf surface						
November	Decemb	-6396.295	4433.00	.183	-16424.44	3631.85
	January	31848.533*	4433.00	.000	21820.38	41876.68
TRAIT = Photosynthetic pigments						
November	Decemb	-8.45714	4.16809	.054	-17.0597	.1454
	January	12.34286*	4.16809	.007	3.7403	20.9454
TRAIT = Kernel number per spike						
November	Decemb	9.24188*	2.77009	.003	3.5247	14.9591
	January	18.4720*	2.77009	.001	12.7549	24.1892
a. TRAIT = Kernel weight						

*. The mean difference is significant at the 0.05 level.

Table 2.LSD test, evaluating the changes in average values of analyzed indicators in DxM var. crops.

Multiple Comparisons^a

(I) Optimal time	(J) Delayed time	Mean Difference (I-J)	Std. Error	Sig.	95% Confidence Interval	
					Lower Bound	Upper Bound
November	Decemb	11.81*	2.39	.000	6.98	16.65
	January	13.28*	2.59	.000	8.05	18.50
a. TRAIT = Leaf surface						
November	Decemb	9788.66*	515.55	.000	8622.40	10954.92
	January	-2.08E4	515.55	.000	-22003.79	-19671.27
TRAIT = Photosynthetic pigments						
November	Decemb	-2.82	3.62	.444	-10.28	4.63
	January	3.17	3.62	.389	-4.28	10.63
TRAIT = Kernel number per spike						
November	Decemb	11.16*	3.451	.003	4.07	18.24
	January	5.55	3.451	.119	-1.52	12.63
a. TRAIT = Kernel weight						

*. The mean difference is significant at the 0.05 level.

Table 3.LSD test, evaluating the changes in average values of analyzed indicators in STF4 var. crops

(I) KOHA	(J) KOHA	Mean Differenc e (I-J)	Std. Error	Sig.	95% Confidence Interval	
					Lower Bound	Upper Bound
Novembe r	Decemb	14.83400*	2.79817	.000	9.1591	20.5089
	January	14.98864*	3.10807	.000	8.6852	21.2921
a. TRAIT = Leaf surface						

Novembe r	Decemb	-	402.150	.000	-	-
		1.13792E 5			114667.8 8	112915.4 6
	January	-	402.150	.000	-99150.59	-97398.17
		9.82744E 4				

TRAIT = Photosynthetic pigments

Novembe r	Decem b	-.88889	6.73219	.896	-15.0327	13.2549
	January	9.77778	6.73219	.164	-4.3660	23.9216

TRAIT = Kernel number per spike

Novembe r	Decemb	2.68889	2.91337	.368	-3.4319	8.8096
	January	-4.52778	2.91337	.138	-10.6485	1.5930

a. TRAIT = Kernel weight

*. The mean difference is significant at the 0.05 level.

References

- ACADEMIC PRESS 1976: Chemistry and biochemistry of plant pigments. Vol. II: pp. 1-9.
- ACEVEDO, E., SILVA, P. & SILVA, H. 2002: Wheat growth and physiology In: Bread Wheat; Improvement and Production. FAO Plant Production and Protection Series No. 30 Rome: 567pp.
- BABANI, F. 1995: Ndryshimi i aktivitetit fotosintetik gjatë ndriçimit të filizave të etioluar të elbit. Pun. Inst. Kërk. Biol. 10: 63-67.
- HUNT, R. 1982: Plant growth curves: pp. 5-46.
- IHM (1982) Klima e Shqipërisë. Akademia e Shkencave, Tiranë.
- JAUPAJ, O., STAMO, I., MALO, V., BARDHI, N. & LASKA, A. 2013: Wheat: In search of diverse features to successfully cope with a changing world. Agriculture & Forestry, Vol. 59. Issue 1: 29-39.
- KONGJIKA, E. & KONGJIKA, S. 2004: Bioprodhimtaria dhe fotosinteza: 4-43.
- KRAJA, A., VERO, I. & ELEZI, F. 2000: Analiza sasiore e pigmenteve fotosintetike në materialet e provës kombëtare të grurit. Stud. Biol., No. 3: 78-86.
- LASKA, A. 2009: Elementet klimatike dhe modeli statistikor i prodhimit

- bimor. Monografi, pp. 11-32, 78-89.
- LICHTENTHALER, H. K. 1987: Chlorophylls and carotenoids: pigments of photosynthetic biomembranes. Meth. in Ezim., No.148: 350-382.
- MIKE, J. G. & DAVIES, W. P. 1997: Wheat production and utilization: systems, quality and the environment. pp. 5-60, 283-289. U. K. Cab International. 337 pp.
- STAMO, I. 1995: Aspektet gjenetike dhe bujqësore të mutagjenezës fizike te kultura e grurit të butë. Disertacion për kërkimin e gradës shkencore.
- SHEHU, R. 2004: Efektiviteti i përdorimit të treguesve biologjikë në prodhimin e grurit. Stud. Biol., No. 8: 27-36.
- WORLD BANK 2009: Climate vulnerability assessments: An Assessment of Climate Change Vulnerability, Risk, and Adaptation in Albania's Power Sector, Report No. 53331-ALB; pp. 5-20.
- <http://www.fao.org/DOCREP/006/Y4011E/Y4011E00.HTM>

Krahasimi i dy teknikave imunologjike (Elisa - Ecl) për detektimin e antitropave anti - toxoplasma igm

Blerta Laze *, Anila Mitre **

* Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali", Fakulteti i Shkencave Teknike,
Departamenti i Biologjisë

** Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Departamenti i
Biologjisë,

PËRMBLEDHJE

Toxoplasma gondii është një parazit që mund të shkaktojë çrregullime të ndryshme te pacientët dhe gratë shtatzëna, për shkak të rrezikut të lartë të transmetimit transplacental dhe zhvillimit të shumë plagëve të lindura te fetusit. Për këto arsye, është shumë i rëndësishëm evidentimi i rasteve pozitive për këtë patogjen në tre mujorin e parë të shtatzënesisë. Qëllimi i këtij punimi është krahasimi i testit ELISA, të aplikuar në aparatën CHORUS dhe Elektrokemilumineshencës (ECL), të aplikuar në aparatën COBAS 6000 për detektimin e antitropave anti-Toxoplasma IgM. Në diagnostikën mjekësore po punohet për të përcaktuar teknikën më të ndjeshme, në kuadrin e së cilës është zhvilluar ky punim shkencor. Janë analizuar 200 pacientë për detektimin e Toxoplasma IgM. Rezultatet e 185 mostrave (92.5 %) ishin të përputhshme me të dyja teknikën. Rastet e dyshimta dhe pozitive u testuan me teknikën PCR dhe u krahasuan të dhënat me njëra-tjetrën. Disavantazhi i testit ELISA (CHORUS) është sensitiviteti i ulët, por ka si përparësi matjen e mostrave një nga një. Ndërsa, ECL ka sensitivitet dhe specificitet të lartë. ELISA rekomandohet për ekzaminimet e shpejta, por në rastet e dyshimta është e rëndësishme që pacientët të testohen me teknikën ECL.

Comparison of two immunological techniques (elisa-ecl)
for detection of toxoplasma-igm antibodies

ABSTRACT

Toxoplasma gondii is a parasit that can cause many disorders to patients and

pregnant women, due to the high risk of transplacental transmission and development of many congenital injuries to the fetus. For these reasons, it is very important evidence of positive cases for this pathogen in the first trimester of pregnancy. The purpose of this study is to compare ELISA test, applied in CHORUS instrument and Electrochemiluminescence (ECL) technique, applied in COBAS 6000 instrument for detection of Toxoplasma IgM antibodies. Medical diagnostic is working to determine the most sensitive techniques, in the framework of which is developed this scientific work. 200 patients were analyzed for detection of Toxoplasma IgM antibodies. 185 out of 200 samples (92.5%), gave compatible results with both techniques. Doubtful and positive cases were tested with PCR technique and the results were compared with each other. ELISA (CHORUS) disadvantage is low sensitivity, but has the priority of measuring samples one by one. While, ECL has high specificity and sensitivity. ELISA is recommended for quick examinations but in doubtful cases it is important for patients to be tested with ECL technique.

KEY WORDS: Elektrokemiolumineshenca, ELISA, Toxoplasma IgM.

Hyrje

Toxoplasma gondii është një protozoar i kudogjendur që infekton të gjitha llojet e gjitarëve. Tek njerëzit, studimet serologjike kanë treguar përqindje të lartë të adultëve të infektuar nga ky parazit. Kjo sëmundje është veçanërisht e rrezikshme gjatë shtatzënësisë së pacientëve, meqenëse transmetohet nga nëna te fetusit (HOHLFELD at al. 1994). Për këtë arsye është i rëndësishëm determinimi i titrit të antitropave përpara fillimit të një shtatzënësie. Ky parazit mund të transmetohet prej oocisteve të maturuara, të shpërndara në ujë ose ushqim, veçanërisht nga macet (DUBEY at al. 2011). Fillimisht, infeksioni akut i cili shfaqet shpeshherë pa simptoma në individët e shëndoshë, shoqërohet nga një infeksion i mëvonshëm që qëndron gjatë gjithë jetës. Megjithatë, riaktivizimi i toxoplasmës, shpesh shoqërohet me meningoenfalit. Shkalla e infeksionit fetal rritet me moshën e barrës. Por, rreziku i disa manifestimeve klinike, është më i lartë në rastet e infeksioneve të hershme maternale. Diagnoza e toxoplasmosës, zakonisht përcaktohet nga detektimi i antitropave specifike anti-Toxoplasma IgG ose IgM. Detektimi i antitropave anti-Toxoplasma IgM, shpreh një riaktivizim të mundshëm akut ose latent të infeksionit (MEEK at al. 2001). Qëllimi i këtij punimi është krahasimi i testit ELISA, të aplikuar në aparatën CHORUS dhe Elektrokemiolumineshencës (ECL), të aplikuar në aparatën COBAS 6000 për

detektimin e antitropave anti-Toxoplasma IgM. Në diagnostikën mjekësore po punohet për të përcaktuar teknikat më të ndjeshme, në kuadrin e së cilës është zhvilluar ky punim shkencor.

Në rutinën klinike mjekësore, diagnoza e infeksionit të *Toxoplasma gondii*, është bazuar në serologji (DANNEMANN at al. 1990). Kohët e fundit, detektimi i toxoplasmës nëpërmjet PCR-së, mund të sigurojë një standard të saktë në diagnozën e infeksionit akut, por kjo teknikë është mjaft e kushtueshme. Në këto kushte është me vlerë testimi i teknikave të tjera imunologjike, si: ELISA dhe Elektrokemiolumineshenca dhe krahasimi i tyre me metodën e artë që është PCR Real-Time. Gjithashtu aparati CHORUS, është një aparat i ri dhe është me vlerë përcaktimi i vendit të tij në diagnostikën mjekësore.

Materiali dhe metodat

Në këtë studim janë analizuar 200 paciente (femra në tre mujorin e parë të shtatzënisë), të cilat janë testuar paralelisht me testin ELISA dhe teknikën e elektrokemiolumineshencës. Rastet pozitive janë testuar me teknikën PCR. Të dhënat e pacienteve janë organizuar në tabela, janë krahasuar me njëra-tjetrën dhe është llogaritur sensitiviteti për secilën teknikë. Secilës paciente i është marrë gjak prej venave dhe është hedhur në tuba me xhel. Serumi është përfutur nëpërmjet centrifugimit të gjakut për 10 minuta me 5000 xhiro.

Parimi i testit ELISA: Kjo teknikë aplikohet në aparatin Chorus, i cili është një aparat i ri në diagnostikën mjekësore. Antigenet e purifikuara të toxoplasmës janë të fiksuara në fazën solide. Antitropat specifike anti-Toxoplasma IgM lidhen me antigenet gjatë një inkubimi me serum in e holluar. Serumi, paraprakisht holluhet me një hollues që bllokton antitropat IgG. Pas shpëlarjeve për eliminimin e proteinave që nuk veprojnë, mostra inkubohet me konjugatin e përbërë nga antitropat monoklonalë IgM të lidhura me peroksidazë. Realizohen përsëri shpëlarje për largimin e konjugatit të palidhur dhe shtohet substrati. Ngjyra e formuar është në përpjesëtim të drejtë me përqendrimin e antitropave specifike të pranishëm në serum. Stripi i reagentit përmban të gjithë reagentët e nevojshëm për zhvillimin e një testi.

Përbërja e një stripi Toxo IgM: Stripi përmban 7 puseta, përmbajtja e të cilave njihet nga aparati nëpërmjet leximit të një barkodi. Barkodi tregon kodin e analizës, numrin e lotit dhe datën e skadencës së kitit. Në pusetën e parë hidhet serumi jo i holluar, ndërsa pusetat e tjera përmbajnë reagentët e nevojshëm për zhvillimin e analizës.

Marrja e mostrave: Serumi është përfutur nëpërmjet centrifugimit të gjakut për 10 minuta me 5000 xhiro. Mostrat mund të ruhen në 2-8°C për 2-4 ditë ose në -20°C për periudha më të gjata.

Parimi i testit të elektrokemiolumineshencës (ECL): ECL aplikohet në aparatën Cobas 6000. Reagentët e përdorur në këtë aparat vendosen në një dhomë të përcaktuar dhe serumi vendoset në tuba me barkode. Për detektimin e antitropave anti-Toxoplasma IgM përdoret parimi μ capping. ECL bazohet në përdorimin e antigeneve të biotinuara dhe të markuara me rutenium. Biotina shërben për fiksimin e komplekseve imune në fazën solide, ndërsa komplekset rutenium-trys (bipyridil)-tripropilamina shërbejnë për prodhimin e dritës. Nëse në serum janë të pranishëm antitropat anti-Toxoplasma IgM, ata lidhen me antigenet e pranishme në reagent duke formuar komplekset imune. Këto komplekse lidhen me mikropjesëza të ngarkuara me streptavidinë dhe fiksohen magnetikisht në elektodat e punës. Oksidimi i tripropilaminës çon në prodhimin e dritës, përqendrimi i së cilës është në përpjesëtim të zhdrejtë me përqendrimin e antigenit. Rezultati llogaritet duke u nisur nga kurba e kalibrimit. Në reaksionet negative ndodh e kundërta.

Reagentët Toxo IgM Roche: Reagentët e cobas e 601 kanë një barkod dydimensional (2D). Kjo lejon regjistrim plotësisht automatik dhe menaxhim të informacionit për reagentët. Reagentët e gatshëm përmbajnë tri shishe M, R1 dhe R2, ku ndodhen reagentët e nevojshëm për analizë. Disa prej kalibratorëve janë të gatshëm, por disa të tjerë duhen përgatitur. Kontrollat dhe kalibratorët e liofilizuar përgatiten dhe transferohen në tubat e duhur që përmbajnë gjithashtu barkode 2D.

Marrja e mostrave: Serumi është përfutur nëpërmjet centrifugimit të gjakut për 10 minuta me 5000 xhiro. Mostrat mund të ruhen në 2-8°C për 3 javë ose në -20°C për 3 muaj.

Aparati CHORUS i shpreh rezultatet si indeks (raporti ndërmjet vlerës OD të mostrës dhe vlerës së cut off), i cili është në përpjesëtim të drejtë me përqendrimin e antitropave specifike IgM të pranishme në mostër.

Aparati COBAS 6000 llogarit automatikisht vlerën cut off, të bazuar në matjet e kalibratorëve Cal1 dhe Cal2.

Kriteret e interpretimit të rezultateve shprehen në tabelat e mëposhtme.

Tabela 1: Kriteret e interpretimit të rezultateve për Toxoplasma IgM.

Toxoplasma IgM	ELISA (CHORUS)	ECL (COBAS 6000)
Negative	<0.9	<0.8 COI
Pozitive	>1.1	>1 COI
E dyshimtë	0.9-1.1	0.8-1 COI

Rezultatet dhe diskutimi

Rezultatet për secilën teknikë shprehen në tabelat e mëposhtme:

Tabela 2: Rezultatet e detektimit të antitropave anti-Toxoplasma IgM me teknikën ECL.

Toxoplasma IgM	ECL (COBAS 6000)
Negative	149
Pozitive	50
E dyshimtë	1

Tabela 3: Rezultatet e detektimit të antitropave anti-Toxoplasma IgM me teknikën ELISA.

Toxoplasma IgM	ELISA (CHORUS)
Negative	154
Pozitive	35
E dyshimtë	11

Siç shprehet edhe në tabelat 2 dhe 3, 185 mostra (92.5%) dhanë rezultate të përputhshme me të dyja teknikat. Në veçanti, 149 mostra dhanë rezultate negative, 35 mostra dhanë rezultate pozitive dhe 1 mostër rezultoi me vlerë të dyshimtë me të dyja teknikat. 15 mostra dhanë rezultate të papërputhshme, nga të cilat 10 rezultuan të dyshimta me teknikën ELISA dhe pozitive me teknikën ECL, ndërsa 5 mostra rezultuan negative me teknikën ELISA dhe pozitive me teknikën ECL (Tabela 4).

Tabela 4: Rezultatet e papërputhshme ndërmjet teknikave ECL dhe ELISA.

Pozitive (ECL)	Të dyshimta (ELISA)	Pozitive (ECL)	Të dyshimta (ELISA)	Pozitive (ECL)	Negative (ELISA)
1.8	0.9	3	1	1.7	0.8
1.5	0.9	1.9	0.9	1.5	0.7
2	0.9	1.4	1.1	1.8	0.7
1.6	1	2.6	1.1	2.5	0.8
2.1	0.9	2.1	0.9	2.7	0.8

Rezultatet pozitive, të dyshimta dhe të papërputhshme ndërmjet dy teknikave u analizuan me teknikën PCR dhe u përfatuan rezultatet e mëposhtme:

Tabela 5: Rezultatet e përfuara nga teknika PCR.

Toxoplasma IgM	PCR
Negative	1
Pozitive	50
E dyshimtë	0

Mostra që rezultoi e dyshimtë me të dyja teknikat, rezultoi negative me teknikën PCR, ndërsa 15 mostrat e papërputhshme ndërmjet teknikës ELISA dhe ECL rezultuan pozitive me teknikën PCR. Duke u bazuar në këto të dhëna është llogaritur sensitiviteti për secilën teknikë.

$$\text{Sensitiviteti} = \frac{\text{Numri i mostrave pozitive}}{\text{Numri i mostrave pozitive} + \text{numri i mostrave fals negative}}$$

ELISA: Sensitiviteti = 88%

ECL: Sensitiviteti = 98%

Në këtë studim është realizuar krahasimi i dy teknikave imunologjike duke u bazuar në teknikën PCR. Disavantazhi i teknikës ELISA është sensitiviteti i ulët, por ka si përparësi matjen e mostrave një nga një në një interval të shkurtër kohor. Aparati CHORUS i shpreh rezultatet si indeks (raporti ndërmjet vlerës OD të mostrës dhe vlerës së cut off), i cili është në përpjesëtim të drejtë me përqendrimin e antitropave specifike IgM të pranishme në mostër. Serumet e disa pacientëve mund të japin një rezultat negativ të përsëritshëm ose një rezultat të dyshimtë (BOBIC et al. 1991). Për këtë arsye, rezultatet e analizave duhet të interpretohen në përputhje me historinë klinike të pacientit ose duke u bazuar në rezultatet e diagnozave të tjera. Gjithashtu duhet të realizohen konfirmime të këtyre rezultateve me metoda të tjera si ECL ose PCR.

Aparati COBAS 6000 llogarit automatikisht vlerën cut off, të bazuar në matjet e kalibratorëve Cal1 dhe Cal2. Teknika ECL karakterizohet nga sensitivitet dhe specificitet të lartë. ELISA rekomandohet për ekzaminimet e shpejta, por në rastet e dyshimta është e rëndësishme që pacientët të testohen me teknikën ECL. Siç përmendet edhe në literaturë, metoda e artë në Biologjinë Molekulare është PCR-ja, por përdorimi i saj është i pamundur në diagnostikën mjekësore

rutinë për shkak të kostos së lartë të saj (WILSON et al. 1997). Për këtë arsye, duke u bazuar në sensitivitetin e teknikave ECL dhe ELISA, mund të themi se ECL rekomandohet si teknikë shumë e përshtatshme në diagnostikën mjekësore rutinë, veçanërisht për detektimin e infeksioneve akute të *Toxoplasma gondii* në tre mujorin e parë të shtatëzënësish.

Referencat:

- BOBIC, B., SIBALIC, D. & DJURKOVIC-DJAKOVIC, O. 1991: High levels of IgM antibodies specific for *Toxoplasma gondii* in pregnancy 12 years after primary toxoplasma infection. Gynecol. Obstet. Investig. 31: 182-184.
- DANNEMANN, B. R., VAUGHAN, W. C., THULLIEZ, P. & REMINGTON, J. S. 1990: Differential agglutination test for the diagnosis of recently acquired infection with *Toxoplasma gondii*. J. Clin. Microbiol. 28: 1928-1933.
- DUBEY, J. P., FERREIRA, L. R., MARTINS, J. & JONES, J. L. 2011 Oct.: "Sporulation and survival of *Toxoplasma gondii* oocysts in different types of commercial cat litter". The Journal of Parasitology 7 (5): 751-4.
- HOHLFELD, P., DAFFOS, F., COSTA, J. M., THULLIEZ, P., FORESTIER, F. & VIDAUD, M. 1994: Prenatal diagnosis of congenital toxoplasmosis with a polymerase chain reaction test on amniotic fluid. N. Engl. J. Med. 331: 695-699.
- MEEK, B., VAN GOOL, T., GILIS, H. & PEEK, R. 2001: Dissecting the IgM antibody response during the acute and latent phase of toxoplasmosis. Diagn. Microbiol. Infect. Dis. 41: 131-137.
- WILSON, M., REMINGTON, J. S., CLAVET, C., VARNEY, G., PRESS, C., WARE, D. & THE FDA TOXOPLASMOSIS AD HOC WORKING GROUP. 1997: Evaluation of six commercial kits for detection of human immunoglobulin M antibodies to *Toxoplasma gondii*. J. Clin. Microbiol. 35: 3112-3115.